



Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Buletini Shkencor

Buletini shkencor Nr.5 Vol.2 - 2022



Buletini shkencor

NR. 5, VOL.2 - 2022

ISSN: 2310-6719

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

Buletini shkencor

Numër 5, Vëllimi 2, 2022
ISSN 2310-6719

BULETINI SHKENCOR
Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë
Numër 5, Vëllimi 2, 2022
ISSN 2310-6719

Fjala hyrëse

Nga Prof. Dr. Roland Zisi, Rektor i Universitetit të Vlorës “Ismail Qemali”

Është detyrim dhe kënaqësi për mua që si kryeredaktor i Buletinit Shkencor të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, që të përcjell për lexuesit një rezymë shpjeguese në çelje të volumit të ri të tij, (Numër 5, Vëllimi 2, 2022). Ky numër i ri i Buletinit tonë shkencor përmban 18 artikuj studimorë nga fusha të ndryshme si shkencat politike, juridike, ekonomike, gjuhësia-albanologjia, shëndetësia, historia, shkencat inxhinierike dhe matematikore etj.

Buletini Shkencor ka si qëllim të udhëtojë nëpër mjediset e universiteteve kombëtare dhe ndërkombëtare për promovimin e rezultateve të kërkimit shkencor të ndërmarrë nga profesorati i Universitetit “Ismail Qemali”, dhe jo vetëm. Drejtohet nga një Bord Editorial dhe redaksitë përkatëse. Pjesë e Bordit Editorial janë akademikë të njohur në fusha të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

Pjesa më e madhe e materialeve të botuara në Buletinin Shkencor të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë janë fryt i punës kërkimore-shkencore që kryejnë pedagogët e Universitetit të Vlores, por prej kohësh janë afruar edhe studiues të universiteteve të tjera të vendit, si nga Universiteti i Tiranës, Universiteti i Korçës, Universiteti i Elbasanit etj. Gjithashtu në të janë paraqitur me materialet e tyre edhe studiues e kërkues të institucioneve të tjera kërkimore - shkencore.

Duke respektuar planin strategjik të UV-s për rritjen e kërkimit shkencor, unë si Rektor i UV-s si dhe të gjitha autoritetet drejtuese do të vazhdojmë të mbështesim studime sa më cilësore e bashkohore të cilat i përshtaten dhe i përgjigjen nevojave lokale, rajonale e më gjerë.

Kemi besimin se ky volum i Buletinit Shkencor të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë do të shërbejë jo vetëm për të paraqitur në një farë mënyrë kontributin e shumë brezave të pedagogëve - shkencëtarë të këtij Universiteti në fushat e ndryshme të shkencës, por do të ndihmojë konkretisht edhe pedagogët e rinj për t’u orientuar dhe për t’u thelluar në fusha të ndryshme me interes studimor, do të ndihmojë ata që janë në fazën e përgatitjes disertacioneve si dhe studentët e degëve të ndryshme.

Vlorë, Korrik 2022

Bordi editorial:

1. Prof. Dr. Roland ZISI (Kryetar)
2. Prof. As. Dr. Frosina Londo
3. Prof. As. Dr. Aurela Saliaj
4. Prof. Dr. Albert Qarri
5. Prof. As. Dr. Armela Panajoti
6. Prof. As. Dr. Hajdar Kiçaj
7. Prof. As. Dr. Enkelejd Mehilli

Bordi Shkencor:

1. Prof. Dr. Roland ZISI (Kryetar)

Fakulteti i Shkencave Humane

2. Prof. Dr. Bardhosh Gaçe
3. Prof. Dr. Nexhip Merkuri
4. Prof. As. Monika Hasani
5. Prof. As. Veneranda Hajrulla
6. PhD Erion Hitaj

Fakulteti i Ekonomisë

7. Prof. As. Dr. Xhiliola Agaraj (Shehu)
8. Prof. As. Dr. Klaudia Guga
9. Prof. As. Dr. Ilirian Lipi
10. Prof. As. Dr. Evelina Bazini
11. Prof. As. Dr. Fjoralba Velaj
12. Prof. As. Dr. Elenica Piero
13. Prof. As. Dr. Filloreta Madani

Fakulteti i Shendetit Publik

14. Prof. Dr. Yllka Bilushi

Fakulteti i Shkencave Teknike

15. Prof. As. Dr. Kristofor Lapa
16. Prof. As. Dr. Flora Qarri
17. Prof. As. Dr. Ermal Feleqi
18. Prof. As. Dr. Denada Kasëmi
19. Prof. As. Dr. Diana Ilia
20. Prof. As. Dr. Luljeta Gusho
21. Prof. As. Dr. Llambrini Sota

Të jashtëm

22. Prof. Dr. Genuario Belmonte
23. Prof. Dr. Triantaphyllos Almpanis
24. Prof. Dr. Francesko Altimari
25. Prof. Dr. Jorgo Kaçani
26. Prof. Dr. Muzafer Korkuti
27. Prof. Dr. Shaban Sinani
28. Prof. Dr. Dhori Kule

INFORMACION

Buletini Shkencor boton punime origjinale që sjellin njohuri të reja dhe të rëndësishme për avancimin e shkencës.

Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të gjetjeve shkencore të akademikëve shqiptarë brenda dhe jashtë mjedisit universitar shqiptar. Rëndësia e botimit të buletinit disa herë në vit qëndron në dhënie e mundësisë për të gjithë kërkuesit akademik dhe jo vetëm të bëjnë të njohura gjetjet më të reja në fushat përkatëse të tyre si dhe në përditësimin në kohë të gjetjeve të mëparshme.

Dërgimi i dorëshkrimit nënkupton që punimi i paraqitur në të nuk është botuar më parë (përveçse në formën e një përmbledhjeje, leksioni apo tezave akademike), nuk është në shqyrtim për t'u botuar gjetkë dhe se botimi është aprovuar nga të gjithë autorët, si dhe autoritetet përgjegjëse ku hulumtimi është kryer. Autorëve do t'ju kërkohet që të paraqesin, nëse ka ndonjë konflikt interesash, si dhe ndonjë burim financiar të veçantë të përdorur për kryerjen e kërkimit. Nëse dorëshkrimi pranohet për botim ai nuk mund të botohet në të njëjtën formë diku tjetër pa marrë më parë leje me shkrim nga Bordi i Buletinit Shkencor.

Plagjiatura nuk lejohet dhe do t'u raportohet si autorit, ashtu edhe autoriteteve përkatëse. Konkluzionet duhet të justifikohen nga skema eksperimentale dhe të dhënat e paraqitura. Informacioni duhet të jetë i detajuar në mënyrë që të lejojë përsëritjen e punës nga shkencëtarë të tjerë të së njëjtës fushë. Autorët duhet t'i ruajnë të dhënat eksperimentale dhe t'ia paraqesin Këshillit Botues, nëse u kërkohen. Shkrimi duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm, konçiz dhe korrekt nga ana gramatikore. Autorët mbajnë përgjegjësi për anën shkencore dhe formale të materialeve që paraqesin, si dhe për çdo korrespondencë me redaktorët.

Të interesuarit të paraqiten me arritjet më të reja nga fushat e angazhimeve të tyre profesionale – shkencore.

Artikujt duhet të jenë origjinale (të pakumtuara në ndonjë aktivitet tjetër), të pabotuara dhe jo në proces vlerësimi ose botimi (në ndonjë redaksi tjetër).

Autorët janë përgjegjës për redaktimin gjuhësor të tekstit të përmbledhjeve të tyre, qoftë në shqip, qoftë në anglisht.

Të gjithë autorët e interesuar për të botuar në Buletinin Shkencor të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë mund të na kontaktojnë në adresën email: publikime@univlor.edu.al

Përmbajtja

SHKENCAT POLITIKE-JURIDIKE DHE EKONOMIKE

MIRËQËNIA E KONSUMATORIT NË PRONËSINË INTELEKTUALE: RASTI I PATENTËS <i>Belinda Halilaj</i>	12
NJËANSHMËRIA E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NDAJ EKSPORTEVE SHQIPTARE <i>Florian Miti</i>	17
LEGAL AND PRACTICAL CHALLENGES ON IMPLEMENTING RIGHT TO INFORMATION <i>Oljana Hoxhaj</i>	33

SHKENCAT MJEKËSORE DHE SHËNDETËSORE

AKTIVIZIMI DHE MOTIVIMI I NXËNËSVE NË KUSHTET E IZOLIMIT NGA PANDEMIA COVID-19 <i>Asllan Vrapit</i>	41
VLERËSIMI I HOMOFOBISË TEK STUDENTËT E INFERMIERISË DHE INFERMIERI-MAMISË, NË FAKULTETIN E SHËNDETIT, VLORË <i>Erlini Kokalla, Dafina Bucaj, Esilda Trushaj</i>	49
HEALTH SAFETY AT WORK IN VLORA REGIONAL HOSPITAL <i>Denada Selfo, Glodiana Sinanaj</i>	58
SI NDIKOI STRESI NË SHËNDETIN MENDOR DHE FIZIK TË NJERËZVE TË INFEKTUAR ME COVID- 19 DHE MENAXHIMI I TIJ PËR TË PËRMIRËSUAR CILËSINË E JETËS <i>Glodiana Sinanaj, Denada Selfo, Blenora Kapaj</i>	63
NJOHURITË DHE PRAKTIKAT E PËRDORIMIT TË MEDIKAMENTEVE ANTI-INFLAMATORË JOSTEROIDË - (AIJS) NË POPULLATËN ADULTE NË QYTETIN E VLORËS <i>Jerina Jaho, Dhurata Shena</i>	73
PANDEMIA DHE SHTATËZANIA - ROLI I INFERMIERIT NË QETËSIMIN E FRIKËS DHE ANKTHIT GJATË PERIUdhËS SË PANDEMISË <i>Saemira Durmishi, Diana Çuberi</i>	80

SHKENCAT E EDUKIMIT

NIVELI I ULËT I VET-VLERËSIMIT TEK NXËNËSIT NXIT BULLIZMIN NË SHKOLLAT NËNTËVJECARE <i>Arlinda HALLUNOVI (Ymeri)</i>	87
MUZIKA, FAKTOR I RËNDËSISHËM EDUKATIV DHE TERAPEUTIK PËR FËMIJËT ME VËSHTIRËSI NË TË NXËNË <i>Eliona Lici</i>	96

GJUHËSI-ALBANOLOGJI

KONKORDANCAT LEKSIKORE NË ROMANIN “PSE” TË STERJO SPASSES <i>Evis Hudhëra</i>	105
VËZHGIMI SHKENCOR I PROFESOR ETHEM LIKAJ PËR MBIEMRAT TE “MORFOLOGJIA E SHQIPES STANDARDE” <i>Evis Hudhëra</i>	115
ARRITJE SHKENCORE PËR AFTËSINË KRIJUESE TË BASHKËSISË GJUHËSORE TË MALËSISË SË MADHE - “Fjalori leksiko-frazeologjik i Malësisë së Madhe” i prof. Gjovalin.Shkurtaj Akademik Emeritus <i>Nexhip Mërkuri</i>	121
TIPAT NDËRTIMORË TË SINTAGMAVE PARAFJALORE NË GJUHËN ANGLEZE NË PËRQASJE ME ATO TË GJUHËS SHQIPE <i>Leonora Lumezi, Daniela Hasa</i>	130
 SHKENCAT INXHINIERIKE DHE MATEMATIKORE	
NJË VËSHTRIM MBI ALGJEBRËN GJEOMETRIKE <i>Elda Lamçe, Llambrini Sota</i>	139
METODAT STATISTIKORE JOPARAMETRIKE <i>Llambrini Sota, Elda Lamçe</i>	144
VLERËSIMI I TRAFIKUT ME NIVELET E SHËRBIMIT DHE NEVOJA PËR TRANSPORT TË QËNDRUESHËM NË QYTETIN E VLORËS <i>Pëllumb Cacaj</i>	151

SHKENCAT POLITIKE-JURIDIKE DHE EKONOMIKE

Mirëqënia e konsumatorit në Pronësinë Intelektuale: Rasti i Patentës

Dr. Belinda HALILAJ

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Vlorë/Shqipëri

belinda.halilaj@univlora.edu.al

Abstrakt

Evoluimi i teknologjisë shtroi si domosdoshmëri mbrojtjen e konsumatorit. Mirëqënia e konsumatorit në fushën e Pronësisë Intelektuale është domosdoshmëri e kohëve moderne. Patentimi i shpikjes është kusht kryesor që mbrojtja të shtrihet dhe mbi konsumatorin. Konsumatori gëzon mbrojtje vetëm mbi ato shpikje që janë të pantetuara. Në fushën e pronësisë intelektuale kompanitë kanë miratuar strategji për të garantuar mirëqënien e konsumatorit përballë shumëllojshmërisë së produkteve. Patenta është e drejtë ekskluzive e dhënë për një shpikje, e cila është një produkt ose një proces që siguron në përgjithësi, një mënyrë të re për të bërë diçka, ose ofron një zgjidhje të re teknike për një problem. Kur vendoset nëse duhet ose jo të patentohet shpikja, gjënë e parë që shpikësit duhet të dinë është të caktojnë nëse shpikjet e tyre i plotësojnë kushtet e patentimit. Shpikësit duhet të zbulojnë sa janë njerëzit të interesuar në shpikjet e tyre dhe nëse konsumatorët do të dëshirojnë të blejnë. Procesi i patentimit mund të jetë i gjatë dhe i shtrenjtë prandaj shpikësit duhet të sigurojnë që kur të fitojnë patentat do të mund të shesin shpikjet e tyre dhe të mbulojnë kostot e patentimit dhe prodhimit.

Fjalë kyçe: Mirëqënie, konsumator, ligj, patentë, pronësi intelektuale.

Abstract

The evolution of technology makes consumer protection a necessity. Consumer welfare in the field of Intellectual Property is a necessity of modern times. The patenting of invention is a key for protection to extend the consumer as well.

The consumer enjoys protection only over those inventions that are patented. In the field of intellectual property, companies have adopted strategies to guarantee consumer welfare in the face of product diversity. A patent is the exclusive right granted to an invention, which is a product or process that provides, in general, a new way of doing something, or offers a new technical solution to a problem. When deciding whether or not an invention should be patented, the first thing inventors need to know is to determine if their inventions meet the patent requirements. Inventors need to find out how much people are interested in their inventions and whether consumers will want to buy. The patenting process can be lengthy and expensive so inventors must ensure that when they obtain patents they will be able to sell their inventions and cover the costs of patenting and manufacturing.

Keywords: welfare, consumer, law, patent, intellectual property.

Hyrje

Fillesat e para për mbrojtjen e patentës datojnë në Venecia në vitin 1450, në fushën e punimit të qelqit. Mbrojtja ofrohej për një periudhë 10 vjeçare. Në vitin 1555, ishte Mbreti Henri II i Francës që krijoi konceptin e patentës për një shpikje. Patentat janë dhënë nga ana e monarkisë dhe nga institucione të tjera si "*Maison du Roi*" dhe Parlamentit i Parisit. Në shekullin e XVI-të në Angli, familja mbretërore shpërnda patentat për monopolet më të favorizuara. James I i Anglisë anuloi të gjitha monopolet ekzistuese dhe

deklaroj se patenta do të përdroshin për "shpikjet e reja". Vendimi bëri të pavlefshme të gjitha monopolet dhe lejet e dhëna me përjashtim të punëve që ishin prodhuar për herë të parë. Zhvillime të rëndësishme mbi ligjin për patentën ndodhën në shekullin e 18-të me anë të një procesi të ngadaltë të interpretimit të ligjit nga gjykata. Si pasojë e filzofisë të ndjekur nga Xhon Lok, në fund të shekullit të XVIII-të dhënia e patentave filloi të trajtohej pjesë e Pronësisë Intelektuale. Sistemi modern i patentave u krijua në Francë gjatë Revolucionit të vitit 1791.

Metodologjia.

Për zhvillimin e këtij punimi shkencor janë përdorur disa metoda kërkimi si: metoda historike, përshkruese, shpjeguese, analitike. Këto metoda gjenden të përziera në punim.

Kuptimi i patentës.

Patenta është e drejtë ekskluzive e dhënë për një shpikje, e cila mund të jetë produkt ose proces që siguron një mënyrë të re për të bërë diçka, ose ofron zgjidhje të re teknike për një problem (1). Për të marrë një patentë, informacione teknike rreth shpikjes duhet të jenë të hapura për publikun me një kërkesë për patentë. Patenta është dokument zyrtar që i lëshohet shpikësit nga ana zyres shtetëror kompetent ose "Zyra Evropiane e patentave". Në Shqipëri, institucioni kompetent është Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale (DPPI). Patentat janë pjesë e Pronësisë Intelektuale, ajo përmbledhë krijime të shpikura nga truri i njeriut.

Shpikësit pajiset me patentë për shpikjen e bërë duke paraqitur aplikimin për patentë në institucionin kompetent shtetëror për patentim. Ky aplikim është përshkrim i hollësishëm dhe diagram i shpikjes dhe mënyrës së funksionimit. Patenta është e vlefshme për një periudhë të kufizuar kohore, me afat 20 vjet nga data e depozitimit të aplikimit për t'u pajisur me patentë (2). Patenta është e drejtë territoriale, e kufizuara në kufirin gjeografik të vendit apo rajonit. Fushat e aplikimit për patentë janë të kufizuara sepse kjo e drejtë nuk mund të ushtrohet në çdo fushë. Fushat në të cilat nuk mund të ushtrohet janë si më poshtë:

- Zbulimet dhe teoritë shkencore,
- krijimet estetike,
- zbulimet e thjeshta të substancave,
- shpikjet që mund të ndikojnë në rendin publik, zakonet e mira apo shëndeti publik,
- metodat diagnostike, terapeutike dhe kirurgjike për trajtimin e njerëzve apo kafshëve,

- proceset biologjike për prodhimin e bimëve ose kafshëve,
- programet kompjuterike.

Kushtet e patentimit.

Në aplikimin për shpikje, shpikësi duhet ta përshkruaj shpikjen në detaje dhe ta krahasoj atë me teknologjitë e mëparshme ekzistuese në të njëjtën fushë, në mënyrë që të tregoj risinë e tij (2). Jo të gjitha shpikjet janë të patentueshme. Ligji, parashikon që shpikja të përmbushë kushtet e mëposhtme, të njohura si kërkesa apo kushte të patentimi:

- Zbatueshmëria Industriale: Shpikja duhet të jetë për përdorim praktik ose e aftë për një lloj aplikim industrial.
- Risia: Ajo duhet të tregojë një karakteristikë të re që nuk është e njohur më përpara në këtë fushë.
- Hapat krijues: Ajo duhet të tregoj një hap shpikës që nuk mund të konkludohet nga një person me njohuri mesatare në fushën teknike.
- Subjektet e patentueshme.

Për kushtet e reja dhe hapat krijues duhet të ekzistoj një datë e caktuar, zakonisht data në të cilën kërkesa paraqitet. Nga ky rregull bëhet përjashtim vetëm për aplikimet e bëra në vendet anëtare të Konventës së Parisit. Çfarë do të kuptojmë me të drejtë të përparësisë? Me të drejtë të përparësisë (2) do të kuptojmë ato raste kur aplikanti ka paraqitur një kërkesë për mbrojtjen e shpikjes në një vend anëtar të Konventës së Parisit, të njëjtën kërkesë aplikantit (ose zëvendësuesi i tij ligjor) e ka paraqitur në një shtet tjetër. Lind pyetja se cili nga këto aplikime do të jetë i vlefshëm? Aplikimi i kryer më vonë në kohë do të konsiderohet sikur të jetë paraqitur në të njëjtën ditë si aplikim i paraqitur në një datë të mëparshme. Patentat ndahen si në patentë produktit dhe në patentë procesi. Personit që i është dhënë një patentë, njihet si pronari i patentës ose mbajtësi i patentës. Personat e interesuar që dëshirojnë të shfrytëzojnë shpikjen komerciale në vendin e tyre duhet të marrin autorizimin e patentës. Çdokush i cili shfrytëzon një shpikje të patentuar, pa autorizimin e patentës kryen një veprim të kundraligjshëm. Ligjet bashkëkohore të patentave mbrojnë shpikësin për një periudhë të caktuar kohore, zakonisht 20 vjet. Gjatë kësaj periudhe kohore nuk lejohet me ligj që persona të tjerë të kopjojnë, përdorin, shpërndajnë ose shesin shpikjen pa pëlqimin e shpikësit.

Disa shpikës janë tepër të zënë duke punuar në idenë vijuese për të shpenzuar kohë për shitjen e shpikjes. Në këto raste, shpikësit mund të aplikojnë licencimin e shpikjeve të tyre. Kur

shpikësit licensojnë shpikjet e patentuar, ata autorizojnë një person ose kompani tjetër të prodhojë, shesi ose shpërndajë atë. Nëse persona të tjerët kopjojnë, shpërndajnë ose shesin një shpikje të patentuar pa lejen e patentuesit kjo përbënë shkelje të patentimit, i patentuari në këtë rast ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës. Në përfundim të afatit të mbrojtjes së patentës, shpikja kalon në dominim publik dhe secili mund ta komercializojë pa lejen e shpikësit.

Për përdorimin e patentave janë miratuar strategji nga kompanitë për produktet e konsumit të cilat kanë në fokus mbrojtjen e konsumatorit. Kjo mbrojtje ofrohet vetëm për produktet e konsumit. Mbrojtja prek fazat që prej prodhimit të produktit deri në vendosjen e tyre në treg. Prodhuesit kanë synim të kënaqin konsumatorin nëpërmjet shumëllojshmërisë së produkteve që ofrojnë. Kompania nxjerr në treg produkte që konsumatori ka interes dhe synon t'i mbroj nëpërmjet patentës së shërbimit (3).

Ndikimi i të drejtat e pronarit të patentimit mbi mirëqënien e konsumatorit.

Të drejtat ekskluzive të pronarit të patentimit janë si më poshtë:

- Në rastin e Patentës së produktit, pronarit ka të drejtë për të parandaluar palët e treta, duke përdorur ofrimin për shitje, shitjen ose importimin e produktit të tij. Me masat e mara pronari që zotëron patentën garanton konsumatorin mbi të drejtat që gëzon, si psh: ne rastin e kompanisë *Apple kundër Samsung*, në gusht të vitit 2012, një juri gjeti Samsungun fajtor se kishte cenuar gjashtë patenta të Apple (4). Në këtë rast konkret bëhet fjalë, sipas pretendimeve të Apple, se Samsungu i ka shkelur të drejtat e patentave në segmentin e sinkronizimit të muzikës dhe videove me kompjuter PC në modelet Samsung Galaxy S, Galaxy Tab dhe Galaxy S II.
- Në rastin Patentës të procesit, e drejta për të parandaluar palët e treta pa pëlqimin e pronarit të përdorin procesin. Ajo u ndalon palëve të treta përdorimin, ofrimin për shitje, shitjen ose importimin për këto qëllime të produkteve të cilat janë marrë drejtpërdrejt nga ky proces.

Të drejtat që gëzon pronari nga patentimi ndikojnë direkt në mirëqënien e konsumatorit. Konsumatori ka mundësi zgjedhje në treg mbi llojin dhe cilësinë e produktit që blenë.

Klasifikimi Ndërkombëtar i Patentave.

Klasifikimi Ndërkombëtar i Patentave (IPC) është një sistem hierarkik, i themeluar me

Marrëveshjen e Strasburgut në vitin 1971. Ai shërben si një instrument për rregullimin e marrëveshjeve mbi dokumentat e patentës. Edicioni i shtatë i IPC përbëhet nga 8 seksione, të cilat janë ndarë në 120 klasa, 628 nënklasë dhe përafërsisht 69,000 grupe. Tetë seksionet janë si më poshtë (4):

- 1) Nevojat e njeriut;
- 2) Kryerja e Operacioneve; Transportimi;
- 3) Kimi; Metalurgji;
- 4) Tekstile; Letër;
- 5) Ndërtimi;
- 6) Inxhinieri Mekanike; Ndriçimi; Ngrohje; Armë;
- 7) Fizikë;
- 8) Elektricitet.

Modelet e përdorimit.

Modelet e përdorimit gëzojnë mbrojtje ligjore në më shumë se 30 vende, por dhe nga Marrëveshjet Rajonale të Organizatës Pronësisë Industriale Rajonale të Afrikës (ARIPO) dhe Organizata Afrikane "*de la propriete intellectuelle*" (OAPI). Shprehja "model përdorimi" është dhënë për një titull të mbrojtjes mbi shpikje të caktuara, për zbulimet në fushën mekanike. Modelet e përdorimit janë të kërkuar zakonisht për shpikjet teknike më komplekse ose për shpikjet që kanë një afat të shkurtër tregtimi. Modelet e përdorimit ndryshojnë nga patentat për shpikje në këto aspekte (5):

- 1) Kërkesa për marrjen e një modeli shërbimi është më pak strikte sesa në rastin e patentës.
- 2) Afati maksimal i mbrojtjes që parashikohet nga ligj për një model shërbimi është përgjithësisht më i shkurtër se një afat maksimal për mbrojtjen e parashikuar për një patentë për shpikjen (zakonisht nga 7 deri në 10 vjet).
- 3) Taksat e kërkuara për marrjen dhe mbajtjen e të drejtës janë në përgjithësi më të ulëta se ato për patentat.

Kur duhet të patentohet një shpikje?

Kur vendoset nëse duhet ose jo të patentohet shpikja, gjënë e parë që shpikësit duhet të dinë është të caktojnë nëse shpikjet e tyre i plotësojnë kushtet e patentimit. Neni 52 pika 1 i EPC-së përshkruan lëndën e patentueshme si "*çdo shpikje në të gjitha fushat e teknologjisë, me kusht që ato të jenë të reja, të përfshijnë një hap shpikës dhe janë të zbatueshme në industri*". Shpikësit duhet të zbulojë sa janë njerëzit të interesuar për shpikjen e tyre dhe nëse konsumatorët do të dëshirojnë ta blejnë. Procesi i patentimit mund të jetë i gjatë dhe i shtrenjtë prandaj shpikësit duhet

të sigurojnë që kur të fitojnë patentat do të mund të shesin shpikjet e tyre dhe të mbulojnë kostot e patentimit dhe prodhimit. Në bazë të nenit 52 pika 2 të EPC-së përjashtohen subjekte të caktuara të cilët, në mënyrë të veçantë, nuk mund të konsiderohen si shpikje të patentueshme sipas kuptimit të nenit 52 pika 1 e EPC. *Çfarë ndodh nëse një shpikje nuk patentohet?* Shpikjet që nuk janë patentuar mund të kopjohen, shiten dhe shpërndahen nga secili (6). Kjo nënkupton që pa patentë, shpikësit mund t'i humbasin të hollat që do të mund të fitonte nga shpikja e tij (6). Nëse shpikjet janë të suksesshme dhe njerëzit duan të blejnë, nuk do të ketë asgjë për të ndaluar kompanitë që kopjojnë të shesin shpikjet e njëjta. Kjo konkurrencë do të zvogëlonte shitjet dhe fitimin që shpikësit do të mund të arrijnë nga shpikje e tyre. Përveç kësaj, pa patentë, vështirësohet liçensimi i shpikjes për investuesit, prodhuesit ose distributorët.

Mbrojtja e patentuar vlen vetëm në shtetin që është dhënë patenta (11), (12). Në bazë të nenit 53 përjashton nga patentimi (8):

- Shpikjet, përdorimi tregtar i të cilave është në kundërshtim me rendin publik ose moralin.
- Varietetet bimore, shtazore apo proceset thelbësisht biologjike për prodhimin e bimëve ose kafshëve, me përjashtim të proceseve mikrobiologjike dhe produktet e tij.
- Metodatat për trajtimin e trupit të njeriut ose të kafshës me kirurgji ose terapi. Metodatat diagnostike që ushtrohen mbi trupin e njeriut ose të kafshës, me përjashtim të produkteve, veçanërisht ndaj substancave apo përbërësve, që përdoren në ndonjë nga këto metodatat.

Fusha e mbrojtjes (Neni 69 i EPC-së).

Të drejtat e mbajtësit të një Patente Evropiane janë të njëjta me ato që gëzonë dhe mbajtësi i një patente kombëtare (Neni 64 pika 1 i EPC-së). Si pasojë kufizimet dhe përjashtimet mbi të drejtat ekskluzive të mbajtësit të patentës janë të njëjta. Megjithatë, EPC përmban rregulla që përcaktojnë fushëveprimin e mbrojtjes, të detyrueshme dhe në fazën e post-grantit. Në nenin 64 /2 i EPC-së e bën të detyrueshme që mbrojtja e patentës së dhënë për një proces do të shtrihet edhe mbi produktet e fituara drejtpërdrejt nga ky proces (13). Neni 69 pika 1 i EPC-së parashikon se masat e mbrojtjes së siguruar nga një Patentë Evropiane përcaktohen nga pretendimet, përshkrimi dhe vizatimet janë përdorur për të interpretuar pretendimin. Në nenin 69 pika 2 parashikohet se: *Për periudhën deri në dhënien e patentës evropiane, shkalla e mbrojtjes që siguron*

aplikimin Evropian i patentës përcaktohet nga pretendimet e paraqitura në aplikimin që publikohet... Duke marrë në konsideratë faktin se neni 69 është i një rëndësie vendimtare në fushën e të drejtës ekskluzive për mbrojtjen e patentës si dhe për ndikimin ekonomik që ka, u konstatua se shtetet anëtare kishin tradita të ndryshme dhe udhëzimet për interpretimin e nenit 69 u përcaktuan në një Protokoll të EPC (14).

Për përcaktimin e shkallës së mbrojtjes të dhënë nga një patentë evropiane, llogaritjet e duhura duhet të meren nga çdo element që është ekuivalente me një element të specifikuar të pretendimeve. Në nenin 1 të këtij Protokollit parashikohet se: *Neni 69 nuk duhet të interpretohen sipas kuptimit që kanë masat për mbrojtjen e siguruar për një patentë evropiane, ajo duhet të kuptohet në kuptimin literal të fjalëve të përdorura në pretendim...*

Në nenin 63 pika 1 të EPC-së parashikohet që afati i patentës evropiane do të jetë 20 vjet nga data e depozitimit të aplikimit (9), (10).

Konkluzione.

Patenta është e drejtë ekskluzive e dhënë për një shpikje. Fushat e aplikimit për patentë janë të kufizuara sepse kjo e drejtë nuk mund të ushtrohet në çdo fushë. Për përdorimin e patentave janë miratuar strategji nga kompanitë për produktet e konsumit të cilat kanë në fokus mbrojtjen e konsumatorit. Kjo mbrojtje ofrohet vetëm për produktet e konsumit. Mbrojtja prek fazat që prej prodhimit të produktit deri në vendosjen e tyre në treg.

Prodhuesit kanë synim të kënaqin konsumatorin nëpërmjet shumëllojshmërisë së produkteve që ofrojnë. Të drejtat që gëzon pronari nga patentimi ndikojnë direkt në mirëqënien e konsumatorit. Konsumatori ka mundësi zgjedhje në treg mbi llojin dhe cilësinë e produktit që blenë.

Literatura

- (1) Dreier TH., Kur A., *European Intellectual Property Law*, Edward Elgar Cheltenham, UK• Northampton, MA, USA, 2013, fq. 84.
- (2) http://www.wipo.int/export/sites/www/free_publications/en/sme/917/wipo_pub_917.pdf
- (3) Dolin G., *Do Patent Challenges Reduce Consumer Welfare?*, fq. 261, *E vlefshme online:* https://lawreview.uchicago.edu/sites/lawreview.uchicago.edu/files/Dolin_RESP_FINAL_revised.pdf
- (4) <http://www.bbc.com/news/technology-24855829>

- (5) Arthur. R. Muller, Michael H. Davis, "Intellectual Property", 1991, West Publishing Company, P.O. BOX 64526.
- (6) http://www.wipo.int/export/sites/www/free_publications/en/intproperty/895/wipo_pub_895.pdf
- (7) Mësoni nga e kaluara, krijoni ardhmërinë: Shpikje dhe Patentë, Organizata Botërore e Pronës Intelektuale, 2007, fq. 25.
- (8) MacQueen, Hector L; Charlotte Waelde and Graeme T Laurie (2007). *Contemporary Intellectual Property: Law and Policy*. Oxford University Press. ISBN 978-0-19-926339-4.
- (9) Seville C., *EU Intellectual Property Law and Policy*, MPG Books Ltd, Bodmin, Cornwall, 2009, pg.7, ISBN 978 1 84720 123 2.
- (10) Mossoff, A. 'Rethinking the Development of Patents: An Intellectual History, 1550-1800,' *Hastings Law Journal*, Vol. 52.
- (11) "Berne Convention for the Protection of Literary and Artistic Works, Article 5". *World Intellectual Property Organization*.
- (12) Traktati i Bashkëpunimit për Patentën.
- (13) Konventa Evropiane e Patentave (EPC).
- (14) Protocol on the Interpretation of Article 69 EPC, 5 October 1973.
- (15) Patenta Evropiane dhe procedura e garantimit, DPPI, fq.13 E vlefshme online: file:///C:/Users/User/Downloads/Patentat-Evropiane-dhe-Procedura-e-Grantimit.pdf

Njëanshmëria e investimeve të huaja direkte ndaj eksporteve shqiptare

Florian Miti

University "Ismaïl Qemali", Vlorë
Albania
florian.miti@univlora.edu.al

Abstract

Foreign direct investment (FDI) is considered to be an important factor of economic and international integration of a country. It can ensure financial stability, promote economic development and improve social welfare.

A particular research interest has been shown for countries with a history of economic transition, which, although at different stages of development, share similar mechanisms of post-communist economic recovery. This study analyzes the short-term and long-run relationship of FDI inflows to Albanian exports and Gross Domestic Product (GDP) of the last two decades using vector error correction model (VECM) and Granger causality tests on quarterly time series data ($n = 72$) between 2004 and 2021.

The findings of this study, confirm in some cases the results of previous studies performed on the same variables and, although applied on different time periods and with a more detailed data, lead to some important conclusions on the country's policy-making.

Keywords: *export; FDI; causality; transition*

Abstrakti

Investimet e huaja direkte (IHD-të) konsiderohen si ndër faktorët kryesorë të integritit ekonomik dhe ndërkombëtar të një vendi. Këto investime të huaja mund të sigurojnë stabilitet financiar, të nxisin zhvillimin ekonomik dhe të përmirësojnë mirëqenien shoqërore të vendit pritës. Në këtë këndvështrim, IHD-të janë parë si kanal i përshtatshëm për të zhvilluar një ekonomi gjatë fazës së tranzicionit ekonomik, duke pasur në fokus krijimin e vendeve të reja të punës dhe përmirësimin e teknologjisë të vendit pritës.

Ky studim analizon marrëdhënien afatshkurtër dhe afatgjatë të flukseve hyrëse të IHD-ve, kundrejt eksporteve Shqiptare dhe Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB-së) të dy dekadave të fundit duke përdorur teste e korrigjimit vektorial të gabimit (VECM) si dhe testet e shkakësisë Granger mbi të dhënat në seri kohore tremujore ($n = 72$) midis 2004 dhe 2021. Gjetjet e këtij punimi, në disa raste, konfirmojnë rezultatet e punimeve të mëparshme të kryera mbi këto variabla dhe, edhe pse të aplikuara në periudha të ndryshme kohore por dhe me të dhëna më të detajuara, çojnë në disa përfundime të rëndësishme mbi politikëbërjen e vendit.

Fjalët kyçe: *IHD; Eksporte; tranzicion; marrëdhënia shkakësore*

1. Hyrje

Investimet e huaja direkte (IHD-të) janë një faktor i rëndësishëm për ekonominë e çdo vendi pritës, ndaj dhe shumë studiues kanë shprehur intresin e tyre mbi rolin e investimeve të huaja direkte në këto ekonomi. Një interes veçantë në këto hulumtime kohët e fundit kanë zënë ekonomitë të vendeve me një historik tranzicioni të cilat, dhe pse në faza të ndryshme zhvillimore, karakterizohen nga situata të ngjajshme ekonomike dhe ndajnë mekanizma të ngjajshëm për rimëkëmbjen ekonomike post komuniste. IHD-të luajnë një rol shumë të madh për këto vende pasi këto investime të huaja shtojnë njohuritë dhe kapitalin që i mungon vendit pritës, gjithashtu ato krijojnë vende të reja pune. Investitorët e huaj kanë treguar interes në rritje për këto investime të huaja direkte duke u joshur kryesisht tek potencialet e Shqipërisë të lidhura me burimet natyrore, pozitën gjeografike, klimën, krahun e lirë të punës etj. Në këtë kuadër, Shqipëria është në përpjekje të vazhdueshme për të krijuar politika zhvillimore dhe masa të tjera të rëndësishme për të krijuar një ambient sa më të përshtatshëm të biznesit dhe klimë sa më të favorshme investuese.

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë në mënyrë empirike marrëdhënien afatshkurtër dhe afatgjatë midis variablave të marra në konsideratë për të dalë kështu në disa përfundime shkakësore lidhur me ndikimin që do të mund të kenë Investimet e Huaja Direkte në eksportet vendase dhe anasjelltas.

Pavarësisht rolit vendimtar të luajtur nga IHD-të në ekonomitë e vendeve në tranzicion, specifikisht në rastin e Shqipërisë, të dhënat empirike të vendosura në dispozicion nga institucionet (B.SH, AIDA, INSTAT etj.) janë të fragmentuara dhe jo mjaftueshërisht të qëndrueshme në metodologjinë e mbledhjes së tyre. Një nga treguesit më të rëndësishëm ekonomik sic është Produkti i Brendshëm Bruto, rezulton të publikohet në seri tremujore vetëm pas vitit 2008. Përpara këtij viti PBB-ja rezulton vetëm në interval vjetor.

Ky artikull është i përbërë nga shtatë seksione. Seksioni i parë është hyrës dhe paraqet panoramikën investimeve të huaja në Shqipëri. Seksioni i dytë paraqet një kornizë të

përgjithshme rreth literaturës dhe studimeve të mëparshme. Ndërsa në seksionin e tretë paraqitet metodologjia e huazuar në këtë studim e ndjekur nga seksioni i katërt ku detajohet analiza ekonometrike së bashku me prezantimin e të dhënave dhe zbatimin empirik e testimin e hipotezave. Në seksionin e pestë paraqiten rezultatet, të ndjekura nga diskutimet dhe kufizimet e seksionit të gjashtë. Seksioni i fundit përmbledh përfundimet e studimit.

1.1 Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri

Shqipëria ka një pozicion të mirë gjeografik për të përfituar nga implementimi i projekteve ndërkombëtare dhe për të tërhequr grupe të reja investitorësh. Referuar të dhënave nga Banka e Shqipërisë, energjia dhe minierat përbëjnë pjesën dërmuese të stokut total të IHD-ve, të ndjekura nga sektori i informacionit dhe komunikimit 16% dhe shërbimet financiare 14%. Më pak se 10% e të gjitha IHD-ve në vend janë të fushën e manifakturës. Sipas AIDA, (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve), vendet e BE-së mbeten burimi kryesor i investimeve të huaja direkte në Shqipëri dhe në fund të vitit 2020 zënë 54.2% të stokut total të IHD-ve. Vendet kryesore të burimit të investimeve të huaja direkte përfshijnë Zvicrën (18.9% të stokut), Holanda (16.2%), Kanadaja (12.8%), Italia (9.6%) dhe Turqia (7.2%). Sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit, 12,944 kompani të huaja janë aktive në territorin e Shqipërisë ku, rreth 80% e tyre janë 100% me kapital të huaj (10,231) ndërsa, pjesa tjetër, janë ndërmarrje të përbashkëta (2,713).

Grafiku 1: Fluksi i IHD nga 2009-2020 (mln Euro)



Burimi: BSH, INSTAT, AIDA

Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT vëmë re se pandemia gjatë vitit 2020, goditi edhe investimet e huaja, duke e çuar fluksin e investimeve në ekonominë shqiptare në nivelet e vitit 2016. Gjithashtu, sipas të dhënave të Bilancit të Pagesave për atë vit, IHD u tkurrën me 140 mln Euro ose 13% më pak krahasuar me vitin 2019. Periudha me rënien më të madhe është ajo e tremujorit të dytë, kur pati një bllokim të aktivitetit ekonomik. Ndërsa investimet e huaja direkte nisën një rikuperim gjat fundit të vitit, duke arritur në total një vlerë prej 940 mln Euro, kemi një tregues i cili nuk është ndikuar nga pandemia, sic janë remitancat. Niveli i dërgesave të emigrantëve dhe i përfaqësuesve të diasporës ka mbetur në të njëjtën trajektore. Sipas Instat, industria e nxjerrjes së mineraleve dhe lëndëve djegëse pësoi rënien më të lartë të investimeve gjatë periudhës së dytë të vitit 2020, kjo për shkakë të goditjes që morën lëndët e para e sidomos karburantet në tregjet globale.

2. Rishikimi i literatures¹

Investimet e huaja direkte janë burimi kryesor i financimeve të jashtme në vendet në zhvillim të cilat mund të rrisin prurjet e kapitalit fiks dhe të ndihmojë në përmirësimin e bilancit të pagesave. Sipas UNCTAD-it, IHD kanë potencialin për të gjeneruar punësim, rritje të prodhueshmërisë, aftësi transferuese, teknologji të re, rritjen e eksporteve, si dhe kontribuon në zhvillim afatgjatë ekonomik të vendeve në zhvillim. Punimet e mëparshme të cilat lidhen kryesisht me faktorët përcaktues të IHD-ve në vendet në tranzicion, janë bazuar kryesisht tek faktorët si madhësia e tregut (Škuflić dhe Botrić, 2006) apo në faktorët e gravitetit që shpjegojnë modelin e IHD-ve si afërsia gjeografike, pengesat tregtare, politikat tatimore dhe mjedisi politik (Mateev, 2008; Demekas et al. 2005).

Sipas Janicki dhe Wunnava (2004), tregtia me jashtë është ndoshta faktori më i rëndësishëm i fluksëve të investimeve të huaja direkte tek vendet me ekonomi në tranzicion.


¹ Falenderoj Savra Kurti e cila kontribuoi në rishikimin e literatuës dhe në seksionin e parë.

2.1 Lidhja e investimet e huaja direkte me eksportet

Zhvillimi dhe rritja ekonomike zakonisht përkthehen në më shumë vende pune, më shumë të ardhura për banor, si dhe përparim social. Shumë studime tregojnë se eksporti është një nga kontribuesit më të mëdhenj për rritjen ekonomike (Janicki dhe Wunnava 2004). Pra, vendet që eksportojnë më shumë kanë rritje më të lartë ekonomike, dhe zakonisht kanë model më të qëndrueshëm të rritjes, veçanërisht nëse eksportet janë të shumëllojshme.

Eksportet janë burim i rëndësishëm për zhvillimin e ekonomive të vogla siç është dhe Shqipëria.

Grafiku 2: Flukset 3 mujore të IHD dhe Eksporteve nga 2004-2022 në Shqipëri.



Lidhja mes fluksit të IHD-ve dhe eksporteve, ka tërhequr vëmendjen e studiuesve të ndryshëm.

Në aspektin teorik, parashikimet lidhur mes IHD-ve dhe eksporteve, varen nga natyra horizontale dhe vertikale e IHD-ve (Amiti dhe Wakelin, 2000). Konkurrenca ndërkombëtare që varet nga fluksi i IHD-ve lejon që ekonomia pritëse t'i rrisë eksportet dhe të përmirësojë bilancin e pagesave, dhe në shumë raste, të bëjë lehtësimin e shtrëngimeve financiare ndërkombëtare ndaj rritjes ekonomike. IHD, nëpërmjet të gjitha kontributeve të saj direkte dhe indirekte, mund të shërbejë si shtytës i kryesor në ristrukturimin e ndërmarrjeve, si dhe në ristrukturimin e përgjithshëm ekonomik.

Teoria horizontale e IHD-ve që bazohen në prodhime të produkteve homogjene në vende të ndryshme (Markusen et al, 1996) parashikon lidhje negativ në mes fluksit të IHD-ve dhe tregtisë (eksporteve dhe importeve), duke i

trajtuar IHD-të dhe tregtinë si zëvendësues të njëra tjetrës, kurse teoria vertikale e IHD-ve, që bazohet në zhvillim të procesit prodhues të fragmentuar sipas rajoneve gjeografike dhe niveleve prodhuese parashikon relacion pozitiv në mes IHD-ve dhe tregtisë, duke i trajtuar IHD-të dhe tregtinë si plotësues të njëra tjetrës (Helpman, 1984). Ka shumë autorë që kanë studiuar dhe analizuar ndikimin e investimeve të huaja direkte (IHD) në performancën e eksportit. Disa prej tyre konkludojnë se IHD-të kanë efekte pozitive në ecurinë e eksportit dhe disa nuk e konfirmojnë pasi ka gjetje ku IHD-të nuk kanë ndonjë ndikim në eksport. Megjithatë, studime të shumta empirike gjithashtu konfirmojnë se IHD-të promovojnë eksportet, rrisin vende të reja të punës, ndihmojnë në transferimin e teknologjisë, sigurojnë trajnime për fuqinë punëtore vendore duke përmirësuar aftësitë teknike dhe menaxheriale (Athukorala dhe Menon 1995; Zhang dhe Song 2001; Zhang dhe Felingham 2001; Zhang 2005; Banga 2006; etj). Sipas Aitken dhe Harrison (1999), IHD-të mund të stimulojnë eksportet nga sektorët e brendshëm përmes lidhjeve industriale si dhe eksportet çojnë në rritjen e produktivitetit që më tej tërheq investitorët e huaj për të ndërmarrë IHD-të.

2.2 IHD-të dhe rritja ekonomike në ekonomitë në tranzicion.

Edhe pse ndikimi i IHD-ve në përshpejtimin e produktivitetit është dukshëm më i madh në rastin e vendeve të zhvilluara ekonomikisht, ndikimi pozitiv i IHD me kalimin e kohës bëhet më domethënës në drejtim të marrëdhënieve tregtare ndërkombëtare për vendet me ekonomi në tranzicion (Bačić, Račić, Šonje, 2004).

Shumica e studimeve mbi ekonomitë në tranzicion kanë qenë ndër-shetërore, dhe ka pasur mangësi të kërkimeve për ekonomitë specifike. Kjo është ndoshta për shkak se studimet e një vendi të vetëm mund të ofrojnë vëzhgime të kufizuara. Megjithatë, që nga rënia e komunizmit, ka pasur një nivel i lartë heterogjeniteti ndërmjet ekonomive në tranzicion për shkak se ndryshimet strukturore janë zhvilluar me ritme të ndryshueshme dhe këto ekonomi kanë kushte të ndryshme sociale,

ekonomike dhe politike. Prandaj, meqenëse studimet ndër-shetërore kanë prodhuar rezultate të paqarta, studimet specifike për një vend specifik janë të nevojshme që politikëbërësit pastaj të marrin vendime të posacme sipas kushteve ekonomike të vendit.

Duke marrë parasysh marrëdhëniet e ndërsjella të IHD-ve, PBB-së dhe eksporteve, Ahmadi dhe Ghanbarzadeh (2011) arriti në përfundimin se ekziston një lidhje pozitive midis këtyre të tre variablave makroekonomikë. Gjithashtu këta autorë argumentojnë se ndryshimet në rezultate shpesh kanë një shkak ekonometrik në metodat që përdoren, si dhe në ndryshoret, që mund të merren në terma nominale ose realë.

Kështu, Campos dhe Kinoshita (2002) analizuan të dhëna nga 25 vende në tranzicion të Evropës Lindore ndërmjet viteve 1990 dhe 1998 duke evidentuar efektin e rëndësishëm pozitiv të IHD-ve në rritjen ekonomike prej transferimit të teknologjisë dhe njohurive tek industrinë e vendit pritës.

Sapienza (2010), duke përdorur të dhëna nga 25 ekonomi në tranzicion të Europës Lindore nga 1990 deri në 2005, doli në një përfundim krejt tjetër. Ai zbuloi se efekti i flukseve aktuale hyrëse të IHD-ve tek PBB-ja ishte dukshëm negativ, por që përdorimi i koeficientëve me distance kohore çonte në një efekt pozitiv afatgjatë. Kjo sugjeroi që firmat ndërkombëtare fillimisht largojnë firmat vendase, duke çuar në një rënie në rritjes ekonomike edhe pse efektet pozitive të pranisë së tyre në vendin pritës realizohen me kalimin e kohës.

Ndryshe nga Sapienza (2010), Curwin dhe Mahutga (2014) duke analizuar 25 vende të Evropës Lindore nga 1990 në 2010, arritën në përfundimin e fortë se flukset hyrëse të IHD-ve ulën ritmet e rritjes ekonomike si në terma afatshkurtër ashtu edhe në ato afatgjatë.

Lidhur me të dhënat statistikore që janë baza për llogaritjet e ndikimit të IHD-ve në treguesit makroekonomikë, autorët në disa studime të mëparshme sugjerojnë që rezultatet mund të humbin rëndësinë e tyre kur analiza përfshin shumë vende që janë në të njëjtën kohë në faza të ndryshme dhe nivelet të ndryshme të zhvillimit ekonomik, gjë që tregon për domosdoshmërinë e ndarjes së të dhënave seri

për vendet e zhvilluara dhe vendet në zhvillim (Johnson, A., 2005). Ky autor gjithashtu rekomandon që të shmangen seritë e shkurtra kohore, për shkak të efekteve të cikleve afatshkurtra të biznesit.

Duke e marrë në konsiderate heterogjenitetin e të dhënave midis IHD-ve, eksporteve, dhe rritjes ekonomike, Acaravci dhe Ozturk (2012), analizuan individualisht dhjetë ekonomi në tranzicion për vitet midis 1994 dhe 2008, duke përdorur vonesat e shpërndara autoregresive për të gjetur marrëdhëniet afatgjata si dhe duke përdorur testin e shkakësisë apo kauzalitetit të Granger të bazuar në korigjimin e gabimeve për të vlerësuar kauzalitetin afatgjatë dhe afatshkurtër ndërmjet këtyre variablave duke gjetur kauzalitet të variablave vetëm tek katër vende. Në tërësi, ata arritën në përfundimin se IHD-të janë një stimulues më efektiv të rritjes ekonomike sesa eksportet dhe se IHD-të duhet të promovohen nga politikëbërësit.

Nga ana tjetër, Kutun dhe Vukšić (2007) sugjerojnë që IHD-të dhe eksportet ndërveprojnë për të stimuluar rritjen ekonomike. Duke hetuar 12 vende të Europës Qender-Lindore nga 1996 deri në 2004, studimi i tyre tregoi se IHD-të rrisin kapacitetin e ofertës së një ekonomie, e cila, nga ana tjetër, rrit eksportet. Kjo u zbulua të jetë më e rëndësishme sesa efektet specifike të IHD-ve që lindin nga transferimet e njohurive dhe teknologjisë nga firmat ndërkombëtare.

2.3 Studimet e ngjashme mbi ekonominë shqiptare

Literatura për Shqipërinë e periudhës së tranzicionit është e karakterizuar nga disa përfundime të paqarta:

Boriçi dhe Osmani (2015) hetuan marrëdhënien ndërmjet IHD-ve dhe rritjes ekonomike në Shqipëri. Analiza e kointegrimit e të dhënave të serive kohore zbuloi një lidhje të rëndësishme afatgjatë midis IHD-ve dhe rritjes së PBB-së. Ata sugjeruan se Shqipëria duhet të investojë më shumë në ekonominë e saj për të tërhequr më shumë IHD.

Hysa dhe Hodo (2016) ekzaminuan efektet reale të IHD-ve në rritjen ekonomike të Shqipërisë duke përdorur metodën e

kointegrimit për të dhënat tremujore nga viti 1991 deri në vitin 2012. Gjetjet empirike të këtij studimi tregojnë një korrelacion të fortë ndërmjet rritjes së PBB-së dhe raportit të IHD-ve ndaj PBB-së, gjë që tregon kontributin e saj të rëndësishëm në rritjen ekonomike.

Përtej këtyre rezultateve, Golitsis et al. (2018) testoi efektin e remitancave dhe IHD-ve në rritjen ekonomike, duke përdorur të dhënat tremujore ndërmjet viteve 1996 dhe 2014 nga Banka Botërore. Nga përdorimi i testit të shkakësisë së Granger dhe i testit VAR, ata zbuluan se remitancat shkaktojnë rritje ekonomike në terma afatshkurtër dhe afatgjatë, ndërkohë që IHD-të duket se nuk kanë lidhje me rritjen ekonomike. Kjo do të tregonte se transfertat nga emigracioni për të mbështetur familjet e tyre rezultojnë më shumë domethënëse se IHD.


Gjithashtu, Demeti dhe Rebi (2014) pohuan argumentin se IHD-të nuk e mbështesin nxitjen e zhvillimit ekonomik në Shqipëri. Studimi përdori të dhëna nga periudha ndërmjet 2002 dhe 2013, duke përdorur koeficientin e korrelacionit të Pearson dhe testin e shkakësisë së Granger. Ky studim zbuloi megjithatë një lidhje pozitive midis IHD-ve dhe produktivitetit të punës, që është a treguesi kryesor i zhvillimit ekonomik. Arsyeja për këtë ishte se sektorët më produktivë të Shqipërisë kanë tërhequr më shumë IHD duke sjellë si shembull sektorin e hidrokarbureve i cili zë një pjesë të konsiderueshme në stokun e IHD-ve të Shqipërisë gjatë kësaj periudhe.

Së fundmi, Hobbs, S., Dimitrios P., dhe Mostafa E. A. (2021), studiuuan rastin e Shqipërisë me të dhënat vjetore të mbledhura prej 1992 deri 2016 dhe gjetën marrëdhënie afatgjata midis tregtisë, rritjes ekonomike dhe IHD-ve. Ata gjetën se eksportet ishin më efektive në nxitjen e rritjes ekonomike sesa IHD-të pasi, sipas testeve me VECM, kishte një varësi më të fortë ndërmjet eksporteve dhe rritjes së PBB-së. Si përfundim, edhe pse në këtë studim të tyre nuk u gjet një shkakësi nga flukset hyrëse të IHD-ve për tek eksportet, ka një mbështetje të fortë për shkakësinë e anasjelltë, nga eksportet në flukset hyrëse të IHD-ve. Ky rezultat duket se mbështet pohimin se politikat gjithnjë e më të hapura tregtare të Shqipërisë kanë qenë tërheqëse për investitorët e huaj. Kjo me shumë

gjasa ndodh sepse liberalizimi i tregtisë çon njëkohësisht në eksporte dhe prurje IHD më të larta.

Në përgjithësi, në rastin e Shqipërisë, rezultatet empirike janë të paqarta dhe nuk parashikohet qartësisht roli i flukseve hyrëse të IHD-ve si tek rritja apo zhvillimi ekonomik ashtu dhe tek ndikimi në eksportet e vendit pritës. Nga ana tjetër, shumica e gjetjeve sugjerojnë se rritja dhe zhvillimi ekonomik shkaktojnë rritje të flukseve hyrëse të IHD-ve.

Grafiku 3. Flukset hyrëse të IHD (në % të PBB-së) në Shqipëri 1990-2020.



Burimi: Banka Botërore, FMN.

Në grafikun 3, përtej trendit rritës në tërësi, dallohet se nga viti 2010, kemi një rënie të % së IHD në raport me PBB edhe pse si vlerë absolute, nga grafiku 1, flukset hyrëse të IHD janë në rritje gjatë gjithë këtyre viteve.

Politikat tregtare të Shqipërisë mund të karakterizohen si promovuese të eksporteve. Si tendenca në shumicën e ekonomive në tranzicion tregojnë se kur rriten IHD-të, rriten edhe eksportet. Prandaj, hulumtimi në marrëdhëniet ndërmjet IHD-ve, tregtisë dhe PBB-së do të ndihmojë së kuptuari efektivitetin e politikave të tregtisë së hapur të Shqipërisë në mënyrë më të përshtatshme sesa kërkimi i ngushtë midis IHD dhe PBB.

Kufizimet e studimeve të mëparshme, lidhen me seritë e shkurtra kohore të variablave të përfshira në analizën e tyre pasi duke përdorur të dhëna vjetore, rezultoni në një numër të kufizuar vrojtimesh. Një numër i vogël i të dhënave nuk lejon përfshirjen në model të një numri më të mjaftueshëm variablash, që në të kundërt do të ndihmonte në një shpjegim më

të mirë të mënyrës së ndërveprimit të variablave makroekonomike me njëra-tjetrën dhe rezultate më të besueshme të testimeve ekonometrike.

3. Metodologjia

Edhe pse marrëdhënia ndërmjet IHD-ve, rritjes ekonomike dhe eksporteve është hulumtuar gjerësisht, ka pasur megjithatë shumë vështirësi në përcaktimin sasior të kësaj lidhjeje pasi metodat ekonometrike dhe variablat shpjegues ndryshojnë dhe shpesh janë unike për studimet e reja, të cilat mund të çojnë në rezultate dhe interpretime të diskutueshme (Sapienza 2010).

Meqenëse studimet për rastin e Shqipërisë kanë rezultuar me paqartësi mbi marrëdhënien e variablave të mësipërme dhe ka ende pak studime që kanë gjetur se mund të ketë një marrëdhënie të dyanshme ose endogjene ndërmjet IHD-ve, ka ende një interes për të hulumtuar më në detaje dhe me të dhëna të përditësuara për të testuar marrëdhënien dhe ndikimin mes IHD-ve, eksporteve dhe rritjes ekonomike duke përdorur të njëjtat metoda ekonometrike për të kuptuar më mirë ndikimet shkakësore midis variablave.

Pyetjet kërkimore të studimit janë si në vijim:

- H1: Si ndikojnë flukset hyrëse të IHD-ve dhe rritja ekonomike (PBB) në eksportet Shqiptare?
- H2: Dhe anasjelltas, cili është ndikimi i eksporteve dhe PBB tek flukset hyrëse të IHD-ve?

Për t'u përgjigjur këtyre pyetjeve përdorim një model të përgjithshëm makroekonomik me variablat e mësipërme.

$$\text{Exporte}_t = f(\text{Exporte}_{t-k}, \text{IHD}_{t-k}, \text{PBB}_{t-k}) \quad (1)$$

$$\text{IHD}_t = f(\text{IHD}_{t-k}, \text{Exporte}_{t-k}, \text{PBB}_{t-k}) \quad (2)$$

ku IHD-të përfaqësojnë flukset hyrëse të Investimeve të Huaja Direkte të matura në miliona Euro; Eksportet përfaqësojnë hapjen ekonomike; PBB është Prodhimi i Brendshëm Bruto, të matura sipas njësisë kohore t .

Fillimisht të dhënat e serive kohore do testohen për rrënjët njësi, më pas do të testohet midis variablave shkakësia sipas Granger, si dhe ko-integrimi dhe Modeli i Korrigjimit të Gabimit (VECM) për të hetuar në lidhje me marrëdhëniet afatshkurtra dhe afatgjata ndërmjet IHD-ve, eksporteve dhe rritjes ekonomike.

4. Analiza Ekonometrike

Modeli i pergjithshem VECM mund të shkruhet si më poshtë:

$$\Delta Y_t = \beta_0 + \sum_{j=1}^k \beta_j \Delta Y_{t-j} + \sum_{i=1}^k \delta_i \Delta X_{t-i} + \varphi_i Z_{t-1} + \varepsilon_t$$

ku Z është termi i korrigjimit të gabimit (ECT) dhe përfaqëson mbetjet e OLS nga periudha afatgjatë e regresionit të kointegrimit. Ky model mund të shprehet në dy në ekuacionet sipas dy hipotezave të parashtruara:

$$\Delta \ln \text{Exp}_t = \alpha_1 + \sum_{j=1}^{k_1} \beta_{11j} \Delta \ln \text{Ekspt}_{t-j} + \sum_{j=1}^{k_2} \beta_{12j} \Delta \ln \text{IHD}_{t-j} + \sum_{j=1}^{k_3} \beta_{13j} \Delta \ln \text{PBB}_{t-j} + \phi_1 \text{ECT}_{t-1} + U_{1t} \quad (1.1)$$

$$\Delta \ln \text{IHD}_t = \alpha_2 + \sum_{j=1}^{k_1} \beta_{21j} \Delta \ln \text{IHD}_{t-j} + \sum_{j=1}^{k_2} \beta_{22j} \Delta \ln \text{Ekspt}_{t-j} + \sum_{j=1}^{k_3} \beta_{23j} \Delta \ln \text{PBB}_{t-j} + \phi_2 \text{ECT}_{t-1} + U_{2t} \quad (2.1)$$


recipient categories, and any other information that is necessary to guarantee the fair and lawful processing of the data (15). Even the health care system must guarantee the privacy of the patient in every case. To this end, healthcare professionals must respect the three key principles of confidentiality. Each patient has the fundamental right to privacy and confidentiality of his/her health information. Each patient has the right to control over the dissemination of his or her health information through explicitly granted or withdrawn consent. For any non-inconsistent dissemination of confidential information from healthcare professionals, account should be taken of the necessity of proliferation, proportionality and accompanying risks.

The role of media is essential in society. However, despite our willingness to be informed of everything, the law provides some reasonable limits on the journalists' space to receive information. Despite the public profile, every person has the right to be respected in his private and family life. This reflects the fact that journalists can not interfere in any individual's privacy without their consent. It is unacceptable to publish photographs of persons in private places without their consent. Another limitation for journalists is the ban on entering into a house without permission or receiving images from a private environment (16). Every country finds it difficult to determine the relationship between media and privacy. This is clearly demonstrated in the approach of the European Court of Human Rights in the case of Von Hannover v. Germany. The Court, recognizing the cultural differences between states, argued that the ECHR member states have their own discretion if there is a conflict between the right to information and privacy (17). The Albanian constitutional court, in the typical case of the interference of two rights in the issue of the disclosure of personal and property data of officials, has argued that within the framework of the right to information, officials should publish their property (18). The Constitutional References and the ECHR practice have led the court towards a decision-making in the function of transparency.

5. Conclusions

It is always difficult to judge the precedence of two constitutional rights. It is a challenge to put the right to information about the right to privacy. In practice we pretend to practice both at the

same time, but this is not always possible. In some circumstances we are forced to choose. Most of the time, the two rights complement each other. However, there are conflicts, for example, privacy laws often are improperly invoked by governments. And there are cases where the conflicts are legitimate (19). A democratic society should be guided by the fulfillment of the right to information, transparency and accountability. Involving the public at all stages of designing a policy would guarantee its success in the future. The question is: what is the limit allowed by law to be informed? The common law legal approach is characterized by a clear freedom of information and expression. Limitations are much lower in relation to the civil law legal family. Researchers share different opinions on this issue, but they agree on the fact that each state can resolve this issue by its own method. This proves that the key element is the context. So the democratic culture of a state, legal traditions, economic and social circumstances are the components that need to be taken into consideration in order to reach the right solution. The right to information is as important as it is the protection of personal data. Everyone chooses not to publish some elements of their private life. In this context, the state must show proper care in the balance between rights. It is very delicate the limit between these rights. As a part of the public we all demand transparency and information on everything that happens but at the same time as persons with moral and professional integrity we require from public institutions to show the necessary care in the protection of our personal data. Often the unauthorized disclosure of personal data, especially of public persons, may cause unrecoverable consequences in their personal and professional life. The law is not always the only solution to the conflict between the rights. It is also required a high legal certainty to exercise our rights without violating the rights of others.

References

1. *Constitution of the Republic of Albania, Article 23*
2. Omari L., Anastasi A., (2008) "E drejta kushtetuese" [Constitutional Law], Tirana, ABC
3. *Universal Declaration of Human Rights (UDHR), article 19*
4. Mendel, Toby., (2008) *Freedom of Information: A Comparative Legal Survey. 2nd ed. Paris, France: United Nations Educational, Scientific, and Cultural Organization*
5. *African Commission on Human and Peoples' Rights - ACHPR (2002) "Declaration of Principles on Freedom of Expression in Africa." Banjul, The Gambia. Available online at : www.achpr.org/english/declarations/declaration_freedom_exp_en.html*
6. Toby Mendel., (2008) "Freedom of Information: A Comparative Legal Survey" UNESCO - Paris
7. *Law no. 119/2014 For the Right to Information, Article 1*
8. *Law no. 119/2014 For the Right to Information, Article 17*
9. *Order of the Commissioner for Information and Protection of Personal Data no. 14/2015 For Approval of the Transparency Model Program*
10. *European Convention on Human Rights, Article 10*
11. Study., (2016) "Privatësia dhe siguria e të dhënave personale gjatë përdorimit të rrjeteve sociale nga moshë 15-18 vjeç" [Privacy and Security of Personal Data During the Application of Social Networks from 15-18 Age], Commissioner for the Right to Information and Protection of Personal Data. Retrieved from http://www.idp.al/wpcontent/uploads/2017/02/Studimi_privatesia_dhe_siguria_e_t_e_dhenave_botim_2016.pdf
12. *Law no. 9887/2008 On Protection of Personal Data, Article 3 (1)*
13. *Law no. 9887/2008 On Protection of Personal Data, Article 3 (4)*
14. Zaganjori Xh., Vorpsi A., Biba D., (2012) "Parime kushtetuese dhe të drejta themelore në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese" [Constitutional and fundamental principles in the jurisprudence of the Constitutional Court], Tirana, Konrad Adenauer Stiftung
15. *Direction No. 4/2010 On the personal security measures in the field of education activities*
16. *Direction No. 9/2010 Basic rules on the protection of personal data in the written, visible and audiovisual media*
17. *ECHR (June 2004) Case of Von Hannover v. Germany (Application No. 59320/00)*
18. *Decision No 16/2004 Publication of personal and property records of officials*
19. Banisar, David. 2011. *The Right to Information and Privacy : Balancing Rights and Managing Conflicts. World*

Bank Institute governance working paper series; World Bank, Washington, DC. © World Bank. Available online at : <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/23022>

SHKENCAT MJEKËSORE DHE SHËNDETËSORE

Aktivizimi dhe motivimi i nxënësve në kushtet e izolimit nga pandemia Covid-19

Dr. Asllan Vrapi

Lektor

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

asllan.vrapi@univlora.edu.al

Abstrakt

Në këtë studim synohet të hulumtohet aktivizimi dhe motivimi i nxënësve në procesin mësimor në kushtet e pandemisë Covid-19 në Republikën e Shqipërisë. Në mars 2020 sikurse në shtetet e tjera edhe arsimit në Shqipëri u gjend përpara dilemës së madhe se si do të zhvillohej mësimdhënia në kushtet e izolimit nga pandemia. Parprakisht theksojmë së familjet shqiptare, përgjithësisht, kanë në përdorim pajisje kompjuterike si telefona smart, laptop, tablet apo kompjuter tavoline. Në Shqipëri ekziston rrjeti kabllor i internetit pothuajse për çdo familje. Gjithashtu, theksojmë se kishte familje me mungesa pajisjesh kompjuterike dhe aksesit në internet.

Gjetjet kryesore të hulumtimit mbi zhvillimin e procesit mësimor në kontekstin e pandemisë, rezultojnë: Problematika fillestare të mosbesimit mbi zhvillimin e mësimdhënies online, sfidat kryesore në sektorin arsimor që lidhen me aftësitë dixhitale të pamjaftueshme për përdorimin e platformave mësimore nga mësuesit dhe nxënësit, vështirësitë në përgatitjen e materialeve mësimore për transmetimin e përmbajtjes lëndore në distancë, aspekte të motivimit dhe angazhimit të nxënësve në mësimnxënien online.

Fjalët kyçe: *pandemia covid-19, arsimimi, motivimi, aftësi dixhitale, mësimdhënia on-line, pajisje kompjuterike, platforma mësimore.*

Abstract

This study aims to investigate the education and motivation of students in the conditions of the COVID 19 pandemic in the Republic of Albania. In March 2020, as in other countries, education in Albania was faced with the great dilemma of how teaching would take place in conditions of isolation from the pandemic. We emphasize in advance that Albanian families, in general, use electronic devices such as smartphones, laptops, tablets, or desktops. In Albania, there is a cable internet network for almost every family. We also point out that there were families with a lack of computer equipment and internet access.

The main findings of the research on the development of the learning process in the context of the pandemic, result: Initial problems of distrust over the development of online teaching, the main challenges in the education sector related to insufficient digital skills for teachers and students to use learning platforms, difficulties in preparing teaching materials for the transmission of subject content at a distance, aspects of motivation and engagement of students in online learning.

Keywords: *Covid 19 pandemic, education, motivation, digital skills, online teaching, computers equipment, learning platforms.*

Hyrje

Pandemia Covid 19 shërbeu si shtysë për përdorimin e pajisjeve teknologjike në arsimin e në distancë. Lidhur me rëndësinë e teknologjisë dixhitale në funksionalitetin e veprimtarisë njerëzore në kushtet e izolimit nga pandemia, Komisioni Evropian ka nënvizuar: "Teknologjia dixhitale është një komponent kyç i përpjekjeve kolektive për të trajtuar virusin dhe për të mbështetur mënyra të reja për të jetuar dhe punuar në realitet gjatë kësaj kohë të jashtëzakonshme" (Komisioni Evropian, 2021). Pajisjet kompjuterike luajtën një rol shumë të rëndësishëm për komunikimin, informimin dhe mbi të gjitha për arsimimin e nxënësve në kushtet e izolimit, larg institucioneve arsimore. Plani i Veprimit për Arsimin Dixhital 2021–2027 është një dokument i prezantuar nga Komisioni Evropian në kushte e krijuara nga pandemia. Në këtë dokument, lidhur me mësimdhënien online theksohet: "Plani i Veprimit për Arsimin Dixhital 2021–2027 mbështet më tej zhvillimin e të mësuarit online në nivele të ndryshme të arsimit në të gjithë Evropën" (Evropian Komisioni, 2020).

Bazimi teorik

Për realizimin e mësimdhënies në distancë janë të domosdoshme plotësimi nga mësuesi i disa kushteve paraprake.

Së pari, të ketë në përdorim pajisje kompjuterike dhe internet.

Së dyti, të zotërojë kompetenca dixhitale për krijimin e klasave dixhitale, përgatitjen, përshtatjen, ngarkimin transmetimin, etj. të materialeve mësimore.

Së treti, të disponojë një platformë mësimore, të disponojë një llogari aksesit në platformë.

Së katërti, të jetë i aftë të ndërtojë një sistem vetërregullues dhe menaxhues të procesit.

Së pesti, të harmonizojë komunikimin, të nxisë dhe sigurojë aktivizimin dhe motivimin e nxënësve apo studentëve.

Shembuj të zhvillimit të mësimdhënies në distancë ekzistojnë edhe përpara pandemisë por izolimi prej saj i bëri pajisjet kompjuterike dhe internetin dy element bazë për zhvillimin e mësimdhënies në distancë. Lidhur me masat paraprake studiuesi Lee shkruan "E rëndësishme në këtë periudhë ishte "përmirësimi i aftësive të ndryshme (të tilla si vetërregullimi) dhe kompetencat" (Lee. etj. 2019).

Duke patur parasysh shpejtësinë e zhvillimit sidomos të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në ndihmë të mësimdhënies në distancë do të rikujtoj një konstatim në punimin tim, në revistën Education, Society and Human Studies, në të cilin theksoj: "Në fillim të këtij shekulli, bota ka lëvizur me hapa të mëdhenj. Edhe mësimdhënia është duke u transformuar" (Vrapi, A. 2022 www.scholink.org/ojs/index.php/eshs). Duke mbështetur transformimet e mësimdhënies drejt aktivizimit dhe motivimit të nxënësve në të nxënë, studiuesi Tome thekson: "Duke qenë se të vërtetat ndryshojnë vazhdimisht, ndodh një lloj negocimi se cilat do të pranohen ose nuk do të pranohen për t'i dhënë kuptim gjërave, ngjarjeve dhe vetë qenies njerëzore" (Tome, S. M. J. 2021. www.scholink.org/ojs/index.php/eshs). Në vazhdim të idesë së mësipërme studiuesi vazhdon: "Nëse është kështu, është kontradiktore të përpiqesh ta bësh mësimdhënien një proces të thjeshtë të transferimit të informacionit nga një lëndë që jep mësim (mësues ose trajner) në një lëndë që mëson (student ose nxënësi)" (Tome, S. M. J. 2021. www.scholink.org/ojs/index.php/eshs). Një nga ndryshimet më të mëdha në formë, në përmbajtje, në proces dhe në rezultatet e pësoi mësimdhënia gjatë zhvillimit të saj në kushtet e pandemisë Covid 19. Në kushtet e izolimit për arsye të mbrojtjes nga pandemia u kalua nga mësimdhënia ballë për ballë në klasë në mësimdhënien në distancë. Gjatë mësimdhënies në distancë u aplikuan dy forma të zhvillimit të saj përse i përket leksioneve: zhvillimi i leksioneve direkt ose dërgimi i leksioneve të regjistruara më parë. Seancat e detyrave,

seminareve, projekteve kurrikulare si rregull u zhvilluan direkt.

Problematika të mësimdhënies në distancë

Një nga problematikat e vërejtura gjatë zhvillimit të mësimdhënies on-line ishte mosbesimi dhe vështirësia e aplikimit të mësimdhënies në distancë sepse deri atëherë mësuesit ishin mësuar më mësimdhënien në klasë. U vu re një reagim mosbesimi. Mësuesit dhe nxënësit hezituan t'a aplikonin atë. Me kalimin e ditëve: "Akademikët duhej të përshtasnin mundësinë e arsimit në internet, fokusi ishte në mësimin e mjeteve për të siguruar që studentët të përfitonin maksimalisht nga mësimdhënia dhe vlerësimet duhej të rishikoheshin për të përshtatur transmetimin në internet" (Ramnund-Mansingh, A. 2020. 33). Në ditët e para u vu re mungesë dëshire madje braktisje e mësimdhënies që sikurse thekson Blicek: "Në mënyrë më të detajuar, faktorët e suksesit të mësimin të rritur në internet që adresojnë sfidat në lidhje me shkallën e lartë të braktisjes janë si më poshtë: besueshmëria, transparenca, fleksibiliteti, aksesueshmëria, interaktiviteti, personalizimi dhe produktiviteti" (Blicek, 2019a). Në një periudhë të shkurtër, institucionet arsimore ofruan platforma mësimore për zhvillimin e mësimdhënies në distancë. Brenda datës 15 mars 2020, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë hapi kanale televizive si RTSH-Shkolla, kanali Youtube i MASR, etj., të cilët transmetonin 24 orë pa ndërpreje programe televizive mbi zhvillimin e orëve mësimore sipas programit mësimor për nxënësit e klasave 1-12 (Sondazhi i dytë i MASR. 4-9 Prill 2020). Shumë nxënës nga familje të varfra u pajisën me pajisje kumpjuterike si tablet dhe telefona smart për të ndjekur mësimet në distancë. Sikurse kemi theksuar në një konferencë të organizuar në nëntor 2020, në Novosibirsk: "Një nga shqetësimet që shoqëron mësimin e studentëve në shtëpi është nëse kanë akses në pajisjet kompjuterike dhe akses në internet. I përmendim këto kushte sepse mungesa e tyre pengon komunikimin dhe përfshirjen në mësimin në distancë" (Vrapi, A. dhe Vrapi, F.

2020. 43). Për këtë qëllim ne theksonim: "Përdorimi i pajisjeve teknologjike në kohën e pandemisë është një zgjidhje për zhvillimin e mësimdhënies por edhe një ndjenjë për të rritur entuziazmin e nxënësve për t'u përfshirë në mësim" (Vrapi, A. dhe Vrapi, F. 2020. 43)

Gjatë arsimimit dhe trajnimit mësuesit kishin marrë njohuri paraprake fillestare mbi zhvillimin e mësimdhënies në distancë por aplikimi i njohurive dixhitale në praktikën e mësimdhënies në distancë nuk ishte i lehtë. Të gjendur në vështirësitë e përdorimit të platformave mësimore, të përgatitjes së materialeve mësimore dhe ngarkimit të tyre në rrjet, mësuesit kuptuan nevojën dhe i'u nënshtruan trajnimeve specifike dixhitale. Disa nga platformat elektronike të përdorura ishin Google Classroom, Zoom, Moodle, Google Hangouts, Loom, GoToMeeting, School of the Future, WhatsApp ose sisteme të tjera të menaxhimit të kurseve (CMS).

Një nga vështirësitë e vërejtura gjatë zhvillimit të mësimdhënies në distancë është vështirësia për të motivuar nxënësit. Një nga arsytet është se: "Mësimi i studentëve të rritur kërkon optimizimin dhe personalizimin i mbështetjes së tyre" (Vanslambrouck, etj., 2019).

Një nga vështirësitë gjatë mësimdhënies është motivimi i mësuesve për zhvillimin e saj. Sikurse shprehen autorët Stranovská, E. Lalinska, M. dhe Bobonova, I: "Ne e konsiderojmë motivimin si një faktor të rëndësishëm për suksesin arsimor të mësuesit sepse ai tregon për orientimin në vlerë, i cili përcakton nevojat e mësuesit dhe nivelin e aspiratës së tij" (Stranovská, E. Lalinska, M. & Bobonova, I. 2017).

Në këtë këndvështrim mësimdhënia në distancë shoqërohet me vështirësitë e zhvillimit të mësimdhënies së diferencuar për t'u përgjigjur nevojave, aftësive, dëshirave dhe gadishmërive të nxënësve në mësimnxënie. "Studentët janë të ndryshëm nga njëri-tjetri, të gjithë kanë kërkesa të veçanta, të gjithë perceptojnë, të gjithë dëgjojnë, të gjithë flasin, të gjithë mendojnë, të gjithë mësojnë ndryshe nga njëri-tjetri, ndaj të gjithëve duhet t'i jepet mundësia" (Vrapi, A. , 2022 www.scholink.org/ojs/index.php/eshs). Disa studiues theksojnë: "Edhe pse vështirësia e

të mësuarit shfaqet ndryshe në moshë të ndryshme, studentët tashmë në vështirësi janë më të ndikuar nga mbyllja." (Allensworth, E. dhe Schwartz, N. 2020). Gjithashtu, disa studiues mendojnë se gjithë mësimdhënies online mësuesit e gjejnë më shpejt ritmin e mësimdhënies. "Me mësimin online, përdoruesit/mësuesit e arsimit mund të gjejnë më lehtë ritmin e duhur të të mësuarit të shkencës për studentët" (Jayul, A. dhe Irwanto, E. 2020).

Në mësimdhënien online nxënësve u mungon bashkëpunimi dhe ndërveprimi i nxënësve me njëri-tjetrin. Në këto kushte ndryshe nga mësimdhënia në klasë ku: "... problemi përfshin nxënësit si pjesë të kontekstit, është thelbësore të sigurohet që historia të pasqyrojë realitetin e nxënësve në klasë" në mësimdhënien online nxënësit gjenden përpara vështirësisë nga të mësuarit vetëm, larg ambientit të saj" (Widjaja, W. 2013). E rëndësishme është që mësuesit të përqëndrohen në ato strategji, metoda dhe teknika mësimore që i bëjnë nxënësit të mësojnë. "Ajo që kërkohet nga studentët nuk është vetëm memorizimi i njohurive dhe informacionit, por edukimi duhet të fokusohet në atë se si t'i mësojë studentët të mësojnë në mënyrë që të menaxhojnë kërkesat dhe ndryshimet e vazhdueshme" (Vrapi, A. 2022 www.scholink.org/ojs/index.php/eshs).

Nxënësit të cilët janë të motivuar për të mësuar detyrat në një nivel të caktuar, sipas aftësive të tyre, nisin veprime kur kanë mundësi për t'a bërë këtë dhe tregojnë interes dhe përqendrim të madh në zbatimin e detyrave. Ata në përgjithësi shfaqin emocione pozitive gjatë mësimin, duke përfshirë optimizmin, entuziazmin, kuriozitetin dhe interesin. Është i njohur fakti se nxënësit mësojnë duke bashkëvepruar në një ambient social. Duke u fokusuar tek rëndësia e teorisë së të nxënësve social disa autorë theksojnë: "Duke punuar në bashkëpunim me bashkëmoshatarët dhe duke marrë udhëzime nga një lehtësues (mësues), kjo teori parashtron se nxënësit mësojnë përmes angazhimit aktiv me një problem" (Nancy K. DeJarnette, Ruba S. Deeb dhe Pallis, J. 2021). Në mësimdhënien në distancë në krahasim me mësimdhënien në klasë nxënësit ndodhen në

kushte të ndryshme përse i përket gjendjes emocionale. Mungon atmosfera e klasës, ndryshojnë bashkëveprimi, ndërveprimi, ndjenja e përgjegjësisë e nxënësit në raport me nxënësit e tjerë dhe me mësuesin, ndryshon gjendja emocionale. "Si pjesë integrale e mënyrës sesi njerëzit mësojnë, proceset emocionale duhet të merren parasysh kur shkollat planifikojnë përvoja mësimore për nxënësit. Diversiteti brenda shkollave të shekullit të 21-të e bën më sfidues adresimin e nevojave emocionale të nxënësve" (Caroline L. South dhe Nancy Delarnette. 2022). Kur diskutojmë dhe analizojmë mësimdhënien në distancë, ne duhet të veçojmë mësimdhënien në distancë të realizuar këto dy vitet e fundit si një mësimdhënie të zhvilluar në kushte krejt të veçanta, jo vetëm arsimore por edhe sigurisë dhe rrezikut për jetën, mungesës së perspektivës humbjeve financiare që përsuan familjet e nxënësve gjatë pandemisë. "Nxënësit mund të ndeshen me vështirësi të shumta në kurset e tyre këtë vit – jo vetëm ndërprerje në mësimdhënie dhe të nxënësve, me kalimin në mësim në distancë, por edhe stres dhe traumë nga vetë kriza dhe humbje në burimet financiare të familjes." (Allensworth, E. dhe Schwartz, N. Qershor 2020).

Stresi dhe gjendja e rënduar psikologjike ishte shoqëruese e pasigurisë për shëndetin personal dhe të familjes gjatë periudhës së pandemisë

Duke iu referuar përshkrimin të mësipërm dallojmë dy çështje që duhen konsideruar shumë më tepër të rëndësishme në drejtim të mësimdhënies në distancë që janë:

1. veprimi dhe
2. entuziazmi.

Në kushtet e pandemisë, të dy këta tregues shfaqen të ndryshuar. Veprimi për të bërë diçka është i kufizuar në mjedisin e shtëpisë, i izoluar fizikisht nga nxënësit e tjerë, prania dhe ndikimi i mësueses nuk është si më parë. Hapësira e lirisë ndryshoi, tani studenti nuk është nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të mësuesit, ai mund ta ndjekë mësimin kur të dojë, mund të

kthehet për të parë e dëgjuar leksionin sa herë të dojë, mund të vërë në dukje paqartësitë, dhe mund të bëjë pyetje për sqarim pa ndrojtjen e zakonshme që shoqëron shumë nxënës në klasë. Akti i të bërit diçka është i ndryshëm nga ai në klasë. Realiteti në ndryshim i kësaj pandemie e bënte jashtëzakonisht të vështirë përqendrimin në kërkime dhe klasa për shumë njerëz, por gjithashtu e bënte të qartë se mësuesit dhe nxënësit do të ishim në këtë "normale të re" për një kohë të gjatë. Ndikimi i rrezikshëm i prekjes së tij dhe anëtarëve të tjerë nga covid-19 ka sjellë një gjendje tjetër entuziazmi. Pandemia ka ndryshuar humorin e nxënësit dhe mësuesit. Ndikimi i mjeteve të komunikimit dhe informacionit si: rrjetet sociale, pajisjet kompjuterike, TV, radio etj kanë ndikuar në gjendjen mendore dhe entuziazmin e nxënësit. Koncepte të tilla si kuptimi i numrit, marrëdhëniet numerike, shkronjat dhe objektet e ndryshme, shoqërizimi, simetria ose asimetria, zhvendosja, lëvizja, forma të ndryshme të planit dhe hapësinor, të njëjtat koncepte, të ndryshme ose të kundërta, konceptet e kohës, të varësisë ose jo, janë disa nga konceptet e shumta që nxënësi ndesh vazhdimisht gjatë procesit mësimor bazuar në përdorimin e pajisjeve kompjuterike.

Institucionet arsimore paraqitën vështirësi në institucionalizimin e mësimdhënien në distancë. Institucionet arsimore prezantuan përpjekje për realizimin e mësimin në distancë në mënyrë që të kishin ndikim sa më të madh në aktivizimin dhe motivimin e nxënësve në të nxënë, duke pasur parasysh edhe faktin se pandemia globale nuk kishte perspective optimiste përfundimi.

Shtrimi i problemit. Në kushtet e izolimit nga pandemia përdorimi i platforma mësimore ishte një zgjidhje e mirëpritur nga nxënësit për zhvillimin e mësimin në distancë.

Pyetja kërkimore

A janë më shumë apo më pak të motivuar nxënësit në mësimdhënien në distancë në krahasim me mësimdhënien ballë për ballë?

Hipoteza

Gjatë mësimin në distancë, motivimi i nxënësve në mësim është më i ulët se në mësimdhënien ballë për ballë.

Metodologjia

Për realizimin e këtij studimi ka bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Republikën e Shqipërisë. Pyetësi i'u shpërnda mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore parauniversitare. Pyetësi u shpërnda përmes platformës elektronike Google Form. Sondazhi është kryer në muajin Maj 2020. Në Shqipëri arsimit kryhet nga institucione arsimore publike dhe jo publike. Anketa është kryer në institucionet arsimore publike.

Ftesat për të marrë pjesë në anketë u dërguan me email në institucionet arsimore të qarkut Tiranë dhe Elbasan. Ftesat për të marrë pjesë në anketë janë dërguar edhe në këto institucione përmes grupeve të WhatsApp-it, të zyrave arsimore të Tiranës dhe Elbasanit. Pyetësi u dërgua për plotësim në 180 institucione arsimore. Anketa u ndoq nga 144 institucione arsimore por vetëm 103 institucione arsimore parauniversitare plotësuan pyetësin: "Motivimi i nxënësve në mësimdhënien ballë për ballë dhe motivimi i nxënësve në mësimin në distancë". Duke qenë se në Tiranë dhe Elbasan popullsia është heterogjene për shkak të ardhjeve demografike të familjeve dhe mësuesve nga rajone të tjera të Shqipërisë, mendoj se kampioni i përzgjedhur është përfaqësues i Shqipërisë. Sqarojmë se pyetësi kishte një shtrirje më të gjerë studimi, por për efekt të temës dhe punës që prezantojmë jemi fokusuar në motivimin e nxënësve në klasë dhe mësimdhënien në distancë në kohën e pandemisë.

Pyetësi u hartua duke i'u referuar shkallës së matjes Likert, të nivelit të matjes dhe vlerësimit nga 1 deri në 5. Alternativat e përgjigjes ishin PD (Plotësisht dakord), D (Dakort), PP (të papërcaktuar), ND (Nuk jam dakort) dhe AD (Nuk jam aspak dakort).

Të anketuarit duhej t'i përgjigjeshin secilës nga deklaratat e mëposhtme. Për secilën deklaratë i anketuari duhej të klikonte në një të një nga alternativat e përshkruara më poshtë.

Deklarata e parë: Nxënësit janë të motivuar në mësimdhënien ballë për ballë.

Të anketuarit duhej t'i përgjigjeshin një prej alternativave të deklaratës të parë:

- PD; D; PP; ND; AD

Deklarata e dytë: Nxënësit janë të motivuar në mësimin në distancë.

Të anketuarit duhej t'i përgjigjeshin një prej alternativave të deklaratës të dytë:

- PD; D; PP; ND; AD

Pyetësi është krijuar në mënyrë që anketuesi nuk mund të klikonte "Dërgo" nëse intervistuesi nuk i është përgjigjur të gjitha pyetjeve. Prandaj, përgjigjet totale për të dyja deklaratat janë nga 103 pjesëmarrës.

Gjetjet e studimit.

Të dhënat e mëposhtme dalin nga sondazhi si në tabelë:

Altenativa / Deklarata	PD	D	PP	ND	AD
Nxënësit janë të motivuar në mësimdhënien ballë për ballë	32	31	17	18	5
Nxënësit janë të motivuar në mësimin në distancë	21	20	32	19	11

Meqenëse të dy pohimet janë deklaratat pohuese (pozitive) atëherë sipas metodës Likert, kodimi për secilën deklaratë është PD=5; D=4; PP=3; ND=2; AD=1.

Për të zbuluar se në cilën lloj mësimdhënie nxënësit janë më të motivuar njihsojmë koeficientin e motivimit për secilin rast me anën e formulës $V = (n_{pd} \cdot 5 + n_d \cdot 4 + n_{pp} \cdot 3 + n_{nd} \cdot 2 + n_{ad} \cdot 1) / 103$

Nga llogaritjet për pohimin e parë: Nxënësit janë të motivuar në mësimdhënien ballë për ballë, kemi: $V_1 = (32 \cdot 5 + 31 \cdot 4 + 17 \cdot 3 + 18 \cdot 2 + 5 \cdot 1) / 103 = (160 + 124 + 51 + 36 + 5) / 103 = 376 / 103 = 3,65$

Nga llogaritjet për pohimin e dytë: Nxënësit janë të motivuar në mësimin në distancë, kemi:

$V_2 = (21 \cdot 5 + 20 \cdot 4 + 32 \cdot 3 + 19 \cdot 2 + 11 \cdot 1) / 103 = (105 + 80 + 96 + 38 + 11) / 103 = 330 / 103 = 3,20$.

Diskutime.

Sikurse është përshkruar më lart instrumenti I përdorur në studim është anketimi i pjesëmarrësve duke shfrytëzuar platformën elektronike Google Form. Për të dyja deklaratat përgjigjet e pjesëmarrësve janë 103 sepse ndryshe pa i'u përgjigjur secilës deklaratë për vetëm një të një nuk mund të jepej komanda "Dërgo". Metoda e përdorur për matje është shkalla Likert nga 1 deri në 5. Në të dyja deklaratat janë përdorur formulime pozitive për të mos krijuar konfuzion tek anketuesi apo favorizim të një të një deklaratë në raport me tjetrën.

Nga përlllogaritjet vihet re se në të dyja rastet, si në mësimdhënien në klasë, ashtu edhe në atë në distancë nxënësit janë të motivuar për të mësuar.

Nga llogaritjet, në mësimdhënien ballë për ballë, treguesi i motivimit është 3.65, ndërsa në mësimin në distancë treguesi i motivimit është 3.20. Vihet re se në mësimin në distancë motivimi i nxënësve për të mësuar është më i ulët se ai i mësimin ballë për ballë ($3,20 < 3,65$). Ky është një përfundim i rëndësishëm që konfirmon hipotezën e hulumtimit.

Konkluzione

Në përfundim të këtij studimi theksojmë;

1. Në mësimin në distancë motivimi i nxënësve në mësim është më i ulët se ai i mësimdhënies ballë për ballë (klasë).
2. Mësimi në distancë përmes pajisjeve elektronike dhe platformave mësimore ishte zgjidhja më e mirë në kushtet e izolimit nga pandemia.
3. Rreziku i pandemisë dhe izolimi përshpejtuan aplikimin masiv të zhvillimeve më të fundit në teknologjinë e komunikimit dhe informacionit.
4. Në Shqipëri, ndihmë të rëndësishme gjatë mësimdhënies në kushtet e izolimit dha kanali televiziv shtetëror RTSH-Shkolla, i cili transmetoi 24 orë në ditë pandërprerje, mësimet me të njëjtin rend si në kurrikulën e lëndës për të gjitha klasat 1-12.
5. Gjatë pandemisë, mësuesit u rikualifikuan online për përdorimin e platformave mësimore.
6. Pandemia ishte momenti i mësimin dhe zbatimit të njohurive dhe aftësive në kohën e duhur.
7. Realizimi i mësimin në distancë u shoqërua me mungesë besimi në efektivitetin e tij nga mësuesit, nxënësit dhe prindërit.
8. Shumë mësues, nxënës dhe prindër shprehën dyshime për rezultatet e pritura nga mësimi në distancë.
9. Gjatë mësimdhënies në distancë, shumë nxënës që ishin jashtë mbikëqyrjes së mësuesit ishin neglizhent në ndjekjen e mësimin dhe kryerjen e detyrave mësimore.
10. Ka pasur vështirësi në motivimin e nxënësve gjatë mësimdhënies online.
11. Gjendja psikologjike e shkaktuar nga rreziku i pandemisë luajti një rol frenues në motivimin e brendshëm dhe të jashtëm të nxënësve.

Reference

1. Allensworth, E. dhe Schwartz, N (2020) School practices to address student learning loss. No. 1. EdResearch for Recovery Project; Annenberg Institute for Scholl Reform at Brwn University. [https://annenberg.brown.edu/sites/default/files/EdResearch for Recovery Brief 1.pdf](https://annenberg.brown.edu/sites/default/files/EdResearch%20for%20Recovery%20Brief%201.pdf)
2. Blicck, Y., Kauwenberghs, K., Zhu, C., Struyven, K., Pynoo, B., & DePryck, K. (2019a). Investigating the relationship between success factors and student participation in online and blended learning in adult education. Journal of Computer Assisted Learning, 35(4), 476-490. DOI:<https://doi.org/10.1111/jcal.1231> <https://researchportal.vub.be/en/publications/investigating-the-relationship-between-success-factors-and-studen>
3. Caroline L. South & Nancy DeJarnette (January 22, 2022) RULER: A Social Emotional Learning Program's Impact on School Climate. <http://dx.doi.org/10.22158/eshs.v3n1.p52>
4. European Commission. (2020). Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee of the Regions: Digital education action plan 2021-2027 resetting education and training for the digital age (COM/2020/624 final). <https://eurlex.europa.eu/legalcontent/EN/TXT/?uri=CELEX:52020DC0624>
5. European Commission. (2021). Digital technologies - actions in response to coronavirus pandemic. <https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/content/digital-technologies-actions-responsecoronavirus-pandemic>
6. Jayul, A. & Irwanto, E. (June 2020) Online Learning Model as an Alternative for Physical Education Learning

- Activities in the Midst of a Pandemic Covid-19. *Journal Pendidikan Kesehatan Rekreasi* P-ISSN 2337-9561. Vol. 6, No. 2, Hal. 190 – 199, E-ISSN 2580-1430.
DOI: <https://doi.org/10.5281/zenodo.3892262>
<https://ojs.mahadewa.ac.id/index.php/jpkr/article/view/689>
7. Lee, K., Choi, H., & Cho, Y. H. (2019). Becoming a competent self: A developmental process of adult distance learning. *The Internet and Higher Education*, 41, 25–33.
<https://doi.org/10.1016/j.iheduc.2018.12.001>
<https://www.sciencedirect.com/science/article/abs/pii/S1096751617304840>
 8. Nancy K. DeJarnette, Ruba S. Deeb & Pallis, J. July 21, 2021. Academic Collaborative Efforts to Promote STEM Equity in High Needs Schools. <http://dx.doi.org/10.22158/eshs.v2n3.p10>
 9. Ramnund-Mansingh, A. <http://www.asecu.gr/files/16th-international-asecu-conference-2020-novosibirsk-proceedings.pdf> p. 29-33
 10. Stranovská, E. Lalinska, M. & Bobonova, I (December 2017) Assessment of Teachers' Professional Competences In Consideration Of Motivation Factor. October 2017
doi.org/10.15405/epsbs.2017.10.26
 11. Sondazhi i dytë i MASR. (4-9 Prill 2020). <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/1586552308063-Sondazhi-i-m%C3%ABsimit-online-2.pdf>
 12. Tome, S. M. J. (2021) Learning to Unlearn for Transformative Learning, an Epistemological Look
JOSE MANUEL SALUM Vol 2, No 2(2021)
www.scholink.org/ojs/index.php/eshs
DOI: <https://doi.org/10.22158/eshs.v2n2p1> p.1-12
 13. Vanslambrouck, S., Zhu, Ch., Pynoo, B., Lombaerts, K., Tondeur, J., & Scherer, R. (2019). A latent profile analysis of adult students' online self-regulation in blended learning environments. *Computers in Human Behavior*, 99, 126–136.
<https://doi.org/10.1016/j.chb.2019.05.021>
 14. Vrapı, A. (2022) Teacher Education and Competencies in an Open Democratic Society. *Education, Society and Human Studies* ISSN 2690-3679 (Print) ISSN 2690-3687 (Online) Vol. 3, No. 1, 2022
www.scholink.org/ojs/index.php/eshs
<http://dx.doi.org/10.22158/eshs.v3n1.p32> p. 32-40
 15. Vrapı, A. & Vrapı, F. (2020). Motivation of students in distance learning in the time of the pandemic.
<http://www.asecu.gr/files/16th-international-asecu-conference-2020-novosibirsk-proceedings.pdf> p. 42-49
 16. Widjaja, W. (2013). The Use of Contextual Problems to Support Mathematical Learning. *Journal on Mathematics Education*, 4(2), 151-159.
<https://doi.org/10.22342/jme.4.2.413>. 151-159.

Vlerësimi i homofobisë tek studentët e infermierisë dhe infermieri-mamisë, në Fakultetin e Shëndetit, Vlorë

Erlini Kokalla

erlini.kokalla@univlora.edu.al

Dafina Bucaj

bucajdafina@gmail.com

Esilda Trushaj

esilda.trushaj@univlora.edu.al

Abstrakt

Hyrje: Homofobia i referohet frikës apo mendimeve, emocioneve dhe sjelljeve negative të individëve heteroseksualë ndaj atyre homoseksualë, pra identifikon një qasje negative ndaj këtij komuniteti. Homofobia ekziston gjithashtu tek ofruesit e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë këtu edhe infermierët. Prandaj është i nevojshëm reduktimi i homofobisë tek studentët e infermierisë, si profesionistë të ardhshëm të shëndetësisë.

Qëllimi: Qëllimi këtij studimi është vlerësimi i nivelit të homofobisë në studentët e infermierisë dhe infermieri-mamisë në Fakultetin e Shëndetit.

Metodologjia: Studimi është kros-seksional dhe përfshin 114 studentë të anketuar gjatë muajit maj 2022.

Rezultate: Shumica e pjesëmarrësve ishin femra (92.1%) dhe moshë mesatare e pjesëmarrësve të marrë në studim ishte 19.5 (± 2.5) vjeç. Vlera mesatare e homofobisë ishte 59.24 (± 14.56) pikë; 50.9% e pjesëmarrësve u klasifikuan me nivel të lartë homofobie, 15.8% nivel shumë të lartë homofobie dhe 33.3% nivel të ulët homofobie.

Konkluzione: Niveli i homofobisë shihet të jetë i lartë tek studentët e infermierisë dhe infermieri-mamisë në Fakultetin e Shëndetit. Studentët meshkuj kishin gjasa më të larta për të qënë homofobë.

Fjalë kyçe: *Homofobia, studentët e infermierisë, nivel, pikë*

Abstract

Introduction: Homophobia refers to the fear or negative thoughts, emotions and behaviors of heterosexual individuals towards homosexual ones, thus identifying a negative approach to this community. Homophobia exists among healthcare providers, including nurses. Therefore, it is necessary to reduce homophobia in nursing students, as future health professionals.

Purpose: The purpose of this study is to assess the level of homophobia in nursing and midwifery students at the Faculty of Health.

Methodology: The study is cross-sectional and includes 114 students surveyed during May 2022.

Results: The majority of participants were female (92.1%) and the mean age of the study participants was 19.5 (± 2.5) years. The average homophobia score was 59.24 (± 14.56); 50.9% of the participants were classified as high level of homophobia, 15.8% very high level of homophobia and 33.3% low level of homophobia.

Conclusions: The level of homophobia is high among nursing and midwifery students at the Faculty of Health. The study found that male students were more likely to be homophobic.

Keywords: *Homophobia, nursing students, level, score*

1. Hyrje

Shoqëria njerëzore është pjesë e një sistemi dinamik dhe si e tillë i nënshtrohet ndryshimeve të vazhdueshme sasiore dhe cilësore. Në këtë gamë të gjerë ndryshimesh përfshihet edhe diferencimi i popullatës bazuar në orientimin seksual, duke u shoqëruar me krijimin e komuniteteve të caktuara siç është edhe ai LGBTI. Ky komunitet që prej krijimit të tij është ndeshur me qëndrime të ashpra të popullatës së përgjithshme dhe pavarësisht lobimit të vazhdueshëm për pranimin e të drejtave të tyre, shihet se kjo gjë nuk konsiderohet si normalitet nga të gjithë, duke sjellë kështu rritjen e një fenomeni të quajtur homofobi.

Homofobia përkufizohet si tërësia e qëndrimeve dhe ndjenjave negative ndaj homoseksualitetit ose njerëzve që identifikohen ose perceptohen si lezbike, homoseksualë, biseksualë, transgjinjorë ose interseksualë (LGBTI). [1, 2] Disa studime kanë treguar se ky fenomen përveç popullatës së përgjithshme, evidentohet edhe tek ofruesit e kujdesit shëndetësor, siç janë infermierët, të cilët janë ndër profesionistët që ndërveprojnë më ngushtë me pacientët. [3, 4]

Shumë infermiere shfaqin qëndrime konservatore dhe sjellje diskriminuese ndaj njerëzve që kanë një orientim homoseksual. [5] Kjo qasje e tyre ndaj homoseksualëve krijon një barrierë në marrëdhënien infermier-pacient dhe rrjedhimisht afekton shërbimin shëndetësor që ata marrin. [6, 7] Duke pasur parasysh incidencat

e larta të paragjyqimeve seksuale në këtë grup profesionistësh, është e rëndësishme matja e qëndrimeve të homofobisë në studentët e infermierisë. [8] Këto hetime që japin informacion për përmasat e situatës, lejojnë marrjen e masave të sakta dhe në kohë nga institucionet e trajnimit, për të reduktuar ndikimin negativ të paragjyqimeve seksuale në këtë praktikë. [9] Disa studime kanë treguar se homofobia në studentët e infermierisë ka ardhur duke u reduktuar pas ndjekjes së programeve edukative të lidhura me minoritetet seksuale, çka thekson rëndësinë e 'luftimit' të këtij fenomeni tek infermierët që në kohën që ata janë studentë. [10, 11]

Në vendin tonë nuk ka evidenca mbi qëndrimet e studentëve apo profesionistëve të shëndetësisë ndaj komunitetit LGBTI, prandaj synimi i këtij studimi është vlerësimi i nivelit të homofobisë tek studentët e Fakultetit të Shëndetit, duke krijuar kështu një pasqyrë të situatës aktuale dhe shënimin e pikënisjes për studime të mëtejshme.

2. Materiali dhe metoda

Ky është një studim transversal (kros-seksional), i cili ka si fokus vlerësimin e homofobisë tek studentët e 'Fakultetit të Shëndetit'. Studimi u krye gjatë muajit maj 2022.

2.1. Karakteristikat e kampionit

Në studim u përfshinë 114 studentë të 'Fakultetit të Shëndetit'. Pjesëmarrja ishte vullnetare pas mirë-informimit të tyre në lidhje me qëllimin e studimit.

2.2. Procesi i anketimit

Pyetëtori i përdorur në këtë studim është i strukturuar, me vetë raportim, anonim dhe duke ruajtur plotësisht konfidencialitetin. Pas marrjes së lejes etike dhe në bashkëpunim me fakultetin, u realizua shpërndarja e pyetësorit përmes Google- forms. Pyetëtori përbëhet nga dy pjesë, si më poshtë vijon:

-Pjesa e parë e pyetësorit përfshin të dhënat demografike të popullatës së marrë në studim; gjinia, mosha, vendbanimi, besimi fetar, dega, viti dhe cikli i studimit.

-Pjesa e dytë e pyetësorit synon vlerësimin e homofobisë dhe korrespondon me Shkallën e Homofobisë (HS). HS është një instrument i aplikuar, i cili është gjetur përmes kërkimit në motorrin e kërkimit Google, në faqen web www.midss.org, ku miratohet leja e përdorimit të këtij instrumenti nga studiues të tjerë të interesuar për homofobinë.

Shkalla e Homofobisë përbëhet nga 25 pyetje, për të cilat pjesëmarrësit përgjigjen në një shkallë 5-pikëshe Likert; me 1 (plotësisht dakord), 2 (dakord), 3 (as dakord, as kundër), 4 (kundër), 5 (plotësisht kundër). HS është projektuar për të matur aspektet konjitive, të sjelljes dhe aspekte emocionale të homofobisë. [12]. Totali i pikëve të grumbulluara nga pyetjet varion nga 0-100.

Cut-off i përdorur për kategorizimin e rezultateve është;

0-25 pikë	nivel shumë i ulët i homofobisë
26- 50 pikë	nivel i ulët i homofobisë
51-75 pikë	nivel i lartë i homofobisë
76- 100 pikë	nivel shumë i lartë i homofobisë

Tabela nr.1: Cut-off-et e përdorura në studim.

2.3. Analiza statistikore e të dhënave

Analiza statistikore e të dhënave të grumbulluara u realizua në SPSS (Statistical Package for Social, Sciences) version 22. Variablat kategorikë janë paraqitur në fekuencë dhe përqindje. Variablat e metrikë janë paraqitur si mesatare dhe deviacion standard. Për krahasimin e proporcioneve ndërmjet variablave kategorike është aplikuar testi Chi-Square Goodness-of-Fit. Normaliteti i të dhënave është vlerësuar përmes testit Kolmogorov-Smirnov. Vlerësimi i homofobisë sipas karakteristikave të përgjithshme, u realizua përmes testeve jo-parametrike Mann-Whitney U dhe Kruskal-Wallis.

Në të gjitha rastet u konsiderua statistikisht sinjifikative një vlerë e $p \leq 0.05$.

3.Rezultatet

Ndër 114 studentë të pëfshirë në studim rezultoi se 105 (92.1%) prej tyre i përkasin gjinisë femërore dhe 9 (7.9%) i përkasin gjinisë mashkullore, me ndryshim statistikor sinjifikant ndërmjet tyre ($p=0.001$).

Mosha e pjesëmarrësve varion nga 18 vjeç deri në 36 vjeç, me një mesatare (\pm SD) që arrin vlerën $19.5(\pm 2.5)$ vjeç. Të shprehur në grupmoshë evidentohet se pjesa më e madhe e studentëve, konkretisht 111 (97.4%) prej tyre, i korrespondojnë grupmoshës 18-30 vjeç, ndërsa 3 (2.6%) studentë janë mbi 30 vjeç, ndryshim ky statistikisht i rëndësishëm ($p=0.0001$).

Përsa i përket vendbanimit, rezulton se shumica e studentëve të përfshirë në studim, 96 (84.2%), janë banues në zonat urbane, ndërsa 18 (15.8%) prej tyre banojnë në zonat rurale, me ndryshim statistikisht të rëndësishëm mes tyre ($p=0.0001$).

Të gjithë pjesëmarrësit rezultojnë të jenë ndjekës të ciklit të parë të studimeve (Bachelor), ndër të cilët 94 (82.5%) studiojnë infermieri të përgjithshme dhe 20 (17.5%) infermieri-mami; ndërsa përsa i përket vitit të studimit 83 (72.8%) janë në vit të parë dhe 31(27.2%) në vit të dytë; me ndryshim statistikisht sinjifikant midis kategorive ($p=0.0001$).

Një faktor tjetër i studiuar është edhe besimi fetar, ku dominojnë besimtarët myslimanë në 82 (71.9%) studentë, me ndryshim proporcional statistikisht të rëndësishëm nga besimet e tjera ($p=0.0001$); ku besimtarët ortodoksë përbëjnë 11 (9.6%) studentë, katolikë 9 (7.9%), 5 (4.4%) janë bektashinj, 1 (0.9%) pjesëtar i sektit dëshmitarët e Jehovahit, ndërsa 6 (5.3%) studentë kanë referuar të jenë ateistë.

Të dhënat e sipërpërmendura janë pasqyruar të përmbledhura edhe në tabelën nr.2.

Të dhëna të përgjithshme		Frekuencë Përqindje/ Mesatare (\pm SD)		vlera p
Gjinia	Femër	105	92.1%	0.001*
	Mashkull	9	7.9%	
Mosha		19.5 (\pm 2.5)		0.0001*
Grupmosha	18-30	111	97.4%	
	>30	3	2.6%	
Vendbanimi	Zona urbane	96	84.2%	0.0001*
	Zona rurale	18	15.8%	
Dega e studimit	Infermieri e përgjithshme	94	82.5%	0.0001*
	Infermieri mami	20	17.5%	
Viti i studimit	Viti I	83	72.8%	0.0001*
	Viti II	31	27.2%	
Besimi Fetar	Mysliman	82	71.9%	0.0001*
	Bektashi	5	4.4%	
	Katolik	9	7.9%	
	Ortodoks	11	9.6%	
	Dëshmitaret e Jehovahit	1	.9%	
	Ateist	6	5.3%	


Tabela nr.2: Të dhëna të përgjithshme, shprehur në frekuencë, përqindje, mesatare, deviacion standard dhe rezultatet e testit Chi-Square Goodness-of-Fit për secilin variabël.

* $p < 0.05$ diferenca proporcionale mes kategorive brenda të njëjtës variabël është sinjifikante. (Vlerësuar përmes testit Chi-Square Goodness-of-Fit).

Vlerësimi i homofobisë është realizuar përmes 25 pyetjeve të pasqyruara në tabelën nr.3, bazuar në pikëzimin e secilës prej tyre. Pikët e grumbulluara për secilën pyetje dhe në total janë shprehur në mesatare dhe deviacion standard. Rezultati më i lartë i homofobisë vihet re për pyetjen "Do të godisja një homoseksual që mund të tentojë të më afrohet" me $6.57(\pm 2.6)$ pikë, ndërsa rezultati më i ulët haset për pyetjen "Kam dëmtuar objekte në pronësi të homoseksualëve, si gërvishtja e makinës." me $1.85(\pm 1.3)$.

Shpërndarja e pikëve totale të grumbulluara nga pyetësi HS është pasqyruar edhe në grafikun nr.1. Duke parë histogramin, vihet re se të dhënat nuk janë të shpërndara në mënyrë normale. Grafiku është i anuar djathtas. Moda është e pozicionuar në anën e majtë (midis vlerave 48-53 pikë), ndërsa shumica e vlerave të vëzhguara janë të përqëndruara në anën e djathtë të grafikut, si dhe evidentohet një vlerë ekstreme.

Bazuar në pikët totale të grumbulluara nga pyetësi, konkludohet se vlerat e homofobisë variojnë nga 36 – 100 pikë, ndërsa mesatarja (\pm SD) shënon vlerën $59.24 (\pm 14.56)$ pikë.



Grafiku nr.1: Histogrami i pikëve totale të grumbulluara përmes HS.

Për të verifikuar rezultatet vizuale të histogramit, të dhënat mbi pikët totale i janë nënshtruar testit Kolmogorov-Smirnov (shprehur në tabelën nr.4), ku $D(114) = 0.113$, $p = 0.001$; çka tregon se kemi të bëjmë me një shpërndarje jo-normale të të dhënave.

	Kolmogorov-Smirnov		
	statistika	df	p
Totali i pikëve	.113	114	.001


Tabela nr.4: Testi Kolmogorov-Smirnov

25 pyetjet e 'Shkallës së homofobisë'	Mesatare (±SD)
1. Njerëzit homoseksualë më nervozojnë.	3.01(±1.4)
2. Homoseksualët e meritojnë stigmatizimin/ diskriminim.	2.22(±1.3)
3. Për mua homoseksualiteti është e pranueshme.	3.2(±1.4)
4. Nëse do të zbuloja që një mik është homoseksual, do t'i jepja fund miqësisë me të.	2.59(±1.4)
5. Homoseksualët nuk duhet të punojnë me fëmijët.	2.96(±1.5)
6. Unë bëj komente nënçmuese kundrejt homoseksualëve.	2(±1.2)
7. Do të pranoja të shoqërohesha me individë homoseksualë.	3.16(±1.5)
8. Martesa mes homoseksualëve është e pranueshme.	3.34(±1.5)
9. Unë bëj komente nënçmuese si "pederast" kur dyshoj se dikush është homoseksual.	2.2(±1.4)
10. Nuk ka rëndësi nëse miqtë e mi janë hetero apo homoseksualë.	2.7(±1.4)
11. Nuk do të mërzhitesha nëse do të mësoja se një mik i ngushtë i imi është homoseksual.	2.8(±1.5)
12. Homoseksualiteti është imoralitet.	2.7(±1.5)
13. I ngacmoj dhe tallem me homoseksualët.	1.9(±1.2)
14. Ndjej se nuk mund t'i besosh një personi që është homoseksual.	2.4(±1.3)
15. Kam frikë se personat homoseksualë do të flirtojnë seksualisht kundrejt meje.	2.7(±1.4)
16. Organizatat që promovojnë të drejtat e homoseksualëve janë të nevojshme.	2.6(±1.4)
17. Kam dëmtuar objekte në pronësi të homoseksualëve, si gërvishtja e makinës.	1.85(±1.3)
18. Nuk do ta kisha problem nëse miku im i dhomës është homoseksual.	3.26(±1.4)
19. Do ta godisja një homoseksual që mund të tentojë të më afrohet.	6.57(±2.6)
20. Sjelljet homoseksuale nuk duhet të cilësohen si kundërshtim ndaj ligjit.	2.87(±1.3)
21. Unë i shmang njerëzit homoseksualë.	5.72(±2.5)
22. Nuk e kam bezdi nëse shoh 1 çift homoseksualësh në publik.	2.9(±1.4)
23. Kur shoh një person homoseksual mendoj, "Çfarë dëmi".	5.9(±2.5)
24. Kur takoj dikë, përpiqem të zbuloj nëse ai/ajo është homoseksual.	6.4(±2.6)
25. E kam të vështirë të krijoj marrëdhënie me njerëz që dyshoj se janë homoseksualë.	5.5(±2.4)
Totali i pikëve të grumbulluara nga pyetësi	59.24(±14.56)

Tabela nr.3: Shkalla e homofobisë, pikët e grumbulluara për secilën pyetje dhe në total, shprehur në mesatare dhe (SD)deviacion standard.

Diferencimi i studentëve sipas niveleve të homofobisë u bë përmes kategorizimit të pikëve të grumbulluara nga pyetësi HS, duke pasur parasysh cut-off-in e vendosur në fillim të studimit.

Siç evidentohet në grafikun nr.2, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në studim kanë rezultuar të kenë një nivel të lartë homofobie, konkretisht 50.9% e tyre. Rreth 33.3% e studentëve shfaqin nivele të ulëta të homofobisë, ndërsa 15.8% e tyre kanë nivel shumë të lartë homofobie.



Grafiku nr.2: Shpërndarja e pjesëmarrësve në studim sipas nivelit të homofobisë.

Siç u pasqyrua dhe në tabelën nr.4 dhe grafikun nr.1 pikët totale treguese të homofobisë, nuk i nënshtrohen një shpërndarjeje normale, si dhe kanë prani të vlerave ekstreme. Për këtë arsye krahasimi i vlerave të homofobisë për

studentët e përfshirë në studim, sipas karakteristikave demografike të trajtuara, u realizua përmes testeve jo-parametrike.

		Totali i pikëve të homofobisë		
		Mesatare (\pm SD)	Z	vlera p
Gjinia	Femër	58.16(\pm 14.2)	-2.675	0.007*
	Mashkull	71.8(\pm 13.1)		
Grupmosha	18-30	59.3(\pm 14.7)	-.310	0.777
	>30	58.3(\pm 5.5)		
Vendbanimi	Qytet	60.1(\pm 15)	-1.275	0.202
	Fshat	54.7(\pm 10.9)		
Dega e studimit	Infermieri e përgjithshme	58.4(\pm 14.2)	-1.312	0.19
	Infermieri -mami	63.35(14.2)		

Tabela nr.5: Vlera mesatare (\pm SD) e homofobisë për secilin grup dhe rezultatet e testit Mann-Whitney U për krahasimin e grupeve

*-p<0.05→rezultat sinjifikant

Në tabelën nr.5 është pasqyruar vlera mesatare (\pm SD) e pikëve të grumbulluara nga pyetësi HS, për secilën kategori të variablave, si dhe janë shprehur rezultatet e testit jo-parametrik Mann-Whitney U. Ky test është aplikuar për vlerësimin e homofobisë sipas gjinisë, grupmoshës, vendbanimit dhe degës së studimit, për të parë

nëse ka ndonjë diferencë mes kategorive të ndryshme. Nga rezultatet e testit konkludohet se gjinia është i vetmi variabël, i cili shihet të ketë një ndikim në nivelin e homofobisë, me një diferencë statistikisht të rëndësishme midis femrave dhe meshkujve. Me një mesatare(\pm SD) 71.8 \pm 13.1pikë, meshkujt rezultojnë të jenë më

Sa i takon gjinisë së pjesëmarrësve në studim, pjesa më e madhe ishin femra sesa meshkuj (Tabela 1). Tabela:1 Shpërndarja e pjesëmarrësve në studim sipas gjinisë

Gjinia	Nr. i individëve
Femra	75
Meshkuj	59

Grafiku:1 Paraqitja sipas gjinisë në përqindje



Pjesëmarrja sipas gjinisë ishte Femra (n = 75) ose 56% dhe meshkuj (n = 59) ose 44%.

Lidhur me grupmoshat e përfshira në studim, individët ishin të gjithë mbi 18 vjec, me numrin më të madh të personave të grupmoshës 55-64 vjec (Tabela 2). Grupmosha 18-34 vjec ishin përdoruesit më të pakët të këtij grupi medikamentesh.

Tabela 2: Shpërndarja sipas grupmoshave

Grupmosha	Nr. i individëve
18 - 34	12
35 - 44	22
45 - 54	28
55 - 64	37
65 -74	16
Mbi 75 vjec	19

Tabela 3, përmban informacionin lidhur me nivelin arsimor të pjesëmarrësve në studim, ku pjesa më e madhe e tyre, kanë kryer arsimin e mesëm.

Tabela 3: Shpërndarja sipas nivelit arsimor

Niveli arsimor	Nr. i individëve
8- vjecar	12
I mesëm	67
I lartë	46
Pasuniversitar	9

Shpërndarja sipas nivelit arsimor, ku predominojnë individët me arsim të mesëm 50% (n=67), me arsim të lartë 34%(n=46), me arsim 8-vjecar 9% (n=12) dhe me arsim pasuniversitar 7% (n=9).

Lidhur me problemin shëndetësor që conte në përdorimin e AIJS-ve, individët e përfshirë në studim kanë dhënë përgjigjet si në tabelën 4.


Tabela 4: Shqetësimet apo problemet shëndetësore kur janë përdorur më shpesh AIJS

Problemet shëndetësore	Nr. i individëve
Dhimbje koke	83
Dhimbje muskujsh	82
Dhimbje kycesh	95
Gjendje gripale	120
Temperaturë e lartë	104
Hernie diskale	18
Dhimbje menstruale	24
Arsye tjetër	13

Shqetësimet më të shpeshta kur pjesëmarrësit në studim kanë përdorur AIJS, janë: gjendje gripale (n=120), temperaturë e lartë (n=104), dhimbje kycesh (n=95), dhimbje koke (n=83), dhimbje muskujsh (n=82), dhimbje menstruale (n=24), hernie diskale (n=18) dhe arsye të tjera (n=13). Personat e përfshirë në studim, i përdornin këto medikamente edhe për më shumë se një shqetësim (2-3 shqetësime).

Në njërin prej pyetjeve, pjesëmarrësit në studim shkruajtën emrin e medikamentit anti-inflamator josteroid, të cilin ata e përdornin më shpesh për njërin apo për disa nga shqetësimet e paraqitura në tabelen 4.


Grafiku 2: Anti-inflamatorët josteroidë të përdorur më shpesh



Paracetamoli përdorej më shpesh, në 98 persona ishte medikamenti i përzgjedhur nga ky grup. Medikamenti i përdorur më pak ishte takipirina dhe naprokseni.

Një pyetje tjetër që ju përgjigjën pjesëmarrësit gjatë plotësimit të pyestësorit lidhej me faktin se nga ishin ndikuar ata për të përdorur këtë grup medikamentesh për shqetësimet e tyre të ndryshme me shëndetin (Grafiku 3).

Grafiku 3: Nga çfarë u ndikuan pjesëmarrësit në studim për të përdorur këto medikamente



Lidhur me faktin se nga çfarë u ndikuan këta persona për të marrë këto medikamente, u konstatua se 27% ose (n=36) e tyre i merrnin përmes këshillës së mjekut. 43% ose n=58 prej tyre i merrnin me vullnetin e tyre. 18% ose n=24 prej tyre i përdornin këto medikamente pas sugjerimit të familjarëve. 12% ose n=16 prej pacientëve ndikoheshin nga reklamimi në media.

Grafiku 4: Njohuritë lidhur me efektet e padëshiruara të AIJS-ve




Në efektet e padëshiruara që mund të sjellë përdorimi pa recetë i anti-inflamatorëve josteroid (AIJS) u vu re se vetëm 13% e pjesëmarrësve (ose 17 prej tyre) nuk e dinin nëse këto medikamente shkaktojnë efekte anësore apo jo. 49 prej tyre ose 37% nuk mendonin se këto medikamente japin efekte anësore dhe nuk kishin shfaqur asnjë problem. 51% ose 68 mendonin se këto medikamente shkaktojnë efekte anësore.

Në pyetësonin e përdorur për studim, pjesëmarrësit u përgjigjën lidhur edhe me shpeshtësinë e përdorimit të këtyre medikamenteve (Tabela 5).

Shpeshtësia e përdorimit të anti-inflamatorëve AIJS	
1 herë në ditë	39
2 herë në ditë	8
1 herë në javë	73
1 herë në muaj	14

Shpeshtësia e përdorimit të anti-inflamatorëve josteroid (AIJS) varion: 29% ose n=39 i përdornin 1 herë në ditë, 6% ose n=8 i përdornin 2 herë në ditë, 55% ose n=73 i përdornin 1 herë në javë, 10% ose n=14 i përdornin vetëm një herë në muaj.


Grafiku 5: Leximi i fletë-udhëzuesit brenda kutisë së medikamentit



Pyetjes nëse e lexonin fletë-udhëzuesin brenda kutisë së medikamentit pjesëmarrësit në studim iu përgjigjën: 13% ose 17 prej tyre e lexonin gjithmonë, 21% ose 28 prej tyre e lexonin shpesh, 28% ose 37 prej tyre e lexonin ndonjëherë, 17% ose 23 prej tyre e lexonin rrallë dhe 21% ose 29 prej tyre nuk i lexonin asnjëherë informacionin mbi medikamentin.

Pyetjes se nëse nuk kishin efektin e dëshiruar pas marrjes së medikamentit AIJS, si vepronin? (Grafiku 6).


Grafiku 6: Si vepronin në rastin kur nuk marrin efektin e dëshiruar



Pyetjes “Nëse nuk keni përmirësim, psh qetësim të dhimbjeve pas përdorimit të njërit prej medikamenteve të grupit AIJS, si vazhdoni ?”

Pjesëmarrësit në studim u përgjigjën: 13% ose n=18 prej tyre rrisnin dozën, 38% ose n=51 prej tyre përdornin një tjetër medikament me efekt më të fortë, 13% ose n=17 prej tyre drejtoheshin tek mjeku specialist dhe 36% ose n=48 prej tyre përdornin në të njëjtën kohë dy medikamente të tillë.

Grafiku 7: Njohuritë lidhur me ndërveprimin e medikamenteve



Lidhur me njohuritë rreth ndërveprimit të medikamenteve me njëri-tjetrin apo me grupe të tjera medikamentesh, përgjigjet ishin si në grafikun 7. 13% ose n=17 prej tyre kishin informacion dhe e dinin se cilin qetësues të përdornin në rast të një patologjie kronike që mund të kishin, 37% ose n=49 prej tyre nuk kishin informacion. 52% ose n= 68 prej tyre nuk e dinin që përdorimi i anti-inflamatorëve josteroidë (AIJS) të kishin bashkëveprim me grupe të tjera medikamentesh.

Diskutimi

Ky studim i realizuar në qytetin e Vlorës evidenton njohuritë që ka popullata rreth grupit të medikamenteve anti-inflamatorë josteroidë. AIJS duke qenë se kanë një përdorim të gjerë, dhe në të njëjtën kohë janë medikamente të kategorizuara si OTC, merren në farmaci nga persona të moshave të ndryshme, për indikacione të shumta. Nga përgjigjet që kanë dhënë pjesëmarrësit në studim është konstatuar që femrat i përdorin më shpesh AIJS, krahasuar me meshkujt dhe grupmosha që i merr më shpesh këto medikamente është 55-64 vjeç, lidhur kjo dhe me faktin që kjo është grupmosha që ka edhe sëmundje kronike më së shumti, krahasuar me grupmoshat e tjera që këtë grup medikamentesh e përdorin vetëm në raste akute. Problemet shëndetësore ku individët i përdornin më shpesh këto medikamente ishin gjendja gripale, temperatura e lartë dhe dhimbjet artikulare. Paracetamoli dhe brufeni ishin renditur si medikamentet më të përdorura të këtij grupi nga personat pjesëmarrës në studimin tonë. Sa i takon faktit se nga çfarë u ndikuan këta persona për të marrë këto medikamente, u konstatua se pjesa më e madhe i merrnin me vullnetin e tyre, të tjerët me këshillën e mjekut ose nga ajo që shihnin në reklama në media. Në një studim tjetër të ngjashëm, burimi kryesor i informacionit dhe që ndikonte në vendimin për të marrë këto medikamente ishte interneti [9]. 37% e pjesëmarrësve në studim mendonin se këto medikamente nuk shfaqin efekte anësore për shëndetin e tyre, krahasuar me një studim të tillë të realizuar në qytetin e Tiranës, ku 48.7% e individëve u përgjigjën se AIJS nuk sjellin efekte anësore [10]. Edhe leximi i fletës së instruksioneve të medikamentit, lexohej gjithmonë vetëm nga 13% e pjesëmarrësve në studim. Kjo lidhet me faktin që pacientët i përdornin këto medikamente për situata akute dhe nuk ishin të fokusuar tek efektet anësore apo te ndërveprimet që mund të kenë AIJS me grupet e tjera të medikamenteve. Lidhur me pyetjen se sa e lexojnë fletë-udhëzuesin, edhe në një studim të ngjashëm të realizuar në Gjermani, u konstatua që pjesa më e vogël nuk e lexonin

sepse hasnin vështirësi në të kuptuar dhe mendonin që nuk merrnin aty informacion të rëndësishëm [11]. Edhe lidhur me njohuritë që kishin sa i takon bashkëveprimit me medikamente të tjera, pjesa më e madhe (52%) e pjesëmarrësve në studim referuan se nuk e dinin që këto medikamente mund të bashkëveprojnë edhe me medikamente të grupeve të tjera.

Konkluzione

Studimi i realizuar në qytetin e Vlorës, që kishte si qëllim evidentimin e njohurive dhe praktikave të përdorimit të medikamenteve anti-inflamatorë josteroidë në popullatën adulte, coi në disa konkluzione. Më të rëndësishmit prej tyre janë ato që kanë të bëjnë me nivelin e njohurive jo adekuate rreth efekteve anësore që sjellin këto medikamente kur përdoren vecanërisht për një kohë të gjatë. Pjesa më e madhe e personave të përfshirë në studim, i merrnin këto medikamente me vullnetin e tyre, por edhe pse AIJS njihen si barna OTC, është i nevojshëm këshillimi me mjekun përpara përdorimit të tyre, në mënyrë të vecantë te personat që vuajnë nga sëmundje të tjera si ato renale apo kardiovaskulare. Ka rëndësi që të informohet popullata që këto medikamente duhet të përdoren me kujdes sepse ndërveprimi me barnat e tjera ndikon në terapinë që merr pacienti. Po ashtu, leximi i fletë-udhëzuesit ka një rëndësi të vecantë e kjo praktikë duhet nxitur që të ndiqet për çdo lloj medikamenti, sepse në fletë-udhëzues përshkruhen me hollësi, jo vetëm dozimet, indikacionet, por edhe efektet anësore, bashkëveprimet me barnat e tjera apo se çfarë duhet bërë në rast mbidozimi.

Në përfundim mund të themi se ka një përdorim të shtuar të anti-inflamatorëve josteroidë, por njohuritë e pacientëve rreth tyre janë të pakta dhe ka nevojë për rritje të ndërgjegjësimit se megjithë efektet pozitive në shëndet, këto medikamente mbartin edhe risqe. Një monitorim i kujdesshëm gjatë përdorimit, peridhë jo e gjatë e terapisë, rritje e informimit dhe e ndërgjegjësimit, janë mënyrat më të mira për të shmangur efektet anësore që sjellin AIJS,

e për të predominuar përftimet në shëndet, krahasuar me pasojat negative që këto medikamente sjellin për organizmin e njeriut.

Referencat

1. Ghlichloo I, Gerriets V. Nonsteroidal Anti-inflammatory Drugs (NSAIDs). 2022 May 8. In: StatPearls [Internet]. Treasure Island (FL): StatPearls Publishing; 2022 Jan-. PMID: 31613522.
2. Davis, J. S., Lee, H. Y., Kim, J., Advani, S. M., Peng, H. L., Banfield, E., Hawk, E. T., Chang, S., & Frazier-Wood, A. C. (2017). Use of non-steroidal anti-inflammatory drugs in US adults: changes over time and by demographic. *Open heart*, 4(1), e000550. <https://doi.org/10.1136/openhrt-2016-000550>
3. Baiomi A, Abbas H, Mehershahi S, Daniel M. Non-Steroidal Anti-Inflammatory Drugs: A Rare Cause of Colonic Mass. *Case Rep Gastroenterol*. 2021 Mar 18;15(1):395-399. doi: 10.1159/000511748. PMID: 33976617; PMCID: PMC8077422.
4. Ghlichloo I, Gerriets V. Nonsteroidal Anti-inflammatory Drugs (NSAIDs). 2022 May 8. In: StatPearls [Internet]. Treasure Island (FL): StatPearls Publishing; 2022 Jan-. PMID: 31613522.
5. Barkin RL. Topical Nonsteroidal Anti-inflammatory Drugs: The Importance of Drug, Delivery, and Therapeutic Outcome. *Am J Ther*. 2015 Sep-Oct;22(5):388-407.
6. Zacher J, Altman R, Bellamy N, Brühlmann P, Da Silva J, Huskisson E, Taylor RS. Topical diclofenac and its role in pain and inflammation: an evidence-based review. *Curr Med Res Opin*. 2008 Apr;24(4):925-50. doi: 10.1185/030079908x273066. Epub 2008 Feb 14. PMID: 18279583.
7. Nezvalová-Henriksen, K, Spigset, O, Nordeng, H . Effects of ibuprofen, diclofenac, naproxen, and piroxicam on the course of pregnancy and pregnancy outcome: a prospective cohort study. *BJOG* 2013; DOI 10.1111/1471-0528.12192.
8. Johnson, A.G., Seideman, P. & Day, R.O. Adverse Drug Interactions with Nonsteroidal Anti-Inflammatory Drugs (NSAIDs). *Drug-Safety* 8, 99–127 (1993). <https://doi.org/10.2165/00002018-199308020-00002>
9. Babelghaith, S. D., Alarifi, M. N., Wajid, S., Alhawassi, T. M., Alqahtani, S. K., & Alghadeer, S. M. (2019). Knowledge of patients on safe medication use in relation to nonsteroidal anti-inflammatory drugs. *Saudi journal of anaesthesia*, 13(2), 106–111. https://doi.org/10.4103/sja.SJA_557_18
10. Roshi, D., Toçi, E., Burazeri, G., Schröder-Bäck, P., Malaj, L., & Brand, H. (2017). Users' Knowledge About Adverse Effects of Non-steroidal Anti-inflammatory Drugs in Tirana, Albania. *Materia sociomedica*, 29(2), 138–142. <https://doi.org/10.5455/msm.2017.29.138-142>
11. Fuchs J, Hippus M, Schaefer M. Analysis of German package inserts. *Int J Clin Pharmacol Ther*. 2006;44:8–
- 13.

Pandemia dhe shtatëzania

Roli i infermierit në qetësimin e frikës dhe ankthit gjatë periudhës së pandemisë

Saemira Durmishi

saemira.durmishi@univlora.edu.al

Diana Çuberi

dianacuberi@gmail.com

Abstrakt

Hyrje: Ndërkohë që pandemia e koronavirusit vazhdon udhëtimin e saj në glob, ajo ka instaluar një sasi të konsiderueshme frike, shqetësimi dhe nervozizmi si për popullatën e përgjithshme por sidomos për grupe të caktuara të popullatës në veçanti të gratë shtatëzëna.

Qëllimi: Të vlerësohet roli i infermierit në qetësimin e frikës dhe ankthit gjatë periudhës së pandemisë.

Objektivi: Të vlerësojmë kujdesin e infermierëve për gratë shtatëzëna, duke pasur si objektiv kryesor që foshnja të zhvillohet, të përparojë, të rritet dhe të kemi një mëmësi të sigurtë.

Metodologjia e studimit: Ky është një studim kros-seksional i kryer në qytetin Vlorës për një periudhë kohore 1 vjecare (Janar 2020 - Janar 2021).

Ky studim u krye në 1 qendër shëndetsore duke u bazuar në kartelat e grave shtatëzënë si dhe intervistat e drejtperdrejta dhe online.

Rezultatet: Janë marrë në studim 1130 gra nga të cilat 840 gra shtatëzënë dhe 290 lehona në harkun kohor 2020-2021. Sipas dokumentacionit rezultojnë 82 vizita të para obstetrikale, ose 9.8%, 64% janë paraqitur në moshë 0-13 javë, 32% janë paraqitur në moshën 13-28 javë dhe vetëm 4% kane ardhur mbi 28 javë.

Nga gratë e kartelizuara 17% e kanë kaluar covid para shtatëzanie, dhe vetëm 9 % e tyre janë të vaksinuara. Frika dhe ankthi kanë shoqëruar gati 70% të pacienteve pothuajse gjatë gjithë gravidancës, dhe si pasojë e kësaj rezultojnë 2% e grave të kanë kryer abort spontan para javës së 16, dhe 1% të kenë bërë feto-morto, kurse lindje preterm rezultojnë të kenë kryer 12% e grave. Ndjekja në dinamikë e tyre më të gjitha ekzaminimet na tregon për rritje të niveleve të HTA, D-dimerit, infeksioneve-urinare, hemoragjisë, dhe aritmisë.

Konkluzione: Personeli shëndetësor ka bërë një punë heroike dhe voluminoze përpara i përket qetësimin të situatave problematike, frikës dhe ankthit që ka shoqëruar vitin pandemik duke qëndruar sa më shumë në kontakt të vazhdueshëm me çdo pacient, duke monitoruar online dhe më prezencë fizike çdo shqetësim në mënyrë që situata e krijuar të menaxhohej.

Fjalë kyçe: *Pandemi, frike dhe ankth*

Abstract

Introduction: Meanwhile the Coronavirus pandemic is spreading rapidly around the globe, it has risen the fear, the concern and the irritability for the general population and for certain groups especially pregnant women.

Aim: To evaluate the role of the nurse in the

appeasement of fear and anxiety during the pandemic.

Objective: To evaluate the nursing care among pregnant women, whose main objective is the appropriate development, the progress and the growth of the baby and above all a secure birth for the baby and the woman.

Methodology: This is a cross-sectional study conducted in the city of Vlora for a period of 1 year (January 2020 - January 2021). This study was conducted in a healthcare center based on health cards of the pregnant women as well as direct questionnaires and online at the same time.

Results: In total 1330 women participated in the study, of which 840 women are currently pregnant and 290 had given birth in the period 2020-2021. Based on the documents 82 obstetric visits or 9.8%, 64 % have done the first control on 0-13 weeks of pregnancy, 32 % have done the first control on 13-28 weeks of pregnancy and only 4 % have done it above 28 weeks of pregnancy. Only 17 % of the women has passed Covid before getting pregnant and only 9 % are vaccinated.

The fear and the anxiety have accompanied almost all the pregnant women during the pregnancy period and as a result 2 % of the women has experienced a spontaneous abortion before the 16 week of pregnancy and 1 % have had a femto-metre, meanwhile 12% of the women have had a preterm birth of the their babies. Tracking carefully every examination we can identify a certain growth among the levels of HTA, D-dimmer, urinary infections, hemorrhage and arrhythmias

Conclusions: The healthcare personnel has been part of a great amount of work and heroic at the same time as far as calming down problematic situations related to the fear and the anxiety that has been present during this pandemic year by being in continuous contact with each patient monitoring online and either physically every problem in order to make each situation possible to be managed.

Keywords: *Pandemic, fear and anxiety*

Hyrje: Ndërkohë që pandemia e koronavirusit vazhdon udhëtimin e saj në glob, ajo ka instaluar një sasi të konsiderueshme frike, shqetësimi dhe nervozizmi si për popullatën e përgjithshme por

sidomos për grupe të caktuara të popullatës në veçanti të gratë shtatzëna. Gjithashtu me shfaqjen e masave të ndryshme dhe veçanërisht karantina me efektet e saj, vetmia, ndyshimet e humorit, do të ishtë e vështirë të mos shqetësoheshim lidhur me atë se çfarë do të thotë frika dhe ankthi të cilat janë probleme të zakonshme edhe në kohë të mira të gratë shtatzënë. Covid-19 prek çdo individ në një mënyrë të ndryshme dhe shihet të jete i ndryshëm edhe në gratë shtatzëna. Frika, shqetësimi dhe stresi janë përgjigje normale ndaj kërcënimeve të perceptuara ose të vërteta, ndërsa përballemi me pasiguri ose mosdije. Kështu, është normale dhe e kuptueshme që gratë të përjetojnë frikë në kontekstin e pandemisë.[1]

Autoritetet shëndetësore, i kanë vendosur gratë shtatzëna në grupin me rrezik të lartë për sëmundje të rëndë Covid-19

Gjatë periudhës të COVID-19, gratë shtatzëna mendohet se janë kategoria më e rrezikuar për shkak të gjendjes së tyre të përgjithshme dhe rrezikut të rritur nga komplikimet gjatë shtatzënisë. Por, nga ana tjetër, hulumtimet nuk tregojnë se gratë shtatzëna janë më të ekspozuara ndaj virusit ose janë në rrezik më të madh që të zhvillojnë simptoma serioze. Gratë shtatzëna të cilat janë të infektuara me COVID-19 është mjaft e sigurt të kenë simptoma të buta ose mos kenë aspak simptoma dhe tërësisht të shërohen pas një periudhe të caktuar kohore.

Hulumtimet më të reja tregojnë se është e mundur që nëna ta transmetojë virusin të fetusit gjatë shtatzënisë, gjegjësisht fëmijës gjatë lindjes, por deri tani nuk dihen sa janë gjasat dhe cili do të ishte numri i grave shtatzëna që do të prekeshin,[2]

Paraqitja e simptomave më serioze të gratë shtatzëna (temperatura e lartë e cila zgjat disa ditë, koll i thatë i vazhdueshëm, frymëmarrje e vështirësuar, humbja e shpejt e aromës dhe shijes, diarreja me dehidrim) që kërkon kujdes

urgjent mjekësor në kushte spitalore,[3] . Nëse këto simptomat janë serioze dhe nuk kalojnë pas një kohe, gratë shtatzëna menjëherë duhet të paraqiten përmes telefonit, e pastaj të vijnë në spital ose në gjinekologji.

Gratë shtatzëna duhet në mënyrë mjaft të disiplinuar t'i praktikojnë masat e izolimit social për dallim nga njerëzit tjerë, me qëllim që të zvogëlohet rreziku nga infektimi. Kjo veçanërisht ka të bëjë me ata të cilët janë fazë të vonshme të shtatzënisë (pas javës 24) ose të cilat kanë sëmundje të zemrës dhe sëmundje kronike. Paçka se sipas provave, gratë shtatzëna nuk janë më të cenueshme sesa njerëzit e tjerë ndaj COVID-19, UNICEF paralajmëron që vendet duhet t'iu sigurojnë aksesin në shërbimet para dhe pas lindjes. Krahas kësaj, të sapolindurve të sëmurë iu nevojitet akses ndaj shërbimeve të urgjencës për ta adresuar riskun me të lartë që mund të kenë në krahasim me moshat e tjera.[4]

Në emër të nënave në mbarë botën, UNICEF iu bën thirrje urgjente qeverive dhe ofruesve të kujdesit shëndetësor që gjatë muajve të pandemisë të shpëtojnë jetë, duke: Ndhimuar gratë shtatzëna me kontrollin para lindjes, kujdes të kualifikuar gjatë lindjes, shërbimet e kujdesit pas lindjes, si dhe shërbime në lidhje me COVID-19 nëse nevojiten duke mundësuar marrjen e të gjitha masave për kontrollin dhe parandalimin e infeksionit në qendrat shëndetësore gjatë dhe pas lindjes; duke bërë të mundur që punonjësit e shëndetësisë të kryejnë vizita patronazhi në shtëpitë e grave shtatzëna dhe nënave të reja, duke i nxitur gratë që të frekuentojnë konsultoret e nënave dhe femijes të kombinuara me konsulta nëpërmjet telefonit. Trajnuar, mbrojtur dhe pajisur punonjësit, përmes paketave të pastra të lindjeve, me qëllim që të lehtësojnë lindjet në shtëpi kur qendrat shëndetësore të jenë të mbyllura; Ndonëse ende nuk dihet nëse virusi transmetohet nga nëna të fëmija gjatë shtatzënisë dhe lindjes, rekomandon që të gjitha gratë shtatzëna të:

- Ndjekin masat e sigurisë për t'u mbrojtur nga ekspozimi ndaj virusit, të vetëmonitohen për simptomat e COVID-19, dhe të kontaktojnë mjekun ose infermierin në rast se kanë shqetësime ose simptoma.

- Te marrin të njëjtat masa sigurie si gjithë pjesa tjetër e popullsisë për të shmangur infektimin me COVID -19: distancimin fizik, shmangien e grumbullimeve, dhe shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore on line ose me telefon.
- Te kërkojnë kujdes mjekësor në kohë nëse

jetojnë në zona të prekura ose të rrezikuara dhe kanë temperaturë, kollë, apo vështirësi në frymëmarrje;

- Te vazhdojnë ushqyerjen me gji edhe nëse janë ose dyshojnë se janë infektuar, duke qenë se virusi nuk është gjendur në mostrat e qumështit të gjirit.
- Nënat që vuajnë nga COVID-19 duhet të mbajnë maskë kur ushqejnë foshnjën, të lajnë duart para dhe pasi ta prekin atë, si dhe të pastrojnë dhe të dezinfektojnë sipërfaqet rregullisht;
- Te vazhdojnë ta mbajnë femijen e porsalindur në krah dhe realizojnë kontaktin lekure me lekure (skin to skin kontakt);
- Te kërkojnë nga mamia ose mjeku që të gjejnë hapësirën më të sigurt për të lindur, si dhe të krijojnë një plan lindjeje, në mënyrë që të ulin nivelin e ankthit dhe të sigurohen që të arrijnë atje në kohën e duhur;
- Te vazhdojnë mbështetjen mjekësore, duke përfshirë vaksinimin e rregullt pas lindjes së foshnjës. [1]

Familjet e reja kërkojnë mbështetje në fillimin e ushqyerjes me gji, marrjes së mjekimeve, vaksinimit dhe ushqyerjes në mënyrë që foshnjat e tyre të jenë sa më të shëndetshme.

Pyetjet më të zakonshme që bëhen në lidhje me koronavirusin dhe rreziqet e shtatzënisë Cila është mundësia për infektim me virusin korona gjatë shtatzënisë?

Çfare behet nëse një shtatzëne e shëndoshë ka test pozitiv?

Nëse jam pozitive në COVID – 19 a duhet të jem e ndarë nga foshnja ime?

A mund t'i jap gji foshnjës nëse kam virus korona?

Këto janë vetëm një pjesë e pyetjeve që çdo shtatzënë ia parashtron vetes në periudhën e

ballafaqimit me pandeminë nga virusi korona. 1) Si të sillen shtatzënat dhe a rekomandohet që të bëhen në mënyrë të rregullt kontrollin antenatal?

Kontrollin antenatal gjatë shtatzënisë janë shumë të rëndësishme, jo vetëm për shëndetin por edhe për mirëqenien e foshnjës. Megjithatë në këtë periudhë të pandemisë aktive

rekomandohet të zvogëlohet kontrolli e obligueshme antenatale, por vetëm për rastet me rrjedhë normale të shtatzënisë dhe të shtatzënat që nuk kanë të kaluar obstetrike të keqe ose që nuk kanë pasur probleme të tjera shëndetësore – gjegjësisht nuk kanë faktorë të rrezikut për paraqitje eventuale të shtatzënisë patologjike.

2) Çka behet nëse ka së paku një nga simptomat e këtij infeksioni, e është shtatzëne? – Nëse ka së paku një nga simptomat e këtij infeksioni është e nevojshme të paraqitet për kontroll te mjeku. Çdoherë të vendos maskën para se të dal nga shtëpia, të ruaj distancën prej së paku 2 m nga të tjerët, veçanërisht pasi që të arrini në spital ose në ambulancë dhe është mirë që shkuarjen ta paralajmëroj me telefon. Në anketën epidemiologjike patjetër lajmërohen në tërësi simptomat dhe kontaktet e rrezikut të mundshëm.

3) Cila është mundësia për infektim me virusin korona gjatë shtatzënisë? – Deri tani kemi shumë pak publikime, kështu që edhe informatat për femra shtatzëna që janë sëmure me COVID – 19 janë të pakta. Nga dëshmitë e publikuara deri më tani duket se numri i shtatzënave që janë pozitive ose të sëmura me COVID – 19 është i vogël në krahasim me numrin e femrave të tjera të asaj moshe. Femrat me probleme të tjera shëndetësore, veçanërisht ato me sëmundje kronike të sistemit respirator, shtypje të lartë të gjakut, diabeti, kanë rrezik më të madh nga kjo sëmundje dhe për ato ekziston protokoll tjetër për ndjekjen e shtatzënisë dhe lindjes.

4) Çka nëse shtatzëne e shëndoshë ka test pozitiv? – Shumica e shtazënave të cilat testi për COVID – 19 do të jetë pozitiv, nëse janë pa simptoma ose me simptoma të buta do të duhej të rrinë në shtëpi dhe të jenë në komunikim të vazhdueshëm me mjekun gjinekolog dhe me mjekun e familjes.

Nëse tek ato simptomat fillojnë të përkeqësohen, është e nevojshme të vendosen në spital.

5) A ka dallime në lidhje me pasojat për fetusin në cilën javë, muaj të shtatzënisë do të infektohet pacientja? – Sa më e afërt është sëmundja aktuale virusale me terminin e mundshëm të lindjes, aq më të vogla janë rreziqet për fetusin. Rrezik më i

madh për fetusin ekziston nëse shtatzëna herët në shtatzëni e fiton virusin, sëmuret dhe ka rrezik të madh për lindje të parakohshme.

6) A ekziston rrezik për anomali strukturore dhe zhvillimore për foshnjën nëse gjatë shtatzënisë preket prej COVID – 19? – Sipas të dhënave ekzistuese deri te të cilat kemi qasje, supozohet se nuk ekziston bartje nga nëna në fetusin gjatë kohës së shtatzënisë. Nuk ka shenja se COVID – 19 i rrit rreziqet për anomali të fetusit edhe pse njohim vetëm disa femra që janë sëmure nga virusi në periudhën e organogenezës, gjegjësisht në tre muajt e para të shtatzënisë. Disa studime me viruse të ngjashme sugjerojnë se foshnja mund të mos rritet sa duhet, përkatësisht për javën e shtatzënisë, gjegjësisht të fitojë rritje të ngadaltë të fetusit (IUGR) pas infektimit të ngjashëm me COVID – 19. Për t'u zbuluar me kohë këto komplikime, më shumë ekspert rekomandojnë së paku një ultrazë pas 2 deri në 4 javë pas përfundimit të infeksionit që të jeni të sigurt se fetusin zhvillohet mirë.

7) Cilat janë rreziqet gjatë kohës së lindjes së fëmijës? – Nëse keni COVID – 19 dhe jeni në fazë aktive të lindjes së foshnjës, për shkak të hipoksisë (mungesë e oksigjenit) të mundshme ose ndalim të procesit të lindjes së fëmijës, mund të vështirësohet lindja spontane vagjinale dhe në atë rast rekomandimet janë që lindja e foshnjës të bëhet me prerje cezariene. Për momentin nuk ka arsye tjetër të zgjidhet prerja cezariene në vend të lindjes vagjinale kur nëna është e infektuar me COVID – 19, përveç nëse bëhet fjalë për lindje të parakohshme të fëmijës ose ekziston ndonjë indikacion tjetër obstetrikë për prerje cezariene nga ana e nënës ose të fetusit.

8) Nëse është pozitive në COVID – 19 a duhet të jete e ndarë nga foshnja? – Shpeshherë rekomandohet të qëndrojmë me foshnjën nëse ndjehet mirë. Disa rrethana mund të kërkojnë të jete e ndarë nga foshnja. Duhet të jeni shumë të kujdesshem që t'i shmangeni transmetimit të virusit foshnjës. Kjo më së miri bëhet nëse i lani duart gjatë dhe në imtësi para se ta prekni foshnjën, mos ta prekni fytyrën e foshnjës, mos të kolliteni ose teshtini në afërsi të foshnjës dhe të mbani maskë kur kujdeseni për atë.


9) A mund ta ushqej me gji foshnjën kur jam e infektuar me COVID – 19? – Nga dëshmitë e deritanishme shkencore që i kemi, disa shtatzëna të infektuara me virusin korona kanë qenë të

testuar dhe në qumështin e tyre nuk është zbuluar shenjë e virusit. Do me thënë, se qumështi i nënës është i sigurt për foshnjën edhe nëse jeni e infektuar me COVID – 19. Por, në të njëjtën kohë, duhet të jeni e kujdesshme që mos t'ia transmetoni e virusin foshnjës. Opsion tjetër i shkëlqyeshëm është të mbani maskë të tipit FFP3 ose P100, ta shtrydhni qumështin nga gjiri dhe të keni dikë që nuk është i sëmurë e që do ta ushqejë foshnjën. [6]

Rezultatet sasiore te studimit

Rezultatet: Janë marrë në studim 1130 gra nga të cilat 840 gra shtatëzënë dhe 290 lehonat të ndjekura në harkun kohor 2020-2021. Sipas dokumentacionit të shqyrtuar rezultojnë 82


Grafiku 1



Sipas rezultateve te studimit 17% e grave kane kaluar covid para shtatezane nga ku 12 % kane kryer lindje pre-term. 9% e grave jane vaksinuar

vizita të para obstetrikale, ose 9.8% ku 53 gra ose 64% janë paraqitur në moshë 0-13 javë, 26 gra ose 32% janë paraqitur në moshën 13-28 javë, dhe vetëm 3 gra ose 4% kanë ardhur mbi moshën 28 javë. Nga gratë e kartelizuara vetëm 17% e kanë kaluar covid para së të ngeleshin shtatëzane, dhe vetëm 9 % e tyre janë të vaksinuara. Frika dhe ankthi kanë shoqëruar gati 70% të pacientevë pothuajse gjatë gjithë gravidancës, dhe si pasojë e kësaj rezultojnë 2% e grave të kenë kryer abort spontan para javës së 16, dhe 3 të tjera kanë bërë feto-morto, kurse lindje preterm rezultojnë të kënë kryer si pasojë e covidit 12% e grave. Ndjekja në dinamikë e tyre më të gjitha ekzaminimet na tregon për rritje të niveleve të HTA, D-dimerit, infeksioneve urinare, hemorragjisë dhe aritmisë.


Grafiku 2



me vaxinen per covid. Nga te gjitha grate kane kryer abort 2% dhe vetem 1 % ka bere feto-morto.

Grafiku 3

Referuar vizites se pare obstetrikale sipas moshes se shtatezanise kemi tabelen me poshte:



Konkluzione dhe Rekomandime

Pandemia COVID-19 është një situatë e veçantë dhe e rrallë dhe mund të prekë njerëzit fizikisht, por edhe psikologjikisht. Në këtë kontekst, shumë njerëz përjetojnë reagime stresi, ankthi dhe depresioni sidomos kjo në kohën e shtatezenise. Personeli shëndetësor ka bërë një punë heroike dhe voluminoze për të përket qetësimin të situatave problematike, frikës dhe ankthit që ka shoqëruar vitin pandemik duke qëndruar sa më shumë në kontakt të vazhdueshëm me çdo pacient, duke monitoruar online dhe më prezencë fizike çdo shqetësim në mënyrë që situata të krijuar të menaxhohej sa më mirë. Është e rëndësishme të keshillohen grata që të minimizojnë shikimin dhe leximin e lajmeve rreth COVID-19 që i bëjnë ato të ndihen në ankth ose shqetësim;

Rekomandohen të kërkojnë informacione vetëm nga burime të besueshme dhe kryesisht në mënyrë që të mund të ndërmarrin hapa praktikë për të përgatitur planet dhe për të mbrojtur veten.

Të gjithë përjetojnë ankthin në shkallë dhe intensitet individual. Intensiteti i përvojës së ankthit ndikohet me shumë gjate periudhes se shtatezanise **Pikat e forta dhe të dobëta të studimit**

Nga ky studim u pa se informacioni që shkon të grata shtatezane lidhur me frikën dhe ankthin që ato përjetojnë është shumë i rëndësishëm dhe i besueshëm është i plotë dhe këtu del në pah roli i infermierit duke bërë kështu një punë të krenarë për minimizimin e problematikave që mbart pandemia. Pika e dobët nëqelë gjithmone situata e vaksinimit dhe dyshimet që ato paraqesin lidhur me efektet afatgjata që mund të sjellin vaksinat si dhe informacioni që marrin jo në rrugë zyrtare dhe mjekësore.

Referenca:

- <https://www.who.int/teams/mental-health-and-substance-use/covid-19>
- <https://www.camh.ca/en/health-info/mental-health-and-covid-19#quarantine>
- <http://bestpractice.bmj.com/bestpractice/monograph/55/basics/epidemiology.html>
- <http://www.nimh.nih.gov/health/publications/women-and-depression-discoveringhope/how-is-depression-diagnosed-and-treated.shtml>
- <https://www.unicef.org/albania/sq/d>
- <https://www.unicef.org/albania/sq/deklarata-shtypi/grat%C3%AB-shtatz%C3%ABna-dhe-foshnjat-e-lindura-gjat%C3%AB-pandemis%C3%AB-s%C3%AB-covid-19-duhet-t%C3%AB-marrin>
- <https://koronavirus.gov.mk/sq/ballina/mbroj-tja-nga-coronavirus/pyetjet-me-te-zakonshme-ge-behen-ne-lidhje-me-koronavirusin-dhe-rreziqet-e-shtatezenise>

SHKENCAT E EDUKIMIT

Niveli i ulët i vet-vlerësimit tek nxënësit nxit bullizmin në shkollat nëntëvjecare

Dr. Arlinda HALLUNOVI (Ymeri)¹

¹ University of Shkodra "Luigj Gurakuqi", Albania Faculty of Education
Sheshi 2 Prilli, 4001 Shkodër, Albania, arlindahallunovi@live.com.

² Faculty of Education Science; "Luigj Gurakuqi" University, Shkoder, Albania

Abstrakt

Bullizmi është një fenomen i cili ka përhapje tepër të gjerë kryesisht në mjediset e shkollave dhe veçanarisht kur personeli akademik dhe mbeshtetës nuk është prezent. Në këtë fenomen përfshihen pothuajse të gjithë nxënësit ku një pjesë nga të përfshirët janë viktimat e pjesa tjetër agresorë. Ky fenomen ka kohëzgjatje dhe shprehet në forma të ndryshme si ai psikologjik, verbal, fizik, virtual/ kibernetik etj. Kohëzgjatja e bullizmit impaktton edhe komponent të ndryshëm të personalitetit të nxënësit. Në këtë punim do të fokusohemi tek agresioni emocional dhe lidhja e tij me vetëvlerësimin. Vet-vlersimi është një dimension thelbësor në procesin e ndërtimit të identitetit personal.

Hipoteza: Midis sjelljeve bullizuese dhe vlerësimit për vehten ekziston një lidhje korelacionale pozitive çka do të thotë se; *Agresorët (personat që bullizojnë) kanë vetëvlerësim të ulët.*

Qëllimi i punimit është nxitja e praktikave raportuese dhe rritja e vetëdijes rreth fenomenit. Në realizimin e këtij studimi u mplementua pyetësori për fenomenin e bullizmit i gërshtuar me pyetje të pyetësorit të agresivitetit personal, sektori emocional dhe pyetësorit për vet-vlersimin. Në anketim u përfshinë 400 nxënësve të klasave të gjashta në katër shkollave 9-vjecare në qytetin e Shkodrës si Martin Camaj, Mati Logoreci, Ndre Mjeda dhe

Medreseja e vajzave dhe djemve. Kampioni u përzgjedh sipas kampionimit jorasteror (i qëllimshëm). Në total 400 nxënës në katër shkolla nëntëvjecare në qytetin e Shkodrës. Pyetësori është pilotuar në një kampion prej 40 nxënësve dhe është menaxhuar nga ana ime personalisht. Shpërndarja e kampionit sipas gjinise është 52 % (212) femra dhe 48 % (188) meshkuj. Në këtë studim është përdorur studimi anketë dhe korelacional. Pjesa e parë ishte pyetësori i agresivitetit personal verbal dhe pjesa e dytë pyetësori për matjen e vet-vlerësimit të nxënësit. Punimi zbuloi se ekziston një lidhje domethënëse mes dy variablave objekt studimi. Sa më e lartë të jetë prirja bullizuese e agresorit tek nxënësit aq më i ulët është vet-vlersimi i tij real. Por nuk mund të neglizhojmë faktin që vërehet se lidhja mes këtyre dy variablave duke qënë komplekse ndikohen nga një sërë ndryshoresh të cilat duhet të merren në konsideratë për vetë ndikimin e tyre në përfundimet e studimit. Faktet e këtij punimi treguan se sa më i lartë të ishte niveli i bullizmit aq më të prirur janë nxënësit për të reaguar në mënyrë të menjëhershme duke mos e kontrolluar dot impulsin për të dëmtuar të tjerët dhe duke menduar se duke bullizuar ato vetëmbrohen dhe respektohen nga të tjerët.

Abstract

Bullying is a phenomenon that is very widespread mainly in school environments and especially when academic and support staff are not present. Almost all students are involved in this phenomenon, where some of those involved are victims and the rest are aggressors. This phenomenon has duration and is expressed in different forms such as psychological, verbal, physical, virtual/cybernetic, etc. The duration of bullying also impacts different components of the student's personality. In this paper we will focus on emotional aggression and its connection with self-esteem. Self-identity is an essential dimension in the process of building personal identity.

Hypothesis: There is a positive correlation between bullying behaviors and self-esteem, which means that; Aggressors (people who bully) have low self-esteem.

The aim of the paper is to promote reporting practices and increase awareness about the phenomenon.

In the realization of this study, the questionnaire on the phenomenon of bullying was implemented, interwoven with questions of the questionnaire of personal aggressiveness, the emotional sector and the questionnaire for self-evaluation. The survey involved 400 sixth grade students in four 9-year schools in the city of Shkodër, such as Martin Camaj, Mati Logoreci,

Hyrja

Bullizmi është një fenomen i cili ka përhapje tepër të gjerë kryesisht në mjediset e shkollave dhe veçanarisht kur personeli akademik dhe mbeshtetës nuk është prezent. Në këtë fenomen përfshihen pothuajse të gjithë nxënësit ku një pjesë nga të përfshirët janë viktimat e pjesa tjetër agresorë. Një incidencë e lartë e nxënësve tregojnë se kanë patur eksperiencë bullizuese kohët e fundit. Ndërsa dallimet gjinore të përfshirjes dhe të pozicionimit në këtë dukuri janë të dukshme. Bullizmi rezulton të jetë më shumë se një incident i thjeshtë. Ky fenomen ka

Ndre Mjeda and Girls' and Boys' Madrasa. The sample was selected according to non-raster (purposive) sampling. A total of 400 students in four nine-year schools in the city of Shkodër. The questionnaire was piloted on a sample of 40 students and managed by me personally. The distribution of the sample by gender is 52% (212) women and 48% (188) men. Survey and correlational research were used in this study. The first part was the questionnaire of personal verbal aggressiveness and the second part was the questionnaire for measuring the student's self-esteem. The paper revealed that there is a significant relationship between the two variables under study. The higher the bullying tendency of the aggressor among students, the lower his real self-esteem. But we cannot ignore the fact that it is observed that the relationship between these two variables, being complex, is influenced by a number of variables that must be taken into consideration for their own impact on the study's conclusions. The facts of this paper showed that the higher the level of bullying, the more inclined the students are to react immediately, not being able to control the impulse to harm others and thinking that by bullying they are defending themselves and being respected by others.

Key words: bullying, aggressor, self-esteem.

kohëzgjatje dhe shprehet në forma të ndryshme si ai psikologjik, verbal, fizik, virtual/ kibernetik etj. Kohëzgjatja e bullizmit impakton edhe komponent të ndryshëm të personalitetit të nxënësit. Kjo për vetë arsytet se përse ndodh bullizmi ndër të cilat përmendim; pamja e jashtme (i shëndoshë apo i dobët), vështirësia në të folur, mënyra e veshjes, statusi familjarë etj. Bullizmi shfaqet me forma të ndryshme si ai fizik, verbal me anë të fyerjes, nofkave, thashathemeve dashakeqe, shpifjeve, social që do të thotë mënjanim nga grupi shoqëror në

shkollë, ose në festa që organizon klasa, virtual me anë të rrjeteve sociale ku bëhen postimi i fakteve apo thjesht shpifjeve publike, racial nëpërmjet fyersjes dhe dhunës etj. Në këtë punim do të fokusohemi tek agresioni emocional dhe lidhja e tij me vetëvlerësimin. Vet-vlersimi është një dimension thelbësor në procesin e

Ndërtimit të identitetit personal. Ai përforcon një stil përgjigjeje të individit ndaj vetes dhe shoqërisë dhe më saktë koncepti për të vlersuar vlerën dhe rëndësinë e tij si person, në vetdije për ti u referuar vetes (Baumeister, 1998). Vet-vlersimi, sukses,-prespektive, raport-ballafaqim midis suksesit konkret të marrë dhe pritshmërive koresponduese të subjektit W. James. Vetvlersimi ka të bëjë me faktin nëse ju e shihni veten në mënyre pozitive apo negative. Vetëvlersimi i larte do të thotë se ju e pëlqeni veten dhe se ndiheni kompetent. Nga ana tjetër veëtvlerësimi i ulët do të thotë se ju nuk e pëlqeni veten dhe se nuk ndiheni kompetent.

Objektivat:

1. Të tregojmë çfarë është bullizmi cilat janë pasojat e tij?
2. Në cilat komponent të personalitetit ka impakt ky fenomen?
3. A ekziston një lidhje mes bullizuesit dhe vetëvlerësimit që ai ka për vehten?

Qëllimi:

1. Njohja më e gjerë e fenomenit dhe zgjerimi i politikave asgjësuese.
2. Gjenerimi i teknikave parandaluese dhe promovimi i normave kundërbulliste
3. Nxitja e fushatave dhe trajnimeve të vazhdueshme për rritjen e vetëdijes rreth këtij fenomeni.

4. Nxitja e praktikave raportuese dhe afirmimi i stafit të shkollës që merret me fenomenin dhe ta adresojnë atë në mënyrë efektive.

Fjalët kyce: bullizimi, agresori, vet-vlersimi

Detyrat kërkimore:

- Identifikimi i elementeve karakterizues të agresorit dhe faktorët që çojnë nxënësit në sjellje agresive.
- Të kuptohet lidhja që ekziston ndërmjet nivelittë agresivitetit personal/emocional dhe vet-vlersimit.
- Të zbulojë shpeshësinë e shfaqjeve të sjelljeve agresive.
- Të zbulojë nivelin e agresivitetit verbal tek nxënësit.
- Të njihet niveli i vet-vlersimit negative dhe atij pozitive tek nxënësit.
- Të zbulojë si lidhet shfaqja e agresionit verbale me vet-vlersimin e lartë dhe të ulët.
- Té zbulojë si shfaqen karakteristikat e sjelljeve agresive tek të dy llojet e nxënësve femra dhe meshkuj.
- Në cilën mënyrë mund të lidhet niveli i agresivitetit personal me vet-vlersimin.
- Në ç mënyrë shfaqen lidhjet midis gjinisë së nxënësve dhe shfaqjes së sjelljeve agresive verbale.

Hipoteza

Midis sjelljeve bullizuese dhe vlerësimit për vehten ekziston një lidhje korelacionale positive ç ka do të thotë se;

Agresorët (personat që bullizojnë) kanë vetëvlerësim të ulët.

Metodologjia

Për të realizuar këtë studim fillimishit u rishikuan studimet ekzistuese mbi bullizmin. Një pjesë e studimeve janë eksperimentale e një pjesë korelacionale. Një pjesë e mirë e ndryshoreve të bullizmit të studiara në vendet e tjera gjejnë shtrirje edhe në realitetin

shqipëtarë. Ky informacion u mblodh nëpërmjet pyetësorit për fenomenin e bullizmit i gërshetuar me pyetje të pyetësorit të agresivitetit personal, sektori emocional dhe pyetësorit për vet-vlersimin. Në anketim u përfshinë 400 nxënësve të klasave të gjashta të katër shkollave 9-vjeçare në qytetin e Shkodrës si: Martin Camaj, Mati Logoreci, Ndre Mjeda dhe Medreseja e vajzave dhe djemve.

Kampionimi

Kampioni u përzgjedh sipas kampionimit jorasteror (i qëllimshëm), ku grupi përbëhej nga nxënës të klasave të gjashta të cilët pranuan të merrnin pjesë në studim. Në total 400 nxënës në katër shkolla nëntëvjeçare në qytetin e Shkodrës.

Çështjet etike dhe konfidencialiteti ishin sqaruar që në fillim. Ata ishin të shkruara në krye te pyetësorit dhe u bënë të ditura gojarisht para plotësimit të pyetësorit. Pyetësi është pilotuar në një kampion prej 40 nxënësve dhe është menaxhuar nga ana ime personalisht. Shpërndarja e kampionit sipas gjinise është 52 % (212) femra dhe 48 % (188) meshkuj. Meqënëse studimi interesohet për lidhjen mes variablit të agresivitetit verbal dhe vetvlersimit si dhe të ndryshoreve demografike si gjinia, e meqenese ndryshori moshë ishte një nga elementët përzgjedhës (kampion i qëllimshëm) nuk janë mbledhur të dhëna për ndryshore të tjera të lidhura me këtë kampion. Studimi respekton çështjet etike të cilat lidhen me lejen e informuar të nxënësve. Ato u informuan fillimisht nga mësuesja dhe, pasi pranuan në parim u informuan nga unë me detaje në lidhje me qëllimin, kushtet dhe metodat e studimit që do të përdreshin. Nxënësit që morën pjesë në studim iu bë e ditur se të gjitha të dhënat e mbledhura prej tyre do të përdreshin vetëm për qëllime studimi dhe se do të respektohej anonimat i tyre. Në këtë punim janë shmangur mashtrimi dhe deklarimi i të dhenave personale.

Instrumentat matës

Në këtë studim është përdorur studimi anketë dhe korelacional. Për të matur nivelin personal të agresivitetit verbal është përdorur një shkallë me sjelljet agresive nga BUSS, DURKEE, 1957,

BIAGGIO, 1980. Studimi dhe informacion për matjen e agresivitetit verbal dhe shkalla e Rosenbergut u përdor për matjen e vetvlersimit. Instrumenti matës i përdorur këtu është bazuar në këtë shkallë dhe përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë ishte pyetësi i agresivitetit personal verbal dhe pjesa e dytë pyetësi për matjen e vetvlersimit të nxënësit. Këto instrumenta janë përdorur për të zbuluar lidhjen midis nivelit të agresivitetit verbal dhe vetvlersimit që është edhe hipoteza e studimit. Pyetësorët janë përkthyer nga anglishtja dhe janë paratësuar në një grup të vogël prej 40 nxënësish para administrimit. Më pas disa nga pyetjet janë rishikuar në mënyrë që të përmisoheshim. Por paratestimi nuk është bërë me qëllim matjen e koeficientit të besueshmerisë, meqënëse nuk kam patur kohën e nevojshme si edhe mundësinë për të përzgjedhur një kampion rastësorë.

Pyetësi i agresivitetit personal

Për të matur nivelin e agresivitetit personal verbal, nxënësit duhet të tregonin mënyrën me të cilën ato kanë reaguar ndaj secilës situatë të caktuar. Agresiviteti emocional është i qëllimshëm, duke i përgjigjur pyetjeve me po ose jo jepet qëndrimi i nxënësve ndaj çdo mundësie zgjedhjeje. Pyetësi i agresivitetit personal përmban 23 çështje për agresivitetin në tërësi por ky punim është bazuar vetëm në agresivitetin verbal. Për çdo pohim nxënësi duhet të përgjigjet po ose jo.

Pyetësi i vetvlersimit

Shkalla e vetvlersimit e Rosenbergut është një shkallë Likert që përmban çështje të cilat masin nivelin me të cilin çdo individ e vlerëson veten e tij si person me vetvlerësim të lartë apo person me vetvlerësim të ulët në varesi të shkallës me të cilën është dakord me çështjet e ndryshme të pyetësorit. Pyetësi përmban 10 pohime, ku subjekti duhet të përcaktojë shkallën me të cilën është dakord për çdo pohim, me anë të një renditjeje prej katër pikëve që varion nga (0 aspak dakord) dhe (3 shumë dakord). Pyetësorët kanë një shkallë të lartë qëndrueshmërie të brendëshme si instrumenta matës.

Rezultate

Analiza e rezultateve synon të përcaktojë lidhjen e rezultateve të pyetësorit të agresivitetit verbal dhe të pyetësorit të vet-vlerësinnt. Për këtë arsye është kryer analiza e shpeshësisë së rezultateve për çdo shkallë force mes1-nivelit personal të agresivitetit verbal ku identifikohet agresori dhe 2-shkallës së vetvlerësimit. Duke analizuar ndryshoret e të dy pyetësorëve rezultoi një lidhje logjike dhe objektive mes dy variablave objekt studimi që janë agresioni verbal i agresorit dhe vetvlerësimit.

Resultatet e studimit treguan se ka një marrëdhënie ndërmjet agresorit dhe vetvlerësimit dhe kjo marrëdhënie korelon pozitivisht. Agresori korelon pozitivisht me vetvlerësimin e ulët. Pra të dy këto variabla ndikojë tek njëri-tjetri reciprocikisht. Agresiviteti verbal është një tjetër variabël që do të analizohet, në mënyrë që të shihet shkalla në të cilën nxënësit e përdorin atë si formë efektive për të zgjidhur situatat e papërshtatshme të jetës së tyre.

Pyetjet me impaktin më të lartë në korrelimin e variablave veçoj:

Shpesh nuk bie dakord me njerëzit.

63% e të anketuarve deklarojnë se nuk bien dakord me ato që thonë të tjerët shpesh ndaj edhe kanë probleme në marrjen e vendimeve, ndërsa më tepër se 37% e tyre pohojnë se një gjë e tillë nuk ndodh shpesh, duke shfaqur një shkallë shumë më të ulët të rasteve kur opinioni i tyre nuk përputhet me atë të të tjerëve. Mes vajzave dhe djemve ka një ndryshim që është domethënës në favor të djemve të cilët shprehen se u ndodh shumë më shpesh që të mos bien dakord dhe ta shprehin këtë qëndrim.

I fyej ato që më kundërshtojnë.

Këtu me shume se 72% e agresorëve shprehen se sulmojnë verbalisht ata që i kundërshtojnë. Duke shfaqur një shkallë të lartë të mospranimit të kundërshtimit dhe një agresivitet verbal që përdoret gjerësisht prej tyre në këtë rast, ndërsa ndër ato të cilët nuk fyejnë ata të cilët i kundërshtojnë përbëhet nga rreth 27% e të anketuarve të cilët nuk përdorin agresivitet

verbal ndaj kundërshtarëve të tyre. Këtu numrin e atyre më agresiv e përbëjnë femrat të cilat shfaqin një shkallë më të lartë të nevojës për të sulmuar ata që i kundërshtojnë, ndërsa meshkujt tregohen më tolerant.

Kërkoj që njerëzit të respektojnë të drejtat e mia.

Kur më bërtasin edhe unë u bërtas. Në lidhje me këtë pohim rreth 49% e nxënësve reagojnë në të njëjtën mënyrë si dhe personi me të cilin po ndërveprojnë, pra duke përdorur të njëjtin agresivitet verbal si dhe bashkëfolësi, ndërsa rreth 50% e tyre deklarojnë se priren të ruajnë situatën të ekuilibruar duke mos rënë në nivelet e bashkëfolësit.

Kur nevrikosem fajin e kanë të tjerët.

Është vërejtur se ka një prirje të lartë tek vajzat për të përdorur justifikimin për të ruajtur vetvlerësimin e tyre. Në krahasim me djemtë të cilët nuk shprehen aq shume në këtë drejtim. Më tepër se 47% e të pyeturve përgjigjen se përdorin fajsimin ndaj personit tjetër kur janë të nevrikosur, ndërsa pjesa tjetër prej afro 52% pohojnë se kur janë të nevrikosur nuk thonë justifikimi për veprimet e tyre, duke shfaqur në këtë mënyrë një tendencë për të menaxhuar situatën në të tilla momente. Tek meshkujt shfaqet më e lartë kjo tendencë në krahasim me vajzat

Shpesh bëj kërcënime pa i menduar vërtetë.

Rreth 53% e nxënësve shprehen se shpesh bëjnë kërcënime pa e menduar vërtetë duke u përfshirë në një agresivitet verbal në kufinj të lartë në situata të caktuara, ndërsa një pjesë prej 46% shprehen se nuk bëjnë kërcënime për të friksuar tjetrin për kot. Tek femrat është me e theksuar prirja për të kërcënuar apo për të thënë gjëra të rënda të cilat më vonë nuk finalizohen në veprime reale të dhunshme.

Kur zihem prirem të ngre zërin.

Në afro 52% e të anketuarve deklarojnë se priren ta ngrenë zërin kur zihen me dikë, ndërsa pjesa tjetër prej rreth 47% të nxënësve thonë se nuk e bëjnë një gjë të tillë. Tek meshkujt shihet më e theksuar tendenca për të folur me zë të

lartë kur zihen me bashkëbiseduesin në krahasim me vajzat.

Vetvlerësimi i nxënësve

Mendoj se kam një numër cilësish të mira.

Rreth 34 % e të anketuarve deklarojnë se kanë një numër cilësish të mira duke e parë vehten e tyre të aftë dhe me cilësi positive. Ndërsa afro 65% e të anketuarve pohojnë se relativisht kanë një numër të caktuar cilësish të mira. Meshkujt shprehen më në favor të të paturit të një numri të caktuar cilësish të mira në krahasim me femrat të cilat nuk shprehen bindshëm për ekzistencën e këtyre cilësive.

Mendoj se nuk kam ndonjë gjë për të qënë krenar.

Në anën pozitiv janë rreth 37% e nxënësve që mendojnë që kanë cilësi për tu krenuar. Ndërsa mesatarja e atyre që janë pak dakord me pohimin e mësipërm e përben rreth 48% e tyre, rreth 9% të të anketuarve shprehen se janë dakord me pohimin që nuk kanë ndonjë gjë përse të jenë krenar. Dhe rreth 5% e nxënësve përgjigjen se janë krenarë për cilësitë që ato kanë. Vërehet se numri i femrave është më i lartë si në rastin pozitiv dhe atë negative për përgjigjet polarizuese në krahasim me meshkujt të cilët shfaqen më të moderuar.

Të qënit në gjëndje për të bërë gjërat si pjesa me e madhe e njerëzve.

Rreth më shumë se 39% e të anketuarve deklarojnë se janë ekstremisht dakord me faktin se janë të aftë ti bëjnë gjërat njësoj si pjesa me e madhe e njerëzve. Ndërsa rreth 28% janë relativisht dakord me këtë fakt, dhe 23% e tyre pohon se është pak i aftë që ti bëjë gjërat si pjesa më e madhe e njerëzve. Ndërsa ekstremi negativë përbën rreth me shume se 8% të atyre që shprehen se janë të paaftë ti bëjnë gjërat njësoj si pjesa më e madhe e njerëzve. Në këtë rast kategorinë që ndodhet në ekstreme e përbëjnë në të dy rastet meshkujt që janë në përqindje me të lartë se femrat

Ndjehem si njeri koti herë pas here.

Rreth 19% e nxënësve deklarojnë se janë shumë dakord me pohimin se ndihen si njerëz koti herë pas herë, ndër ato që shprehen se janë dakord përbëjnë rreth 18% të tyre mesatarja e atyre që janë pak dakord me pohimin, që ndihen si njeri koti herë pas here është 21%. Dhe përgjigjen ekstreme pozitive e jep rreth 31% e atyre të cilët nuk ndihen aspak kot. Meshkujt zënë të dy skajet e përgjigjeve si atë pozitive dhe atë negative, ndërsa femrat janë më të moderuara ndaj ekstremitetëve.

Ndjej se vlej të paktë sa të tjerët.

Pak më tepër se 58% e nxënësve shprehen janë në të njëjtin nivel si ë tjerët. Afro 24% e nxënësve shprehen shumë dakord, 17% e tyre shprehen jo shumë dakord në lidhje me faktin se sa ato vlej. Në ekstemin pozitivë, pra të atyre që janë shume dakord në lidhje me pohimn e mësipërm e përbëjnë meshkujt, ndërsa femrat kanë një % me të madhe në pjesën negative.

Do të doja të kisha një qëndrim më pozitiv ndaj vetes.

Rreth 35% e tyre bien ekstremisht dakord me pohimin se do të donin të kishin një qëndrim më pozitiv ndaj vetes, 25% e tyre bien dakord me qëndrimin që ato kanë ndaj vetes dhe rreth 25% të të anketuarve përgjigjen se kanë një qëndrim pozitiv ndaj vetes. Në ekstremitetin pozitiv janë rreth 14% e nxënësve. Meshkujt shprehen në një % më të madhe në krahasim me vajzat në lidhje me domosdorshmërinë për të patur një qëndrim me potiv ndaj vetes dhe të njëjtin qëndrim mbajnë edhe për skajin tjetër të përgjigjeve.

Gjithnjë mendoj se jam një dështak

Ekstremi pozitiv përbëhet nga afro 10% e të anketuarve të cilët nuk janë aspak dakord. Ndërsa rreth 10% e tyre janë pak dakord me pohimin dhe rreth 67% e tyre janë mesatarisht dakord me të duke shfaqur një tendencë për vlerësim të ulët ndaj vetes. Kurse në ekstemin negativ janë më shumë se 12% e atyre që shprehen plotësisht dakord me të menduarit për veten si një dështim. Femrat shprehen më negativisht në lidhje me veten krahasuar me

meshkujt, kjo e influencuar edhe me faktorë të tjerë implikues përfshirë këtu edhe moshën.

Kam një qëndrim pozitiv ndaj vetes.

Ekstremisht dakord me të paturit e një qëndrimi pozitiv ndaj veten janë më tepër se 23% e nxënësve. Ndërsa relativisht dakord është 6% e tyre, dhe mesatarisht rreth 56% janë në dyshim në lidhje me qëndrimin që kanë ndaj vetes. Duke treguar luhatje dhe ekstremisht jodakord me qëndrimin pozitiv ndaj vetes është më shumë se 5% e nxënësve. Meshkujt në krahasim me femrat kanë një qëndrim më pozitiv ndaj vetes.

Sa të kënaqur janë me vehten.

Ekstremisht të prirur për të qënë të kënaqur me veten janë 30% e nxënësve. Ndërsa në ekstremin tjetër janë 27% e të anketuarve të cilët nuk janë aspak të kënaqur me veten. Dhe afro 30% e tyre janë të prirur për të qënë të kënaqur me veten dhe afro 12% janë mesatarisht pak të kënaqur me veten. Këtu meshkujt pohojnë se janë më të kënaqur me veten, në krahasim me vajzat të cilat shfaqin një përqindje më të lartë të mospëlqimit të vehtes.

Ndjehm i paaftë në çdo gjë që bëj.

Në skajin ekstrem të atyre që mendojnë për vehten e tyre si të paaftë për atë që ndodh në jetën e tyre janë afro 3% e të anketuarve, ndërsa në skajin pozitiv të atyre që mendojnë se janë të aftë e përbëjnë rreth 52% e të anketuarve. Ndërsa rreth 14% e tyre janë relativisht dakord me faktin që nuk janë të aftë për gjë, dhe një mesatare prej 30% janë më pak dakord me të qenit jo i aftë. Meshkujt shfaqin një vlerësim negativ më të madh në krahasim me femrat të cilat përbëjnë një përqindje më të lartë të atyre që e shohin veten si të paaftë.

Lidhja ndërmjet vet-vlersimit dhe agresionit verbal.

Ndërmjet agresivitetit verbal dhe vetëvlersimit të ulët rezulton të ketë një korelacion pozitiv. Kjo do të thotë se bullizuesi prirret të ketë përgjithsisht vlerësim të ulët për vehten. Sa më i ulët vet-vlersimi i nxënësit rreth vetes së tij aq më i prirur shfaqet ai që ti zgjidh çështjet e

ndryshme të jetes së përditshme përmes sjelljeve bullizuese. Një mënyrë kjo që e bën të riun të projektojë tek tjetri frikën që ndjen brenda vehtes dhe si për tu mbrojtur hidhet në sulm pa asnjë motivacion të jashtëm. Sa më bullizues të shfaqet nxënësi aq më i pasigurtë është ai në përballimin e situates, duke qënë se vet-vlersimi i tij është i ulët ai prirret drejt një reagimi bullizues. Kjo pasi mënyra e tij e të funksionuarit është e tillë që ai të mbështet fort tek sjellja bullizues. Sa më i ulët vet-vlersimi i individit aq me bullizues do të jetë ai ndaj të tjerëve. Bullizimi afektohet edhe nga shumë variabla të tjerë që e bëjnë këtë fenomen të komplikuar dhe kompleks njëkohësisht.

Nr	Pyetja	Shpesh	Jo shpesh
1	Unë nuk bie dakort me njerëzit.	63%	37%
2	Unë i fyej njerëzit.	72%	27%
3	Unë kërkoj të më respektojnë të drejtat e mija.	49%	50%
4	Kur nevríkosem fajin e kanë të tjerët.	47%	52%
5	Unë kërcënoj pa e menduar.	53%	46%
6	Kur zihem unë bërtas.	52%	47%
7	Mendoj se kam shumë cilësi të mira.	34%	65%
8	Mendoj se nuk kam ndonjë gjë për të qënë krenarë.	37%	9%
9	Jam në gjëndje për të bërë gjëra si të gjithë të tjerët.	39%	51%
10	Ndjehem si njeri koti.	19%	21%
11	Vlej më pak se të tjerët.	24%	17%
12	Dua të vlerësoj më shumë vehten.	35%	14%
13	Gjithmonë mendoj se jam një dështak.	67%	22%
14	Kam qëndrim pozitiv ndaj vehtes.	23%	56%
15	Jam i kënaqur me vehten.	30%	12%
16	Ndjehem i aftë për çdo gjë.	3%	52%

Përfundime

Punimi zbuloi se ekziston një lidhje domethënëse mes dy variablave objekt studimi. Sa më e lartë të jetë prirja bullizuese e agresorit tek nxënësit aq më i ulët është vet-vlersimi i tij real. Por nuk mund të neglizhojmë faktin që vërehet se lidhjet mes këtyre dy variablave duke qënë komplekse ndikohen nga një sërë ndryshorësh të cilat duhet të merren në konsideratë për vetë ndikimin e tyre në përfundimet e studimit. Faktet e këtij punimi treguan se sa më i lartë të ishte niveli i bullizimit aq më të prirur janë nxënësit për të reaguar në mënyrë të menjëhershme duke mos e kontrolluar dot impulsin për të dëmtuar të tjerët dhe duke menduar se duke bullizuar ato vetëmbrohen dhe respektohen nga të tjerët. Sa më i lartë të jetë niveli i bullizimit tek nxënësit aq më shpesh u shprehin shokëve mospëlqimin ndaj sjelles së tyre. Po aq shpesh ata nuk bien dakord me njerëzit aq me tepër me ngulm kërkojnë që njerëzit të respektojnë të drejtat e tyre. Kjo është tendencë më së shumti për nxënësit të cilët kur nevrifikoset thonë gjëra të pakëndëshme. Apo edhe për ato që janë të prirur për të bërë edhe kërcënime verbale që e finalizojnë me ngritje zëri apo përtallje.

Tek nxënësit shqiptar dimensionet e vet-vlersimit janë të lidhura në mënyra të ndryshme me bullizimin. Studimi zbuloi se sa më i ulët të jetë vet-vlersimi i nxënësve aq më të prirur për të menduar për veten si të paafte për gjërat në jetë ato janë dhe aq më frekuent është mendimi se nuk kanë ndonjë gjë për të qënë krenar për veten. Sa më i shpesht mendimi se ndihen si njerëz koti here pas here aq më i lartë mendimi se ato janë një dështim. Sa më i ulët vet-vlersimi i nxënësve aq më pak të kënaqur janë ato me veten. Ato janë aq më të prirur për të menduar se kanë një numër cilësish të mira.

Punimi zbuloi se bullizimi kishte një shpërndarje mesatare dhe nuk ishte i pranishëm në nivele të larta tek nxënësit në qytetin Shkodër. U vërtetua se kishte një tendencë në rritje të bullizimit kur bëhej fjalë për të mbrojtur të drejtat e tyre apo kur ndjehen të cënuar. Studimi zbuloi se nxënësit me vet-vlersim të ulët kanë prirjen që të përdorin bullizimin si një formë e përshtatshme në situata të ndryshme në

mjediset e shkollës. Nxënësit me vet-vlersim të ulët kanë tendencën që të tregohen më protective ndaj vehtes dhe bullizojnë të tjerët. Këtë qëndrim e mbrojnë me forcë si çështje me rëndësi etike pa asnjë lloj lëshimi që u cenon integritetin personal. Femrat shfaqin nivele më të larta bullizimi në krahasim me meshkujt edhe pse edhe meshkujt shfaqin një nivel të konsiderueshëm të tendencave bullizuese. Femrat janë më të prirura për të reaguar më shpesh përmes agresivitetit verbal pra ato bërtasin, shajnë, bëjnë kërcënime dhe shprehin më hapur pakënaqësit e tyre ndaj të tjerëve. Në krahasim me meshkujt të cilët kanë vet-vlersim më të lartë dhe janë në përqindje më të madhe në krahasim me femrat të cilat shfaqen në nivel më të lartë në numër në dimensionin e vet vlersimit të ulët. Pra meshkujt shfaqin një qëndrim më pozitive si ndaj vetes dhe ndaj jetës ndërsa vajzat e shohin veten si më të lëkundura në këtë aspekt.

Rekomandime

Bazuar në rezultatet e punimit dalim në disa rekomandime në ndihmë të mësuesve dhe të psikologëve shkollorë që të menaxhojnë situatat bullizuese në mjediset e shkollës. Të flitet në mënyrë të vazhdueshme dhe të mbahen trajtime për programe vet-kontrolli si:

1-Analizimi i sjelljes bullizuese

2-Vëzhgimi dhe vetmonitorimi i sjelljes bullizuese

3-Planifikimi i ndryshimit në sjellje

4-Evidentimi i progresit

5-Shpërblimi dhe aplikimi i përforcuesve

6- Vënia në jetë e sjelljeve të reja

7- Shpjegimi i benefiteve për secilin të sjelljeve që ato demostrojnë.

Referencat

1. *Perhapja e bullizimit në sistemin tonë arsimor sipas një studimi ne vitin 2017*

- nga autorët:: Edmond DRAGOTI (Prof. Dr); Emanuela ISMAILI (Dr.)
2. Barbera, Firenze. fq 248-250 3-
Donnerstein. D. *Aggression Theoretical*
 3. Ylli Pango, *Psikologii sociale, 1995, Korbi, fq 67-68*
 4. J. Oléus, *L'aggressivita nella scuola, Bulzoni (edizione italiana del 1983) fq 9-12*
 5. M. Linneëber, *Personalita e aggressivita, 1984, Coprara. V, Roma, Bulzoni, fq 231*
 6. H. Selg, *The making of human aggression, 1976, P. Meazzioni, Ce. P. A. S. A. fq 18-20*
 7. Alfred Adler, *C" kuptim mund te kete jeta, 2003, Plejada, fq 49-54*
 8. *Bullies and victims: Children abusing children. American Journal of Dance Therapy, 19, 127-133 Galloëay, D & Roland, E. (2004)*
 9. *Bullying at school: Basic facts and effects of a school based intervention program. Journal of Child Psychology and Psychiatry, 35, 1171-1190*
 10. *Prevalence Estimation of School Bullying ëith the Oléus Bully/Victim Questionnaire, Journal of Aggressive Behaviour, 29, 293- 268. Roberts*
 11. *Relational aggression, gender, and social psychological adjustment. Child Development, 66, 710-722. Selekman, J., & Vessey, J. (2004). Bullying: It isn't ëhat it used to be. Kidbits Vol 30 No 3.*

Muzika, faktor i rëndësishëm edukativ dhe terapeutik për fëmijët me vështirësi në të nxënë

Dr. Eliona Lici

Lektor

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë

Eliona.lici@univlora.edu.al

Abstrakt

Muzika si një faktor i rëndësishëm edukativ por edhe terapeutik është njohur që në kohët e hershme të njerëzimit, por vetëm pas Luftës së II Botërore nisi të njihet termi "Muzikoterapi" përkatësisht rreth viteve 1950 dhe baza shkencore për të nisi të krijohet po në këtë periudhë. Muzika si terapi përdoret gjerësisht në disa sfera, si ajo e mjekesise, pedagogjisë speciale, si dhe në institucionet për mbrojtjen e shëndetit mendor.

Muzika dhe rrjedhimisht muzikoterapia, ndikon tek fëmijët me vështirësi në të nxënë dhe aftësi të kufizuara, me probleme të sjelljes, humbje të dëgjimit çrregullime të spektrit autik etj. Më specifikisht muzika në edukimin special nxit fëmijët të integrohen në një shumësi aspektesh të zhvillimit të tyre, si fusha e perceptimit, lëvizjes, komunikimit, zhvillimit gjuhësor, shoqëror dhe zhvillimi i lidhjeve ndërpersonale. Qëllimi i artikullit qëndron në informimin teoriko-praktik të edukatorëve dhe

mësuesve të muzikës në arsimin e përgjithshëm dhe atë special përmes rasteve konkrete kryesisht me disleksi për të përmirësuar planet individuale të punës, por, njëkohshëm të konsolidohen strategji të reja mësimdhënieje në këndim dhe instrumentin e pianos.

Music as an important educational but also therapeutic factor has been known since the earliest times, but only after World War II the term "Music therapy" began to be known around the 1950s and the scientific basis for it began to be created in this period. Music as therapy is widely used in some fields, such as medicine, special education, as well as in institutions for the protection of mental health. Music and music therapy, positively impacts with learning difficulties and disabilities, behavioral problems, hearing loss, autism spectrum disorders, etc. More specifically, music in special education encourages children to integrate into a variety of aspects of their development, such as the areas of perception, movement, communication, language development, social development and interpersonal connections. The purpose of the article is to provide theoretical and practical information to music educators and teachers in general and special education through concrete cases, mainly with dyslexia, to improve individual work plans, but at the same time to consolidate new teaching strategies in singing and playing instruments.

1. Hyrje

Duke qenë se në vendin tonë mungojnë strukturat e posaçme për të siguruar një mjedis edukues përmes muzikës në arsimin special në institucionet arsimore si dhe ato jashtë shkollore përsa kryesore i bie mësuesit të muzikës dhe mësuesit ndihmës, i cili duhet të jetë i mirëinformuar për rolin e muzikës si edukim për të gjithë fëmijët në përgjithësi dhe për ata me nevoja ndryshe në veçanti. Muzika në shkolla, por edhe në mjediset jashtë shkollore krahas edukimit me konceptet muzikore dhe argëtimit duhet të sigurojë hapësirën e duhur edhe për fëmijët me nevoja ndryshe për t'u përfshirë në veprimtaritë artistike. Shpesh neuropsikologët e vlerësojnë mësimin e muzikës si proces njohës, pasi përftojnë koncepte muzikore, por edhe si zhvillim, që kontribuon në përmirësimin aftësive si koordinimi lëvizor, gjuha, përqendrimi dhe kujtesa. Shumësia e hulumtuesve dakortësohen se një individ me vështirësi në të nxënë mund të përfitojë nga muzika dhe nga lëndët e tjera vetëm atëherë kur ndërjegjësohet dhe njih vështirësinë sa më herët. Në rastin e *Disleksisë* një nga vështirësitë që has fëmija është njohja e partiturës muzikore, simbolet në pentagram që i duken sikur "fluturojnë" duke i provokuar ngarkesë emocionale dhe lodhje. Përshembull, shpesh herë ndodh që fëmijët me *disleksi* të mos dallojnë timbrin e ndryshëm dhe potencën tingëllore. Një linjë e elementëve të muzikës që i lodh fëmijët me disleksi është *tempi, ritmi*, saktësia ritmike, mundimi që të jenë të saktë gjatë këndimit të këngës apo luajtjes në instrument. Dallimi i lartësisë së tingullit është një nga vështirësitë që vërehet si dhe aritmia. Për fëmijët disleksikë nevojitet kohë më tepër që të arrijnë të stabilizojnë ndjesinë e brendshme të lartësisë tingëllore. Fëmijët me disleksi kanë perceptim pak më të reduktuar ndaj kohës dhe drejtimeve, por kanë tendencën të këndojnë mire. (Beaumont, 1992:13) Krahas edukimit me muzikë, të ushtruarit me këngën dhe instrumentin ka ndikim thelbësor në procesin e të mësuarit. Instrumenti i pianos mund të konsiderohet si një nga instrumentet më komplekse, që kombinon njëkohshëm të gjitha

shqisat, dhe për këtë mund të jetë efektiv në trurin e fëmijës.

2. Metodologjia:

Në këtë punim u rishikua literatura në lidhje me muzikën dhe fëmijët me nevoja speciale dhe veçanërisht muzika dhe Disleksia, duke riparë një program trajnimi gjysmë të strukturuar për këngë dhe piano. Duke zbatuar programin e strukturuar synohet të përshkruhet procesi në detaje dhe të përforcohet efekti terapeutik i trajtimit përmes këngës e pianos. Të dhënat u mbledhën dhe u vlerësuan me analiza përshkruese. Analiza kryesisht mbështetet në testet muzikore të realizuara në raste konkrete me disleksi ku veprimtaritë muzikore mbështeten në improvizim vokal dhe instrumental. Përmes vlerësimeve formuese të ndërveprimit të dy rasteve nisur prej përvojës personale prej punëve të kryera me fëmijë me nevoja speciale, evidentohet se roli i muzikës rrit cilësinë e jetës tek individët me aftësi ndryshe.

2.1

Punimi u realizua me disa teste muzikore për të matur, talentin muzikor, aftësitë muzikore dhe njohurive muzikore të fëmijës. Testet mbështeteshin në ushtrime ritmike, shpejtësinë e metrit dhe të lartësisë tingëllore, duke përdorur shpesh këngën "*Endërr*" dhe "*Happy Birthday to you*" në vokal dhe piano "*Twenke Twenkle little star*". Përfundimet treguan se aftësitë e koordinimit të shpejtë dhe ritmit që kërkojnë shpejtësi bëhen aspekte të vështira për fëmijët me disleksi. Aftësia e mbajtjes së tempit dhe dallimi i lartësisë së tingullit u dukën më pak problematike, ashtu si dhe mundësitë që lidhen me lartësinë dhe potencën tingullore.

Një gjetje tjetër ishte ndërlidhja nëpërmjet ortografisë dhe mundësisë për të mbajtur ritëm të njëtrajtshëm afësi që bazohen dhe i përmbahen deri në një masë të caktuar mundësive fonologjike dhe aftësive të ndarjes së rrokjeve të një kënge. Këto rezultate tregojnë se koordinimi është një aspekt vështirësie për

fëmijët disleksik dhe për rrjedhojë duhet bërë kujdes në proceset ritmike dhe ekzekutimet e shpejta muzikore gjatë mësimdhënies. Kërkimi sugjeron veprimtari muzikore të bazuara tek këngët dhe lojrat ritmike, përmes së cilave fëmija me disleksi mund të zhvillojë aftësi gjuhësore, koordinimin dhe përmirësimin e perceptimit verbal.

Gjatë punës sugjerohen mënyra të dëgjimit muzikor që shërbejnë si mjete për kultivimin e ndjeshmërisë dëgjimore dhe përballimin e vështirësive në gjuhë dhe komunikim, të bësh muzikë është një veprimtari që kërkon aftësi të sakta muzikore, koordinim dëgjimor dhe aftësi mekanike, ndërsa të prodhuarit muzikë është një veprimtari poliedrike dhe njihet se mësimet me këtë karakter janë një mënyrë e çmuar mësimdhënieje për fëmijët disleksik. Përparësia që kanë veprimtaritë muzikore është se e tejkalojnë mësimdhënien tradicionale dhe ndërlihdin aktivitetin e njohjes dhe shkrimit.

2.2

Gjatë seancave të edukimit muzikor tek nxënësja nga vrojtimi personal për më tepër se 4 muaj në 16 tema të edukimit muzikor te vajza me disleksi (I.A), u vu re se në ditët që ishte aktive kryesisht në këndim dhe *body percussion*¹, në proces nuk paraqiti ndonjë vështirësi në ndarjen e karakteristikave të instrumenteve, në ruajtjen e qetësisë duke respektuar rradhën e vet për të luajtur në instrumente muzikore si dhe në shkrimin e ushtrimeve muzikore. Nxënësja paraqiti interes të veçantë për këndimin dhe këngët, pasi vokali paraqet një urë lidhëse mes trupit, mendimit dhe ndjesive. E kënduara bëhet e kuptueshme, pasi i referohet një situatë me kuptim të veçantë personal. Kjo është dhe arsyeja bazë që kënga shërben si mjet terapeutik. (Austin,1993:143) .

Disa nga parametrat e vrotimit ishin imitimi, përgjigje lëvizore, variacion,

¹ Përdorimi I trupit si instrument me goditje, shuplaka ne duar, në këmbë

vetëshprehje me anë të zërit, përgjigje me anë të tingujve prodhuar nga instrumentet.

2.3 Vështirësitë që u hasën

E vetmja vështirësi që mund të përmendet ishte përmirësimi i veshit melodik, për të siguruar një intonacion më të saktë. Kënga, si formë edukuese dhe argëtuese njëkohësisht u bë motivim për nxënësen duke qenë pjesë e grupit koral të klasës dhe duke ecur paralelisht me ta.

Komente të përgjithshme

U krijuan kushtet e përshtatshme, që nxënësja të kishte mundësinë të bënte zgjedhje dhe të ndërmerre nisma. •Nxënësja në përgjithësi paraqiti një ngurtësi në ndryshimin e mënyrës së lojës. Pavarësisht nga alternimet e sugjeruara nga mësuesi i muzikës shumicën e kohës mbante një ritëm konstant. •Vëmendja e nxënësës u tërhoq kur ndodhi një improvizim i shkurtër vokal ku me anën e zërit u imituan modelet ritmike që u luajtën në (instrumentin perkusiv, timpan). Dy rezultate efikase nga ky aktivitet lidhen drejtpërdrejt me aftësitë e komunikimit të nxënësit, por edhe kënaqësinë që ai dukej se ndjente prej pjesëmarrjes në veprimtari .

Përfundime

Vlerësimet për muzikën si terapi bëhen përherë dhe më tepër pretencioze duke qenë se arti muzikor ofron mundësi të mëtejshme të dëgjimit në mënyrë dinamike, ku individ mundet të dëgjojë dhe të vëzhgohet në një mjedis ndërveprues. Gjatë procesit në terapinë e muzikës, i interesuari nuk merr edukim muzikor, por nxitet të luajë një instrument perkusiv dhe të përdorë "zërin" e tij.

Tek fëmijët me vështirësi në të nxënë, edukimi muzikor shërben si një proces njohës dhe zhvillues njëkohësisht, pasi kështu përftojnë njohuri muzikore dhe në të njëjtën kohë përmirësojnë aftësitë si, përqendrimi, koordinimi, vëmendja dhe kujtesa. I njohur është fakti se individët me vështirësi speciale në të nxënë nëpërmjet edukimit muzikor rrisin kohën e përqendrimit që ua kushtojnë disa

aktiviteteve, si dhe përmirësojnë rritjen e vetbesimit.

Dy prej vështirësive kryesore me të cilat ndeshen disleksikët është saktësia e luajtjes së tingujve, dhe tempi i saktë që i referohet vonesës së përpunimit të informacionit nga ngadalësia e të mësuarit. Më poshtë po listojmë disa nga të dhënat për vështirësitë që hasin disleksikët gjatë mësimit të muzikës dhe si munden ti përballojnë ato.

Problemet e ndjesisë së kohës, të ritmit dhe sekuencave në muzikë mund të krahasohen me vështirësitë që disa disleksikë kanë në identifikimin dhe përfaqësimin e njëjësive gjuhësore.

Një nga shkaqet që disleksikët ndiejnë problem në të mësuarin e repertorit muzikor përmes partiturave është vështirësia që përballen me zberthimin e simboleve vizuale (semiografia muzikore) në këndimin apo dëgjimin e tingujve. Dallimin dhe identifikimin e potencës tingëllore timbrin dhe lartësinë e tingullit. (Beaumont,1992:13)

Gjithashtu vështirësia është e dukshme në njohjen e modeleve dhe motiveve ritmike, për sa i përket motiveve në partiturë, intervalet dhe motivet në tastet e pianos, sa i përket aftësisë vizuale. Ndërsa gjatë lojës në piano ndihet vështirësi në koordinimin e duarve për drejtimet e majtë e djathtë, por edhe lëvizja e gishtave është e ngadaltë për shkak të koordinimit, të të parit, të prekurit të dëgjuarit.

Sipas të dhënave nga literatura e lëvruar aftësitë e shpejta të koordinimit dhe ritmit janë aspekte me vështirësi të veçantë për fëmijët disleksikë, ndërsa lartësia tingullore nuk paraqitet problematike. Mësimet e muzikës ndihmojnë në reduktimin e vështirësive të koordinimit, sinkroznizimit dhe zhvillimit të aftësive perceptuese, të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin aftësive njohëse dhe gjuhësore.

Një gjetje me rëndësi në këtë vërtetim ishte dhe ndërlidhja e aftësisë për të mbajtur të qendrueshëm ritmin e një kënge, aftësi kjo që mbështetet në dhënat vokale, dhe shqipitmit të rrokjeve.

Prej kërkimit sugjerohen aktivitete muzikore të mbështetura tek këngët, lojrat

ritmike, që përmbajnë një ndërmjetës të çmuar që nxënësi disleksik zhvillon aftësitë e koordinimit dhe ato gjuhësore.

Për rritjen e aftësive gjuhësore mbështetet fakti se përdorimi i tingujve me fjalë të muzikuara mund të drejtojë në përmirësimin e perceptimit verbal. (Tallall, 1996) Në pedagogjinë muzikore, nismëtar dhe frymëzues të qasjeve shumëdimensionale që u shfaqën në fund të shekullit XIX- fillim i shek XX, ishin *Emile Dalcroze*² (1865 – 1950) *Zoltan Kodaly*³ (1882-1967). Metoda Dalcroze përshkohet nga (Eurithmia) ku trupi ushtrohet që të shprehë me lëvizje, frazën muzikore që ekziston në mendim.

Metoda *Dalcroze* është e natyrës lëvizore-dëgjimore dhe rezultatet prezantojnë përmirësim të kujtesës zanore dhe aftësive gjuhësore të personave me aftësi ndryshe, metodat Dalcroze dhe Sommer mund të ndihmojnë individët me dispraksi. Në studimet e Huewitz, Wolff, *Bortnick*, dhe *Kokas* (1975:167) në artikullin e tyre treguan se metoda Kodaly mund të përdoret njëkohësisht si metodë e mësimit të muzikës dhe si mjet terapeutik për fëmijë me vështirësi në të nxënë.

Një tjetër metodë që bazohet ekskluzivisht tek aftësia e këndimit të individit, bazohet tek këndimi në grup dhe ka shumë ndikime prej metodës *Kodaly*, është "*Growing with music stocks*" e *Stock* dhe *Maddocks*". Secili mësim përbëhet nga një apo më shumë këngë, të shkruara në partiturë që këndohen në klasë sipas ritmit, tingullit dhe formës. Dallimi thelbësor me *Kodaly-n* është se mësimdhënia bazohet në përdorimin e zërit përmes këngës edhe gjatë dëgjimit, ndërsa *Kodaly* përdor njohje të simboleve muzikore, shenjat muzikore për parqitjen e tingujve. Në metodën *Stocks and Maddocks*" semiografia muzikore jepet pas dëgjimit dhe mësimit të këngëve ndërsa *Kodaly* i ezauron gjatë procesit mësimor, ku së pari mësohen vlerat ritmike si u përmend më sipër.

Krahas këndimit, lojrave ritmike edhe të mësuarit e një instrumenti muzikor ndikon pozitivisht në ndjeshmërinë e trurit ndaj

² Pianist , kompozitor, pedagog Zviceran themelues i metodës pedagogjike Dalcroze method Eurithmic

³ Pedagog, Kompozitor hungarez, themelues i metodës Kodaly

ngacmimeve tingullore, me rezultat direkt në aftësitë njohëse të fëmijës duke nxitur zhvillimin e trurit dhe përmirësimin e kujtesës

Gjatë procesit të mësimin të instrumentit mendohet se nxënësi kupton përdorimin e çelsit *Sol* (dora e djathtë) dhe çelsine *Fa-së* dora e majtë dhe paralelisht shkathtësohet në leximin e njëkohshëm të të dy çelsave gjatë ekzekutimit. Në Piano nxënësi i sheh tastet ku secili tast i përket një tingulli. Për nxënësit me vështirësi në të nxënë sugjerohet metoda (*Color Staff*) (me ngjyra) (Hubicki) dhe *Color Muse* (Maxwell-Steer). M.Hubicki⁴ (1915-2006) vizatoi objekte në pentagram dhe në tastierën e pianos me qëllim që të zëvendësonte notat, pasi individët me disleksi marrin lehtësisht njohuritë muzikore në imazhe. (Hubicki&Miles 1991:74-75) Përdorimi i larmishmërisë së ngjyrave dhe simboleve muzikore *color staff*, i lejon përdoruesve të sistemit të përgjigjen vizualisht, me lëvizje dhe me dëgjim.

Rekomandime

Në rastet kur nxënësit kanë vështirësi në të nxënë, sugjerohet që pjesët muzikore të mësohen me anën e dëgjimit, mësuesi luan pjesën dhe nxënësi e përsërit apo e ka të inçizuar për dëgjim.

Me anën e përsëritjes dhe dëgjimit nxënësi do të mësojë më shpejt dhe do ta ruajë në kujtesë më gjatë.

Për nxënësit me mungesë përqendrimi do të jetë më mire që të shmangin aktivitetet në kohë të gjatë. Sugjerohet *5 minuta* si hapësirë kohore. Nëse vërehet përmirësim në rritjen e përqendrimit koha e aktivitetit shtohet me 3 minuta, duke rritur gradualisht kohën e veprimtarisë, dhe pavarësisht llojit të vështirësisë në të nxënë sugjerohet që mësuesi të ekzekutojë së pari pjesën muzikore, dhe më

pas ta studiojë nxënësi. Në vijim nëse nxënësi shfaq pëlqim, atëher ai mund të studiojë si fillim aq sa mundet.

Në rastin që nxënësi ka përmirësuar dukshëm kohën e përqendrimit është e mundur të rritet koha e studimit apo të zgjerohet repertori. Për përzgjedhjen e materialit për provime, sugjerohet që të marrin bashkë vendime mësues dhe nxënës, që të njihet mësimdhënia me në qendër nxënësin, duke marrë parasysh nevojat dhe preferencat e nxënësit.

E mësuara me tingujve bëhet produktive kur realizohet përmes partiturave të ngjyrosura. Secili tingëllim i përket një ngjyre, përsëmbull, nota *Mi* nën ngjyrën roz, e kështu me rradhë për simbolet muzikore.

Shembull. Aplikim praktik raste konkrete nga përvoja me studentët

Kënga "Ylli i vogël lart në Qie" me ndihmë vizuale dhe me ngjyra për në tastierën e pianos.



⁴ Margaret Olive Hubicki, pianiste dhe kompozitore themeloi metodën Color Staff për të ndihmuar njerëzit me disleksi të lexojnë muzikë duke përdorur ngjyra. "Karakteristika e kësaj metode është se mundëson që notëzimi muzikor të mësohet në një mënyrë shumëshqisore

Referenca

1. Austin, J. (1962) *How to do things with words*. Oxford: Oxford University Press
2. (Beaumont, C. (1992) "Teaching Music to Dislexic Children" *Music and Dislexia , Cambridge Conference Proceedings, Cambridge University Press, Cambriddge*.
3. Hubicki, M & Miles Tim,R., (1980) "Musical Notation and Multisensory Learning" in *Child language teaching and therapy , vol 7.pp 61-78*
4. Hulme ,Charles, (1981) *The effects of a Dylexia-centered Teaching Progrmme" in British Journal of Educational Psychology, vol 50, pp.236-242*
5. Hurwitz I.,Wolff P., Bortnick B. &Kokas K, (1975), "Non- musical Effects of the Kodaly Music Curriculum in Primary Grade Children ", *Journal of Learning disabilities , vo.8, no.3.*

GJUHËSI-ALBANOLOGJI

Konkordancat leksikore në romanin "Pse" të Sterjo Spasses

Dr. Evis Hudhëra

evishudhera@univlora.edu.al

Abstrakt

Të studiosh konkordancat leksikore në një vepër letrare është një ndërmarrje e vështirë, por edhe e bukur pasi gjithçka që ne vëzhgojmë imtësisht del e domosdoshme për studime të mëtejshme në gjuhën shqipe. Në këtë punim është marrë në shqyrtim dhe analizë gjuha e Sterjo Spasses në romanin e tejkohshëm të tij të titulluar "Pse?!".

Në punimin tonë bëme *objekt studimi* leksikon, veçoritë semantike e strukturore të tij të romani "Pse" i Sterio Spasses. Objekti i temës është i lidhur me programin e konkordancave kompjuterike për të na paraqitur një listë fjalësh të përdorura në roman.

Në këtë mënyrë punimi ynë do të ketë *qëllim* pasurinë e leksikut të romani "Pse", duke parë aftësinë e autorit për të përzgjedhur mjetet gjuhësore, aftësitë fjalëkrijuese, të cilat i japin vullë origjinale krijimtarisë së tij dhe pasurimit të gjuhës letrare shqipe. *Qëllimi i këtij punimi* del si rrjedhojë e konkordancave leksikore për të studiuar në mënyrë të detajuar gjuhën e Sterio Spasses si dhe frekuencat e fjalëve të zgjedhura prej tij. Kjo na nxjerr në stilin e tij i cili është i veçantë.

Artikulli më tej ndalet në vlerësimin e analizave gjuhësore të korpusit të dalë prej programit të konkordancave.

Fjalët kyçe: *pasuria leksikore, neologjizma, konkordanca leksikore, lista e lemave, frekuencat e fjalëve, etj.*

Abstract

Studying lexical concordances in a literary work is a difficult but also beautiful undertaking as everything we observe in detail turns out to be necessary for further studies in the Albanian language. In this paper, the language of Sterjo Spasses in his later novel entitled "Why?!" is examined and analyzed.

In our work we studied the lexicon, its semantic and structural features in the novel "Why" by Sterio Spasses. The object of the topic is related to the computer concordance program to present us with a list of words used in the novel.

In this way, our work will aim at the richness of the lexicon of the novel "Why", seeing the author's ability to select language tools, word-creation skills, which give the original stamp to his creativity and enrichment of the Albanian literary language. The purpose of this paper emerges as a result of lexical concordances to study in detail the language of Sterio Spasses as well as the frequencies of the words chosen by him. This brings us to his style which is special.

The article further dwells on the evaluation of corpus linguistic analyzes resulting from the concordance program.

Keywords: *lexical richness, neologisms, lexical concordance, list of lemmas, word frequencies, etc.*

Hyrje

Sipas mendimit të Heidegerit (Heidegger) që "Gjuha është tepër e rëndësishme për t'ua lënë vetëm gjuhëtarëve" na bëri të kemi objektin e studimit tonë leksikon në prozë të Sterjo Spasses. Secili shkrimtar ka individualitetin e vet. Ky individualitet semantik i referohet ngarkesave emocionale dhe tematike të fjalëve të caktuara, në këtë mënyrë ato marrin një vlerë specifike. Autori i kushton formës rëndësi të veçantë. Ai kalon nga gjuha e përditshmërisë drejt një gjuhe me vlerë të lartë semantike. Pasuria dhe larmia e leksikut është një tregues i drejtpërdrejtë i pasurisë dhe i zhvillimit të gjuhës.

Materialet: Fillimisht nisëm të grumbullojmë materialet e nevojshme, të cilat na ndihmuan në realizimin cilësor të punimit. Kështu, puna filloi me mbledhjen e studimeve të gjuhës së veprave letrare të autorëve të ndryshëm, si: Shefkie Islamaj me studimin për gjuhën e Fishtës apo të Jakov Xoxes, etj.. Janë të shumta materialet e shfletuara, por në qendër të vëmendjes së materialeve studimore është vepra "Gjuha e Jakov Xoxës" e Shefkie Islamajt. Gjatë studimit të secilit autor morëm mendime në lidhje me punimin tonë. Mbi të gjitha, bërthama mbi të cilën e bazuam studimin është vetë romani i S. Spasses "Pse". Kompjuteri dhe programi i Konkordancave zuri vendin më të rëndësishëm në punimin tonë.

Metodat: *Metoda e hulumtimit dhe e skedimit të leksikut* janë metodat kryesore të përdorura në punim. U shfletua gjithë literatura e nevojshme, u përcaktuan çështjet që janë trajtuar, lexuam imtësisht romanin dhe skedua leksikon e përdorur në të.

Metoda kompjuterike e Konkordancave (SCP) si: metoda kompjuterike e skedimit me 2007, PAET (Programi Analitik Elektronik i Tekstit). Teknika e parë na ndihmon për të përkufizuar secilën fjalë, numrin e fjalëve të përdorura dhe na ndihmon që të mos përsërisim të njëjtën fjalë më shumë se njëherë. Nga kjo analizë do të

nxjerrim sa fjalë janë të mëvetësishme dhe sa herë janë përdorur.

Metoda e hulumtimit me atë të analizës, të përshkrimit dhe të vlerësimit janë metodat që përdorëm në nxjerrjen e Fjalorthit të romanit "Pse".

Metoda kryesore e punimit tonë është *metoda analitike*, e cila na ndihmoi që të paraqesim hap pas hapi tiparet gjuhësore, tiparet e paradigmës së leksikut të figurshëm, të fjalëkrijimeve, etj. Sipas skedave të hartuara në kompjuter është bërë renditja e çdo fjale. Për secilën fjalë jepen shënimet gramatikore më të domosdoshme. Gjatë dokumentimit të skedave për veprën në prozë kombinuam metodën e tipave leksikogramatikorë, veçoritë strukturore-semantike e gramatikore, ashtu edhe të pjesëve të ligjëratës së cilës i përket fjala.

Dy fjalë për autorin dhe romanin "Pse"

Sterjo Spasse është një prej shkrimtarëve që ka lënë gjurmë në letërsinë shqiptare dhe më konkretisht në atë të viteve '30, periudhë në të cilën ai shkruajti dhe botoi edhe veprën e cila e ka bërë më të shquar emrin e tij, romanin "Pse?!". Studioi në "Normalen" e Elbasanit dhe ndërkohë nisi punë si redaktor në revistën pedagogjike "Normalisti" dhe botoi tregimet e tij të para në gazetën "Shqipëria e re", "Zëri i Korçës", "Monografia", "Prespa e Vogël" etj. Në 1935 Sterjo Spasse e botoi romanin "Pse?!", ku spikasin disa prej cilësive dhe stilit të tij si autor në këtë zhanër letrar. I sjellë në trajtën e një ditari, në formë shënimesh a rrëfimesh të një personi, në qendër të veprës është vendosur figura e një djali të ri 22 vjeçar, Gjon Zaveri; i ndodhur mes një lufte pyetjesh pa përgjigje, dy mendësive, dy botëve, një mentaliteti të ashpër ekzistues dhe një tjetri që po përpiqej t'i jepte ngjyra jete Shqipërisë së viteve '30.

Programi i Konkordancave na erdhi në ndihmë për të paraqitur gjuhën dhe fjalorin e autorit të romanit të përzgjedhur. Në roman kemi 1992 – rreshta, 557666 – fjalë të përdorura (përfshirë këtu lemat e secilës fjalë), 7593 – fjalë

emërtuese. Nga programi i Konkordancave ne nxorrëm:

1. Frekuencat e fjalëve

Fjalët me frekuencën më të lartë të përdorimit janë:

Lidhëzat si:

edhe – 425 herë; *dhe* – 863 herë; *por* – 510 herë; *që* – 735 herë; *kurse* – 110 herë

Parafjalët:

me – 1203 herë; *pa* – 254 herë; *për* – 247 herë; *më* – 987 herë; *të* – 3320 herë

Përemrat:

ajo – 327; *ai* – 114; *unë* – 321 herë

Foljet :

jam – 776; *kam* – 499; *them* – 150

Emrat :

femra – 129; *botë* – 105; *fjalë* – 125; *Pola* – 127; *zemër* – 141; *njeri* – 243;

2. Në roman na ranë në sy fjalët më të përdorura nga mënyra e fjalëformimit të cilat janë:

a. Fjalë me *prejardhje parashtesore* si mënyra e formimit të fjalëve të reja me anë të parashtesave **ndër-, ri-, stër- pa-** etj., si:

29 banorët e viseve kufitare e **ndërkufitare** të Jugut e të Veriut ... (**ndër-** + kufitare)

38 Buzë liqenit në të cilën **ringjallte** shëmbëlltyrat më të ... (**ri-** + ngjallte)

43 menduar më parë ose e kanë **stërholluar** (**stër-** + holluar)

52 e të vogla të dukura e **të padukura** - ka natyra mbarë aq pyetje... (të **pa-** + dukura)

280 pranë miqve që luanin duke **nënqeshur** me vete: njëri prej tyre... (**nën-** + qeshur)

b. Fjalë me *prejardhje prapashtesore* si mënyra e formimit të fjalëve të reja me anë prapashtesash të tilla si **-tor, - ar, - xhi, - zë,** etj., p.sh:

32 moçalore dhe shushunjat **dhunëtore** qyqej si ajo kolibja... (**dhunë** + **-tor-e**)

43 përfaqësues i njëmendësisë së **hallexhinjve** dhe siç dihet Shqipëria... (**halle** + **-xhi**-njve)

47 një të vërtetë se përpara **një vërtetari** a radiografisti të botës... (**vërtet** + **-ar**-i)

51 mendime e mëpojnë këtë minutë **kokëzën** time. S' di se si: zemra... (**kokë** + **-zë**-n)

1094 as të ngurtë por as edhe **flurore** megjithatë për një cast (**flur** + **-or-e**)

Shënim: Numrat anash janë numri i reshtit nga është shkëputur fjalia në roman sipas programit të konkordancave. Sterjo Spasse, "Pse"?! Tiranë 2010, fq.3, 8, 10, 12, 58 etj..

c. Fjalë me *prejardhja parashtesore* - një teme i ngjiten njëkohësisht një parashtesë dhe një prapashtesë dhe të dyja këto morfema luajnë rolin e një formati të vetëm, p.sh:

50 familjet e tyre bisedojnë **përmallshëm** ose ia heqin koqes së gjumit (**për** + **mall** + **shëm**)

446 Sot zonjës P. i bënë edhe një **përshpirtje** të veçantë. I ndanë... (**për + shpirt + je**)

ç. **Nyjëzimi** është mënyra më prodhimtare në gjuhën e sotme. Shumica dërrmuese e pjesoreve mund të shndërrohen në këtë rrugë në mbiemra të nyjshëm, p.sh:

32 të damkosur./ **Të damkosurit** e Shqipërisë! Në Veri (**të + damkosur -it**)

44 e fshatarëve të varfër e **të nëpërkëmbur** të cilët dalëngadalë (**të + nëpërkëmbur**)

44 Realizëm socialist shprehje e **huazuar** nga metoda letrare sovjetike (**e + huazuar**)

d. **Kompozimi** është një mënyrë fjalëformimi me anë të së cilës krijohen fjalë të reja që kanë në përbërjen e tyre dy a më shumë tema motivuese; njëra nga këto tema mbështetëse, që është zakonisht e dyta) e formëson gramatiksht gjithë kompozitën, ndërsa tema tjetër (ose temat e tjera, kur janë më shumë se një) është e asnjësuar nga pikëpamja e kuptimeve të saj gramatikore, p.sh:

31 të varfër: një familje **gojëshumë** që mbi krye i binte pika... (**gojë + shumë**)

32 kënetash edhe pse ropatej **gojëkyçur** dikush i shkolluar i... (**gojë + kyçur**)

32 e nëmur në shpirt dhe **gjaktharë** në zemër nga shushunjat... (**gjak + tharë**)

39 është aspak e rastit që në **vargromanet** historike... (**varg + romanet**)

179 tepër tru më tepër mend se sa **veshgjati** prej atij filozofi ... (**vesh + gjati**)

e. **Përngjitja** është një mënyrë fjalëformimi, me anë të së cilës formohen fjalë të reja nga njëfjalëzimi i një togfjalëshi, i një togu parafjalor ose i një grupi fjalësh në përgjithësi. Lidhjet sintaksore ndërmjet gjymtyrëve të togfjalëshit a të togut ruhen zakonisht të qarta edhe në strukturën e fjalës së re të përngjitur, p.sh:

845 për të bërë nga një shëtitje **krahpërkrah** të dy bashkë. Të gjitha... (**krah + për + krah**)

f. **Konversioni** është mënyra e formimit të një të një fjale të re si pasojë e kalimit në një pjesë tjetër të ligjëratë për shkak të kushteve sintaksore të përdorimit të saj. Duke kaluar nga një pjesë tjetër të ligjëratës, fjala e formuar me këtë mënyrë ndërron edhe paradigmen e saj. Për këtë arsye është quajtur edhe mënyrë morfologo-sintaksore. Si formant fjalëformues në konversion shërben paradigëm që fiton fjala e re e motivuar, ose humbja e paradigmes së vjetër dhe lidhjet e reja sintaksore të fjalës, p.sh:

86 shtrihet përtokë dhe me disa **ah-e** përpihet nga vdekja zhduket...(**ah** pasthirmë e emëruar)

Me këto mënyra fjalëformimi gjejmë përdorim të gjerë të fjalëve si: emra, mbiemra, folje, ndajfolje.

3. **Romani përmban edhe një shumësi fjalësh të cilat ne i kemi klasifikuar si shtresat leksikore sipas përdorimit. Aty janë përdorur mjaft huazime nga gjuhët e tjera si:**

Sipas profesor Xhevat Lloshit të "Stilistika dhe pragmatika e gjuhës shqipe" *Cilësimi i një fjale si huazim është një qëndrim etimologjik, domethënë tregohet prejardhja e fjalës. Për stilistikën kanë vlera shprehëse huazimet, për të cilat bëhet e dukshme që janë diçka e huaj kundrejt brumit të shqipes ose tekstit rrethues shqip. Rrjedhimisht, huazimi i veçuar kërkon përftesa të posaçme*

që ta tërheqë vëmendjen te ky vështrim nga prejardhja: ruhet trajta shkrimore, ndonjë veçori tingullore ose fonetike, jepen togje të tëra sintaksore, shoqërohet me fjalën përkatëse shqipe ose me shpjegime të tjera. Vend të veçantë në leksikon e veprës zënë huazimet orientale, për arsyen se ato kanë ardhur nga kontakti i drejtpërdrejtë me turqishten. Duhet se huazimet e tilla janë prezente më tepër në të folmet dialektore dhe krahinore, dhe turqizmat shfaqen bashkëngjitur fjalëve të personazheve nga fshati, ndërsa huazimet frënge apo latine vendosen në gojën e personazheve si profesori, apo edhe vetë Gjon Zaverit, por ka edhe huazime të cilat janë ngulur në shqipe dhe disave prej tyre nuk është gjetur ende një gjegjëse. Kshtu, huazime të tilla kemi, psh:

a. 27 dhe vura se pas një muaj plot **tamam** më 14 gusht të këtij viti... (turqizëm)

30 nuk mund ta quajme si një **trill** të tij por si një lajthim...(latine)

73 më tha:/ - Na plase me **sofisma** filozofike! / - Ja... (gr.vjetër)

93 më të mëdhenjtë: njerëz të **autosugjestionuar** . Një gravatë... (anglisht)

124 mbresë të madhe./ - **Mashalla mashalla** gocë paske or xha Naum... (turqizëm)

338 se jam rritur më tepër si një **harremkë** sulltani se sa një vashë... (turqizëm)

363 / - Është sëmure nga **meraku** . Duket se dashuron ndonjë... (turqizëm)

454 përsëri mik: E zbuloj me mend **çarçafin** e mykur që mbulon këtë... (turqizëm)

716 shihte të veshur aq bukur: me **borsalino** me rrobet ngjyrë qielli... (frëngjisht)

916 nuk kemi **as kanape** dhe as kulltuke si në qytet por mbajmë... (turqisht)

1090 desha të them - me djaj e me **xhinde** . Gjërat që dukeshin e që... (turqisht)

1093 tonë. S ' ke nevojë për **imitim** ! I zhytur je por eja të... (gr.vjetër)

b. *Autori përdor mjaft fjalë nga shtresa e vjetruar e leksikut të cilat janë arkaizma apo historizma si dhe fjalë dialektore të cilat janë pasuri gjuhësore duke u zbërthyer kuptimet brenda kontekstit në roman si:*

71 nuk duhet ta marrim në **gazep** ... për të përmendur aty për... (ta mundojmë)

77 - Atëhere të këshilloj që ta **lëçitësh** me vëmendje Dekameronin... (ta lexosh)

79 bukura dredhkat dyfaqesh dhe **pillimet** e tepërta s'më kanë lënë... (zbukurimet, rregullimet)

152 të shkoj në qytet por me **konditë** që të jem këtu për Krishtlindjet... (me kusht)

485 shoqërore ishte zhytur në **profkat** e qytetërimit të sipërfaqshëm... (fjalë të kota, të gënjeshtërt)

939 shtëpi më shtëpi me një **plloskë** me verë dhe me një strajcë ... (enë druri e rrumbullakët për të mbajtur ujë; trastë)

1021 dhe dhëmballat/Eshttrat dhe **kokallat!** / / Mbas drake... (kocka, eshtra)

Gjithashtu, veç dialektalizmave në vepër gjenden edhe disa historizma apo fjalë arkaike, të vjetra, të cilat nuk janë më presente në fjalorin e shqipes së sotme, por janë zgjedhur prej autorit për të specifikuar periudhën e ngjarjes së rrëfyer, për të karakterizuar një personzh a dukuri si në rastet e mëposhtme:

123 një vit edhe në Shën Jani (**7 kallnor**) kryqi i jepet me kremtime...

344 e ngrita dhe e vura në **kanape.** / - Si jeni zonjë...

388 Gjençit tani e kam në dorë. **Lëçis** drejtimin tim pastaj dhe...

687 Fol moj **hanko** ti me mua/ Pse më rri

1022 nuses i duhej të bënte **tahminanë** e trashëguar! / ...

1025 U trashëgoftit! ia hoqi **duvakun** nuses dhe ja më doli përpara...

4. Duke vëzhguar me imtësi fjalorthin e përdorur nga Spasse kemi realizuar një ndarje sipas fushave semantike e tematike të përdorimit të fjalëve, ku vend kryesor zë Onomastika në romanin "Pse".

a. Emra të përveçëm njerëzish si:

Petri, Profesori G . , Stojani, Polë, Aristofani, Niçja, Spiro Gjinit, Leni, Omar Khajan, Homer, Sokrat, Platon, Aristotel, Virgjil etj..

55 e dy vjeçar dhe më quajnë **Gjon Zaveri**. Por ...bëra gabim...

66 vizitë në shtëpinë time miku **Gjençi** me të cilin biseduam para...

115 edhe veprën e artistit frëng **Jean Einsain Lindorja**. Është një...

177 prandaj qëndro larg meje o **Afërditë** se unë nuk jam i dashuri...

223 dhe të hidhemi tek tjetra. **Bernard Shou** e thotë dhe ti me...

123 shkuan në gosti në shtëpinë e **Naum Gjiks**. Ishte **Shën Jani** dhe...

132 verës në dorë na qënka çuar **Xha Postoli** plaku më fisnik dhe

215 top futbollit e një **Brigitte Helm** me shokë e me shoqe edhe një...

b. Toponime

305 i kam provuar kaq vite në **Amerikë** dhe në **Evropë**. Po... pse...

396 shpejt dhe iku. E gjeta te **Bryli i liqenit** shtambat i kishte...

400 prapa: Kam për t'u hedhur nga **shkëmbinjtë e Kosornikut**. Ajo për...

481 more bre ëë'bëhet andej nga **Parisi**! Jeton bota me të vërtetë...

482 dolëm për shëtitje nëpër bulevardin e famshëm **Chans Elysee** ...

675 e **Malit të Thatë**. Ja dhe Beli i bukur kjo kodër siujdhese...

675 saj zgjatet si gardh vigan Pelisteri që lufton me **Galiçicën** ...

c. Profesione

224 ndryshoj./ Kështu foli **profesori**: ke të drejtë por mos...

484 edhe përpara pallatit të **kryetarit të Republikës** por sa...

569 dhe në fund aristokrat dhe **bankier** si tani edhe më së fundi...

684 ndonjë tjetri./ - E **xhambas** si na e ke mishin? A e...

691 pastaj në atë lëm të vogël! **Gajdexhinjtë** qëndronin në mes të...

Petri ishte **sekretar** privat i babait i cili është **tregtar** me zë në kryeqytet

d. Vegla muzikore

ishin tre burra; njëri kishte **gajdën - lahutën** e dashur që ma...

691 në foshnjëri! Tjetri kishte **gërnetën** ndërsa i treti i binte **trumbetës**

e. *Emra kafshësh*

179 zemërohet njeriu kur i thua **gomar, derr** ose ka dhe nuk zemërohet...

179 i tij i majme? A thua se **zog**u ka më tepër tru më tepër mend...

180 ti e shave atë dhe po i the **pullumb** ose **luan** do të thotë se...

559 **një gunë një strajcë** dhe pesë dele . **Delet** i shiti kurse të tjerat...

5. Frazheologjia gjuhësore në roman merr vlerat e saj dhe është mjaft e pasur kryesisht gjatë dialogëve. Sipas fushave në të cilat përdoren ato kanë lidhje me ligjërimit popullore. Në këto njësi kemi hasur më së tepërmi ku njëra prej gjymtyrëve kanë një prej pjesëve të trupti të njeriut, si koka, zemra, buza, etj..

a. *Njësi frazeologjike që lidhen me pjesët e trupit*

94 / Por Gjençit **nuk i mbushet koka** : do që të më bëjë... (vlerë foljore)

131 megjithatë ai **nuk e prishi gjakun** por iu përgjegj me gjakftohtësinë... (vlerë foljore)

163 edhe me këto shpreson **të marrëmbjë zemrën** . Por ja që unë... (vlerë foljore)

52 dhe si me ëmbëlsi **vë buzën në gaz** : shef në Tokën tonë një babiloni... (vlerë foljore)

53 s'ka gjë nëse dhëndërrri **qënka krunde nga mendja** : mjafton t'ia... (vlerë mbiemërore)

70 Botë. - Unë **nuk ia kam marrë hua ndonjërit kokën** por mendoj... (vlerë foljore)

b. *Njësi frazeologjike që lidhen me gjendjen shpirtërore e bashkëbisedimet*

180 se e lëvdove **e ngrite në qiell** ! E... për këto mbiemra njeriu... (vlerë foljore)

329 e pyeta./ - Ah Gjon **ma nxive jetën** ! Nuk më ngushëllon... (vlerë foljore)

268 me mua. Por eh **nuk të vjen rëndë** : Lere le të çoroditet nën... (vlerë vlerë ndajfoljore)

377 e Pashkëve **do t'u përgjigjem prerë** për fejesën./ Shëndeti... (vlerë ndajfoljore)

92 është i dehur... është bërë thumb !/ Pastaj kam parë... (vlerë mbiemërore)

c. *Njësi frazeologjike që lidhen me orëndi dhe ushqime shtëpie*

220 sjellshëm. Duket se **ka gjetur tenxherja kapakun** !/ Këtu... (vlerë foljore)

719 tani shoqja ime. E **ndava më shapin nga sheqeri** : caktova njerinë...(vlerë foljore)

1079 **kishte shkelur mbi dërrasën e kalbur** ! Pyeste por përgjigje... (vlerë foljore)

1078 sikur i **kishte rënë e tërë çatia mbi kokë** nga ajo që quhet... (vlerë mbiemërore)

137 të cilët gjatë vitit **e bëjnë dhallë mendjen** e nxënësit . Një... (vlerë ndajfoljore)

d. Njësi frazeologjike që lidhen me antikitetin (kryesisht të pamotivueshme)

711 u mërzhitur fare! - Veçëse...
kënga e Mukës për fejesën time... (vlerë mbiemërore)

32 **ditët e Perëndisë** duke bluar me mend vargjet e zjarrta... (vlerë foljore)

572 Ta mendojmë punën pak si e **ëma e Zeqos në majë të thanës** : Ç'është trashëgimi i karakterit... (vlerë ndajfoljore)

223 Oh mik **jeni zënë për mustaqet e Çelos** shumë herë... (vlerë ndajfoljore)

Diskutimet :

Punimi mund të studiohej edhe më thellë nga ana semantike. Problemet e cekura, por pa hyrë në analiza të hollësishme janë të shumta.

1. Nga programi i konkordancave ne hartuam një listë të gjerë fjalësh të cilat mund t'i paraqesim në formën e një fjalorthi. Fjalorthi mund të konspektohej në shtresa leksikore sipas përdorimit dialektizma, krahinorizma, shtresa e vjetruar e leksikut, huazime, etj.. Po japim një shembull të shkurtuar:

Bre - pasth. bised. Përdoret kur i drejtohem dikujt, kur thërresim dikë, me kuptimin «ore». Folni, bre shokë! Mos u nxitoni, bre burra!

Buçet - iste 1. Lëshon një zhurmë a krismë të fortë e të menjëhershme; ushton me një tingull të lartë e të fuqishëm, gjëmon. Buçet pushka (topi, bomba).

Çap - m. sh. Një e hapur e këmbës gjatë ecjes; hap; tingulli që del kur ecim duke shkelur me

këmbë. Çap i shkurtër (i gjatë). Me çapa të shpejtë (të mëdhenj).

Dallavere - f. kryes. sh. Veprim i pandershëm i një njeriu të keq, i cili përpiqet që me rrugë të padrejta e me mashtrime të marrë a të fitojë diçka që nuk i takon, të ngatërrojë të tjerët etj.; mashtrim. Bënte dallavere.

Darovit - kal.,vjet. I jap darovë dikujt (zakonisht nuses), i bëj një peshqesh. Daroviti nusen (dhëndrin).

Gazep- Mundim i madh vuajtje, fatkeqësi e madhe, gjëmë, mynxyrë; hall i madh.

Gdhij - kal. kalon natën pa gjumë derisa zbardh drita. E gdhui gjithë natën.

2. Nga Lista e fjalëve me anë të programit na dolën grupet paradigmatiche leksikore ku mund të thellohem te relacionet semantike të çifteve sinonimike apo antonimike kontekstuale si në këtë shembull:n **I guxullojnë - Shndrisin, Handakosej - Dërrmohet, vritet keq, Kacafyt - E kap dikë për gryke; /ledhaton / përçafet, etj..**

3. Te fjalëformimi mund të merreshim me ndajshesat më të përdorura të cilat janë parashtesat apo prapashtesat apo dhe mënyrat e tjera fjalëformuese që kanë ndikuar në krijimin e neologjizmave si: **të gjithëmonëshme, të rrënjëzuara, gjaktharë, dhunëtore, etj..**

4. Zgjerimi i kuptimit të leksemave të nxjerra prej listës së fjalëve dallohet shumë qartë brenda kontekstit ku ato fjalë kanë figuracione gjuhësore si epiteti, krahasimi, metafora, sinekdoka etj.: **djeg si saç, i kthjellët si qelq, si qiri të ndezur, të më dalin në tru, si harusha të qytetëruara, si ndonjë vrasës me zë, si sundues shekullor i natyrës, etj..**

Përfundimet:

1. Në romanin "Pse" të Sterjo Spasses nga analizat më sipër, themi se janë përdorur dendur fjalët me kompozita dhe sidomos

- ato me prejardhje prapashtesore. **Gojëshumë, gojëkycur, gjaktharë, vargromanet, të autosugjestionuar, vërtetari, kokëzën, flurore, harremkë** etj.. Vlen për t'u theksuar se autori ka fuqi krijuese të neologjizmave. Shembujt e mësipërm i kemi neologjizma.
2. Gjithashtu, ka një larmi të përdorimit të njësive frazeologjike me rreth 100 të tilla në të gjithë veprën, si: **ke derdhur trutë, ia kam marrë hua, del përsëri në shesh, mori erë**, etj..
 3. Romani "Pse" brenda vetes ka shtresa të shumëllojshme të leksikut si:
 - a. 34 huazime kryesisht turqizma dhe tek-tuk ndonjë term nga greqishtja e vjetër, latinishja dhe frëngjishtja si: **Mashalla, tamam, akoma, verem, sehir**, etj..
 - b. 30 toponime: **Malit të Thatë, Beli** i bukur kjo kodër, gardh vigan **Pelisteri, Galiçicën**, etj..
 - c. 197 dialektalizma (duke përfshirë dhe ato fjalë me dallime fonetike dhe morfologjike) si **kanape, Lëçis, hanko** etj.,
 - d. 75 emra të përveçëm, si: **Jean Einsain, Afërditë, Xha Postoli, Leni**, etj..
 - e. 45 krahasime dhe similituda, si **margaritarë të çmuar, tundem si kallam, si dy shpella, shkëmbi si zog**, etj..
 - f. 46 epitete, **dashuri përcëlluese, lëmenj të argjendë, ferrë e katranosur**
 - g. 56 data dhe fjalë që shënojnë kohë pasi romani në vetvete është në formatin e një ditari dhe ja datat; **15 Tetor 193...**, etj..
 - h. 27 numërorë. **22 vite, 100 franga, një mijë napolonë**, etj..
 4. Onomatopetë e përdorura në roman sillen në trajtën e kompozitive me vizë në mes si: **osh-beshet, tak -tuk, Villas-llus, shtrak - shtruk**, etj..
 5. Njësitë frazeologjike janë përdorur me:
 - a. strukturë fjalie psh.; **Sikur i kishte rënë e tërë çatia mbi kokë, si e ëma e Zeqos në majë të thanës, ku ha pula strall**, etj..
 - b. strukturë togfjalëshi psh.; **nuk e prishi gjakun, ma theu zemrën, nuk i vjen erë**, etj..
 6. Duke shqyrtuar disa prej aspekteve fonetike, morfologjike, stilistike, dhe dialektore të leksikut të Sterjo Spases, dukshëm vihet re se autori është një lëvrues mjaft i mirë i shqipes, e njeh mirë strukturën e ndërtimit të fjalive, edhe pse shpesh herë duket sikur nuk do të rrezikojëme periudha të gjata.
 7. I shkruar në vitet '30, kuptohet që romani ka më tepër si bazë të saj shqipen jostandarde, megjithatë duke patur parasysh edhe zhvillimet historiko-shoqërore të asaj kohe që ndikuan mbi shqipen, duket se shkrimtari është një nga prijësit që e orientuan gjuhën drejt një niveli më të lartë lëvrimi.
- Literatura:**
1. *Akademia e shkencave e Shqipërisë (2002) , "Gramatika e gjuhës shqipe I, II", Tiranë.*
 2. *Çepani, A. & Çerpja, A. (2017) "Hyrje në gjuhësinë kompjuterike", Tiranë.*
 3. *Thomai, J. (2010), FFGJSH, EDFA, Tiranë.*
 4. *Shkurtaç, Gj. (2016), "Dialektet e shqipes", Tiranë.*

5. Thomai, J. (2005), *"Leksikologjia e gjuhës shqipe"*, Tiranë.
6. Çeliku, M. (2012), *"Sintaksë e gjuhës shqipe"*, Tiranë.
7. Memushaj, R. (2015), *"Fonetika e shqipes standarde"*, Tiranë.
8. Sterjo Spasses, *"Pse?!"*, Tiranë, Toena, 2010.
9. Lloshi, Xh. (2005), *"Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika"*, Tiranë.
10. Shkurtaç, Gj. (2009), *"Pesha e fjalës shqipe"*, Tiranë.
11. Memisha, V. (2011), *"Studime për fjalën shqipe"*, Botart, Tiranë.
12.
https://it.wikipedia.org/wiki/Martin_Heidegger
13. Islamaj, Sh., Gjergj Fishta, *Gjuha dhe stili, I, II*, Prishtine, 2012.
14. Islamaj, Sh., *Gjuha e Jakov Xoxes, Veçori leksiko -semantike dhe stilistike*, Prishtine, 2000.
15. Dibra, K., Bulka, N., *Gjuhesi e tekstit*, Tirane, 2005.

Vëzhgimi shkencor i profesor Ethem Likaj për mbiemrat te "Morfologjia e shqipes standarde"

Dr. Evis Hudhëra

evis.hudhera@univlora.edu.al

Abstrakt

Gjuha shqipe, si çdo gjuhë tjetër, është në proces të përhershëm ndryshimi, por gjithmonë priret të ruajë për një kohë të gjatë më thelbësoren e strukturës së saj. Dukuritë gjuhësore të çdo fushe nuk duhet të zënë vend relativisht lehtë në përbërjen normative të gjuhës, sepse ato nuk duhen parë vetëm si gjendje gjuhësore të arritura, por edhe si pjesë të një organizmi në zhvillim.....-shpreh në "MORFOLOGJIA E SHQIPES STANDARDE DHE ZHVILLIME TË REJA " Prof. dr. Ethem Likaj .

Ky punim është një vëzhgim krahasues mbi klasën leksiko - gramatikore të mbiemrave te "Gramatika e gjuhës shqipe 1", 2002, botim i Akademisë së Shkencave, te "Morfologjia e shqipes standarde" e prof. Ethem Likaj dhe Maklena Çabej, Tiranë, 2010, si dhe "Gramatikë e gjuhës shqipe", Kostaq Cipo, Tiranë, 2015 në një vështrim sinkronik. "Gramatikë e gjuhës shqipe" është ribotim ku janë përmbledhur në një vepër të vetme dy vëllime "Gramatika shqipe" (1949) dhe " Sintaksa" (1952) të gramatologut elbasanas Kostaq Cipo. "Gramatika e gjuhës shqipe 1" është ribotim i Akademisë së Shkencave në vitin 2002, por me këtë Gramatikë është punuar para viteve 1990. Kurse Morfologjia e profesor Ethem Likaj është botim për herë të parë në vitin 2010. *Objekti i punimit* tonë është vëzhgimi shkencor i

mbiemrave ndër vite nga gjuhëtarët, koncepti i tyre për këtë klasë leksiko –gramatikore.

Qëllimi i punimit është përmbushja e një konceptimi shkencor të drejtë ose më të thjeshtë për t'u përthithur nga studentët e niveleve të ndryshme. Pra kemi vëzhgim krahasues ndërmjet Gramatikës së Akademisë dhe dy gramatikave alternative, ku duhet të nxjerrim përfundimet se bota shkencore e njëjës prej tyre është më lehtë e perceptueshme.

Fjalët kyçe: *gramatikë alternative, Gramatika e Akademisë, mbiemrat, vëzhgim krahasues, koncepte normative, etj..*

Abstract

The Albanian language, like any other language, is in a constant process of change, but always tends to retain for a long time the most essential of its structure. Linguistic phenomena of any field should not take place relatively easily in the normative composition of language, because they should not be seen only as achieved linguistic states, but also as part of a developing organism... .. states in "MORPHOLOGY OF STANDARD ALBANIA AND NEW DEVELOPMENTS "Prof. dr. Ethem Likaj.

This paper is a comparative observation on the lexical-grammatical class of adjectives in "Grammar of the Albanian language 1", 2002, publication of the Academy of Sciences, in "Morphology of standard Albanian" by prof. Ethem Likaj and Maklena Çabej, Tirana, 2010, as well as "Grammar of the Albanian language", Kostaq Cipo, Tirana, 2015 in a synchronous view. "Grammar of the Albanian language" is a reprint where two volumes "Albanian Grammar" (1949) and "Syntax" (1952) by Elbasan grammarologist Kostaq Cipo are summarized in a single work. "Grammar of the Albanian language 1" is a reprint of the Academy of Sciences in 2002, but with this Grammar was worked before the 1990s. And Morphology by Professor Ethem Likaj is a publication for the first time in 2010.

The object of our work is the scientific observation of adjectives over the years by linguists, their concept for this lexical-grammatical class.

The aim of the paper is to fulfill a fair or simple scientific conception to be absorbed by students of different levels. So we have a comparative observation between the Academy Grammar and two alternative grammars, where we have to conclude that the scientific world of one of them is more easily perceptible.

Keywords: *alternative grammar, Academy Grammar, adjectives, comparative observation, normative concepts, etc..*

Hyrje

Materialet kryesore të përdorura për hartimin e artikullit janë: "Gramatika e gjuhës shqipe 1", 2002, botim i Akademisë së Shkencave, "Morfologjia e shqipes standarde" e prof. Ethem Likaj dhe Maklena Çabej, Tiranë, 2010, si dhe "Gramatikë e gjuhës shqipe", Kostaq Cipo, Tiranë, 2015 vështrim sinkronik. "Gramatikë e gjuhës shqipe" është ribotim ku janë përmbledhur në një vepër të vetme dy vëllime "Gramatika shqipe" (1949) dhe "Sintaksa" (1952) të gjuhëtarit Kostaq Cipo.

Metodat e përdorura në punimin tonë janë: *metoda krahasuese*, pasi ne kemi krahasuar tri gramatikat pra dy gramatika alternative të hartuara nga gjuhëtarë si Kostaq Cipo e Ethem Likaj dhe Gramatika e Akademisë e hartuara nga grup gjuhëtarësh. *Metodat e vëzhgimit të imtësishëm, analizës dhe e studimit të rastit* gërshetohen së bashku kur ne jemi duke analizuar mbiemrin e përcaktuar të tria gramatikat, me një vëzhgim të imtësishëm na del te K. Cipo se ai sjell në shembujt e tij edhe mbiemra arkaikë apo sjell ndërtime jo plotësisht shqip. *Metodat deduktive dhe ajo induktive*, ku nga ato koncepte shkencore që i kemi të theksuara në gramatika, ne dalim në disa përcaktime konkrete gjuhësore.

Në punim kemi hulumtuar kreun që trajton konceptin mbi mbiemrat, i cili sillet në rreth 14 faqe të "Morfologjia e shqipes standarde" e prof. Ethem Likaj dhe Maklena Çabej. Mendimi mbi klasën e mbiemrave trajtohet ashtu si vjen në tekstin e botuar nga Gramatika e Gjuhës Shqipe 1, botim i Akademisë së Shkencave në të cilin prof. E. Likaj është bashkautor. Në botimin e Akademisë kjo kategori leksiko-grammatikore sillet në 48 faqe. Kurse të "Gramatikë e gjuhës shqipe", të Kostaq Cipo kjo trajtesë studiohet në 32 faqe. Po sjellim strukturën e trajtesës së kapitullit të mbiemrit të tria studimet shkencore morfologjike. E realizojmë studimin tonë me qëllim nxjerrjen në dritë të trajtimit shkencor të njërës nga klasat leksiko-grammatikore të gjuhës shqipe nga studiues të ndryshëm në vite të ndryshme. Edhe pse duket sikur duhet të jetë studim në diakroni, ne jemi përqendruar mbi studimin teorik në tri morfologjitë, duke e vëzhguar brenda vetes ashtu si i kemi të shfaqura e për të realizuar tek-tuk ndonjë koncept të ndryshëm nga tjetri sepse si e shpreh dhe profesor Kostaq Cipo "Gramatika shqipe studion elementet e gjuhës dhe lidhjet që kanë ato midis tyre. Gramatika shqipe parashikon përshkrimin e të gjitha rrafshëve të sistemit gramatikor e sipas koncepteve gramatologjike...." Synimi i punimit arrihet nëpërmjet analizës krahasuese dhe metodave deduktive dhe induktive duke na përforcuar mendimin shkencor mbi mbiemrat dhe veçoritë

e tyre si nga profesor Ethem Likaj mendimi i të cilit është thelbësori për studimin tonë dhe gramatologu Kostaq Cipo.

- A. Dallimi kryesor midis Gramatikës së K. Cipos dhe Gramatika¹ e "Morfolojia e shqipes standarde" Et`hem Likaj dhe Maklena Cabej qëndron te titulli i emërtimit të kreut ku të K.Cipo ai e quan Adjektivi (Mbiemri), ndërsa te dy gramatikat e kemi thjesht Mbiemri. Madje te Cipo kemi edhe një trajtesë tjetër për mbiemrin në kreun "Vërejtje rreth pjesëve të ligjëratës" ku trajtohen çështje si Mbiemrat e substantivuar, Vërejtje rreth shkallëve të mbiemrit, Akordi i mbiemrit, Një vërejtje për mospërdorimin e mbiemrit pronor. Pra bie në sy titulli i disa çështjeve të shkruara nga terminologjia ndërkombëtare.

Vazhdojmë në brendësi të kreut mbiemri apo Adjektivi:

1. a. Përkufizimi i mbiemrave te Gramatika e Akademisë dhe e Likajt ; - **Mbiemri është pjesë e ndryshueshme e ligjëratës që emërton tipar të sendit. Mbiemri ka kategorinë gramatikore të shkallës, si dhe kategoritë gramatikore të gjinisë, të numrit dhe të rasës, të cilat varen nga ato të emrit.**
- b. Përkufizimi te Gramatika e Cipos jepet i thjeshtë: **është fjalë që bën këtë punë, shqipton cilësinë e emrit ose thotë veçoritë e tij**

2. a. Te gramatika e Likajt dhe e Akademisë jepet kuptimi kategorial i përgjithshëm mbi mbiemrin **si tipar i kuptuar si cilësi , veti a marrëdhënie dalluese.** Jepen shembuj si: Një malësor i ri, tepër i nxehtë.....

b. Te Cipo mbiemrin e sheh dy farësh si cilësonjës dhe përcaktues duke sjellë shembuj poezish nga autorë si Naim Frashëri.

3. Te gramatikat e Akademisë dhe Likajt Klasifikimi i mbiemrave sipas a) **formimit**

të prejardhur = me parashtesa (i **panjohur**), me paranyjëzim (i **hapur**), me prapashtesa (**bimor**), konversion (**trim**)

kompozita (të përbërë)= bashkërenditëse (**tekniko-shkencor**), nënrenditëse (**zemërgur**)

të përziara (i përbashkët)

b) **kuptimit leksikor** të cilët i ndan në:

-**Mbiemra cilësorë** që tregojnë tiparin në mënyrë të drejtpërdrejtë, p.sh.: luginë **e gjelbër**

Mbiemrat cilësorë emërtojnë: cilësi (**nxënës i sjellshëm**), madhësi (mal **i lartë**), veti fizike ose shpirtërore (sportist **shtatlartë**).

-**Mbiemra marrëdhëniorë** , të cilët tiparin e emërtojnë jo drejtpërdrejt, por nëpërmjet marrëdhënieve me një send (**i ujshëm**), rrethanë (**i djeshëm**) apo numër (**i tretë**).

sikurse na jep **edhe 4 veçoritë morfologjike** të dallimit midis tyre.

-Nga ana e prejardhjes të pammë, të prejardhur e kompozita **i madh, i padrejtë, zemërbutë** janë mbiemrat cilësorë

-Kategorinë e shkallës që e kanë vetëm mbiemrat cilësorë,

- Emrat abstraktë që formohen me sufikset **-i, -(ë)si, -(ë)ri**: bukuri, gjatësi, madhëri

-Çiftet antonimike i formojnë vetëm mbiemrat cilësorë **i mirë/ i keq**

c) **kriterit strukturor i ndan** në: Mbiemra të nyjshëm të paraprirë nga një nyjë (**i gjatë**) Mbiemra të panyjshëm (**rinor**)

Cipo i studion në një metodë krejtësisht tjetër edhe pse thelbi shkencor i klasifikimit të mbiemrave mbetet po ai. Ai na i sjell në formën e pyetjeve Ku vallë e ka vendin mbiemri cilësues? (**me të bukurën gjuhën tonë**) duke i quajtur mbiemra me kuptim të fytuar; Si i shquajmë mbiemrat cilësues? (**i nderçëm**); nga

formohet gjinia femërore e mbiemrave? (**i nderëm - e nderçme**); Si e bëjnë gjininë femërore kompozitat që përdoren si mbiemra? (**leshkuq - leshkuqe**)

Pra po të shohim dallimet midis Gramatikës së Akademisë dhe asaj të akademik Likaj janë thjesht strukturore, ndërsa te Cipo shembujt janë nga gjuha popullore e vjetëruar si dhe konceptet shkencore shprehen në forma më të thjeshtuara.

B Kategoritë gramatikore të mbiemrit te Gramatika e profesor Ethem Likaj paraqiten para studentit në këtë formë a) Gjinia: Gjinia femërore e mashkullore. Jep raste dhe të gjinisë asnjansë e cila ndeshet shumë rrallë me disa emra foljorë asnjansë, si: *Të folur të shpejtë*. Mbiemrat e nyjshëm të cilët e shprehin gjininë jo vetëm më anë të ndryshimit të nyjës së përparme por edhe me flektivë.

b) **Numri: Numri njëjës dhe shumës si kundërvënje dyshe te mbiemrat e panyjshëm të gjinisë mashkullore dhe ata të nyjshëm të gjinisë femërore.**

c) **Rasa:** Rasa ku në fq 60 thekson se mbiemrat e panyjshëm kur vendosen pas emrave nuk e kanë kategorinë e rasës. Madje sjell raste të rasave dhe ndryshimet morfologjike që ndodhin te mbiemrat gjatë lakimit të tyre.

Thekson që paradigma rasore e mbiemrave të nyjshëm ndryshon edhe kur ndërmjet mbiemrit dhe emrit ndërfiten elemente të reja gramatikore. E njëjta rasë del me dy forma rasore (nyjore) të cilat i përgjigjen së njëjtës sintagmë (emër+ mbiemër), por herë sintagmës emër + mbiemër të pandërprerë nga elemente gjuhësore, herë sintagmës së ndërprerë nga elemente të tjera gjuhësore:

K lisin e gjatë (lidhje e drejtpërdrejtë emër + mbiemër) me nyjën e përparme e

E- K lisin më të gjatë (lidhje emër + mbiemër e ndërprerë nga elementi më) me nyjën të

E lisat e gjatë (lidhje e drejtpërdrejtë emër + mbiemër) me nyjën e përparme e

E-K lisat më të gjatë (lidhje e ndërprerë nga më) me nyjën e përparme të

a) **Shkalla** që kategorizon mbiemrin dhe ndajfoljen. Shkalla shprehet vetëm me rrugë analitike.

-**Shkalla pohore** që vetëm sa e emërton tiparin e sendit përkatës. Qyteti ishte *i vogël*....

-**Shkalla krahasore** emërton cilësi të krahasuara dhe shprehet me pjesëz ose me ndajfolje. Cilësia e emërtuar nga mbiemri mund të jetë në shkallën krahasore të barazisë ose të pabarazisë. me 4 nënshkallët e saj si dhe skemat formale për secilën nga nënshkallët :

Shkalla krahasore e barazisë= Sa + Forma pohore e mbiemrit+ aq/kaq ose dhe anasjelltas vendi i ndajfoljeve: **Sa** i sjellshëm dukej **aq** i ashpër bëhej ose **kaq** zbavitëse **sa** brengosëse.

shkalla krahasore e pabarazisë ndahet në:= **më pak + F. Poh+ se/ sa/nga:**

-**shkallë krahasore të ultësisë= më pak+ forma pohore e mbiemrit+ se/ sa/ nga**

-**shkallë krahasore të sipërisë= a)më+ mbiemër në formën pohore + se/sa/ sesa** (kur shprehen tëdy gjymtyrët e krahasimit) **më të ashpër se të parët** b) **më + forma pohore e mbiemrit** (kur nuk shprehet gjymtyra e dytë) **më të vështirë.**

Shkalla sipërore emërton cilësi në shkallë shumë të lartë **shumë e vogël** si dhe skemën formale

-**Ndajfolje sasive + forma pohore e mbiemrit (fort të ashpër)**

- **Emër me funksion pjesëzor (pjesëz gramatikore) + forma pohore e mbiemrit (Korb të zeza)**

Këto struktura janë mjaft praktike për nxënësit, studentët por edhe për ata që duan të mësojnë shumë mirë gjuhën shqipe.

Ndërkohë te Cipo kemi një strukturë të konceptuar me anë të pyetjeve sipas fjalëformimit në kategoritë gramatikore të numrit, gjinisë. Pra, nënçështjet e trajtuara janë:

Si i shquajmë mbiemrat cilësues? Nga formohet gjinia femërore e mbiemrave? Si e bëjnë gjininë femërore kompozitat që përdoren si mbiemra? Si i shquajmë mbiemrat femërorë? Si e bëjnë shumësin mbiemrat mashkullorë? Si e bëjnë shumësin kompozitat? Si e bëjnë shumësin mbiemrat asnjans?

Dhe këto nënçështje trajtohen thjesht si kthim i përgjigjeve të pyetjeve respektive duke i shembulluar nga leksiku i folklorit shqiptar.

Duke vëzhguar trajtimet shkencore të këtyre dy gramatikeve alternative vëmë re se Gramatika e profesor Ethem Likaj përmban trajtesa të shpjeguara me metoda shkencore bashkëkohore duke qenë shumë më pranë Gramatikës së Akademisë së Shkencave, ku akademiku është edhe bashkautor.

Struktura e *Gramatikës së gjuhës shqipe 1*, ASHSH, Tiranë, 2002.

“Gramatika e Gjuhës Shqipe 1” botim i Akademisë së Shkencave sjell një trajtim të tillë para duarve tona të kategorisë leksiko - gramatikore të mbiemrit.

A Njohuri të përgjithshme, ku bëhet dhe përkufizimi pothuaj i njëjtë si te “Morfologjia e Shqipes standarde” e prof. Et`hemit për klasën e mbiemrit.

B Klasifikimi i mbiemrave sipas kriterit

1 Semantik

a) Mbiemra cilësorë emërtojnë cilësi që kapen me shqisa, janë të përfytyrueshme ose të mendueshme (i verdhë, i ngushtë, i thatë, i verbër etj)

b) Mbiemra marrëdhëniorë japin tiparin nëpërmjet një marrëdhënieje të sendit me një tjetër (shall i leshtë, trup qiellor, student i parë)

5 veçoritë morfologjike të mbiemrave marrëdhëniorë dhe cilësorë

1) Mbiemrat cilësorë edhe të parmë (i mirë)

2) Prej tyre formohen emra abstrakt (bukuri)

3) Formojnë çifte antonimike (i ëmbël/ i hidhur)

4) Njohin emërzimin kontekstual dhe të qëndrueshëm

5) I kanë të gjitha shkallët.

Mbiemrat marrëdhëniorë kanë të kundërtën e veçorive morfologjike të mbiemrave cilësorë.

2 Morfologjik

a) Të nyjshëm

b) Të panyjshëm mbiemra të formuar me konversion nga emra gjegjës

C Kategoritë gramatikore fillojnë të gjitha me njohuri të përgjithshme

D Emërzimi i mbiemrave

Te K. Cipo kjo trajtesë vjen e titulluar **Substantivimi i mbiemrave** dhe me shembuj tipik si: *me të djathtë, jo me të mëngjërën*, ku mbiemrat të djathtë të mëngjër janë të substantivuar. Lakimi i mbiemrave jepet në tabela. Kjo është metodë e cila mund të jetë lehtësisht e asimilueshme nga studentët sepse i mëson sipas një rendi tabelor.

Përfundime

Pra si përfundim e veçanta e kapitullit mbi mbiemrat te libri i akademikut E.Likaj qëndron:

- 1) Duket përgatitja shkencore dhe akademike e profesorit.
- 2) Duket aftësia metodike që e çon informacionin shkencor nga niveli

- akademik në atë universitar, madje edhe te mësuesi apo nxënësi
- 3) Edhe pse në pamje të parë do të krijohej përshtypja se do të kishim një kapitull të mbiemrave në miniaturë, përjashtuar me atë të Akademisë së Shkencave kapitulli për mbiemrin është trajtim shkencor, saktësi, thukësi, lakonizëm, informacion. Vetëm në 14 faqe saktë shkencërisht dhe qartë metodikisht merr informacionin bazë për mbiemrin.
 - 4) Ligjërimi shkencor, gjuha, sintaksa e përdorur, gjithçka që vjen në faqet e këtij kapitulli tregojnë dorën e akademikut që është marrë gjithë jetën me shkencën dhe gjuhën shipe.
 - 5) Metodikisht kapitulli është ndërtuar me sy dhe me gjuhë telegrafike (nuk komenton), por duke dhënë informacionin e plotë psh te mbiemrat sipas formimit nuk sjell ndarjen në shkallën e parë Mbiemra të parmë, mbiemra të prejardhur. Ose të trajtohet Emërzimi i mbiemrave. Pjesa e informacionit është e ndërtuar në mënyrë të atillë që jo vetëm tregon shkallë formimi të përdoruesit të librit por që lehtësisht mund ta çojë në kapituj të tjerë ku sqarohen koncepte e korpuse teorike.
 - 6) Edhe pse formati i librit nuk lejon përdorimin e shembujve të shumtë, në "Morfologjia e Shqipërisë standarde" të Prof. Ethem Likaj, ata janë zgjedhur me kujdes, që i përkasin ligjërimin të folur apo të shkruar, që janë funksional jo vetëm në informacion, jo vetëm në ilustrim, por që shërbejnë si konstrukte modelore për krijimin e shembujve nga studentët.
 - 7) Libri me informacionin që të jep hap dritare për një kërkim të mëtejshëm të informacionit shkencor. Studentin e çon te teksti i Akademisë, apo te botimet e tjera për morfologjinë e Gjuhës shqipe psh. **i hapur, i vdekur** etj. janë mbiemra prejppesore që në kuptimin e parë dalin mbiemra marrëdhënore por në zgjerimet kuptimore të tyre ata fitojnë një semantikë të re dhe kthehen nga mbiemra marrëdhënore në mbiemra cilësorë.

- 8) Së fundi pa diskutim që "Gramatika e Gjuhës Shqipe" trajton koncepte në imtësi, por edhe libri i "Morfologjisë së Shqipërisë standarde" sjell nivelin shkencor të informacionit që ka të bëjë me përcaktimet, tipologji klasifikuese në rrafshin semantik, strukturor e funksional në mënyrë atributive. Rëndësi kanë shembujt funksional që lidhen me nivelin e studentëve dhe rezatojnë pjesë të kulturës sonë kombëtare që i takojnë hapësirave gjeografike shqipfolëse dhe historike.

Literatura:

1. E. Likaj, M. Çabej, (2010), *Morfologji e shqipërisë standarde*, Tiranë, botimet Julvin, f.55 - 69.
2. K. Cipo, *Gramatikë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2015, botimet Pegi, f. 105-120 dhe 256 - 262.
3. *Gramatika e gjuhës shqipe I, II*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 2002.
4. F. Agalliu, *Numërorët e paranyjzuar, vlera dhe përdorimi i tyre*, SF, 1976, 4.
5. Dhrimo, A. (1972), *Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe*, SF, 1972.
6. Dhrimo, A. (1970), *Kategoritë gramatikore të mbiemrave*, SF, 3.
7. Memisha, V., *Dukuri semantike gjate formimit te mbiemrave prejppesore ..*, Gjirokaster, 1999.
8. Kostallari, A., *Kompozitat ekzocentrike te shqipërisë si teme fjaleformuese, ne « Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjaleve ne gjuhen shqipe », I, Tirane, 1972.*

Arritje shkencore për aftësinë krijuese të bashkësisë gjuhësore të Malësisë së Madhe

"Fjalori leksiko-frazeologjik i Malësisë së Madhe" i prof. Gjovalin.Shkurtaç
Akademik Emeritus

Prof. dr. Nexhip Mërkuri

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, Shqipëri
Nexhip.merkuri@univlora.edu.al

Abstrakt

Hulumtimi i aftësisë krijuese të bashkësisë me këndvështrimin si dialektolog e, si etnolinguist, e cila zë vend si pasuri jashtëzakonshme edhe etnonimike dhe nënndarje të tjera të onomastikës i rrit argumentet për gjuhën e moçme shqipe tek 1060 faqet. Studion tek llojet e komunikimeve për kultivimin të gjerë të pasurisë për prirje këtë krijim të bashkësisë së Malësisë së Madhe.

Ka shkruar për kërkimin shkencor në disa nënzona, të cilat i japin mundësinë të argumentojë në debatet për kërkime të tjera. Artikujt e shkruar në revista shkencore apo monografia e botuar për përzgjedhjen e kompleksit tingullor nga bashkësia e Malësisë së Madhe (Fjalori) japin pasqyrë të plotë për faktorët jashtëgjuhësorë, rrethanat shoqërore, si: *realiteti politik, struktura klasore, imigracioni dhe ndryshimet e përgjithshme të popullsisë*, të cilat shfaqen tek ndryshimet gjuhësore ndërmjet brezave. Është model për studiuesin e ri për kërkime të mësojë apo të fitojë se kjo bashkësi krijuese e moçme si e ka formësuar kompleksin tingullor për të realizuar përgjithësimin dhe dhënien e semantikës me tiparet më të genësishme edhe për onomastikën. Mundëson të shihen si afria e gati njëjtësia fonetike e morfologjike e të folmeve të Malësisë së Madhe,

për ti ndjekur në tri boshtet e krahasimit, që na zbulojnë përputhjet e tyre shumë të mëdha, po edhe dallimet e tyre. Modelëson së cituari me shumë kujdes mjedisin ku janë kultivuar dhe emërtuar aftësitë krijuese të bashkësisë gjuhësore, *Malësisë së Madhe dhe më e gjerë*, si shpjegime, ilustrime dhe burime të tjera për çdo studiues të gjuhësisë krahasuese.

Fjalë kyç: *aftësitë krijuese, bashkësisë gjuhësore, etnolinguist, Malësisë së Madhe, dialektolog.*

The research of the creative ability of the community from the point of view as a dialectologist and as an ethnolinguist, which occupies a place as extraordinary and ethnonymic wealth and other subdivisions of onomastics increases the arguments for the ancient Albanian language to 1060 pages. Study the types of communications for the widespread cultivation of wealth for the tendency this creation of the community of Malësia e Madhe. Has written about research in several sub-areas, which give him the opportunity to argue in debates about other research. Articles written in scientific journals or published monograph on the selection of the sound complex by the community of Malësia e Madhe (Glossary) give a complete picture of extralinguistic factors, social circumstances, such as: political reality, class structure, immigration

and general population changes, which appear in linguistic differences between generations. It is a model for the young research researcher to learn or gain how this ancient creative community has shaped the sound complex to realize the generalization and impart of semantics with the most essential features for onomastics as well. It enables them to be seen as the closeness and almost the phonetic and morphological similarity of the dialects of Malësia e Madhe, to follow them in the three axes of comparison, which reveal to us

their very great correspondences, but also their differences. It models very carefully quoting the environment where the creative abilities of the linguistic community, Malësia e Madhe and beyond have been cultivated and named, as explanations, illustrations and other sources for every researcher of comparative linguistics.

Keywords: *creative skills, language community, ethnolinguist, Malësia e Madhe, dialectologist*

Hyrje

Ndihet modest, pjesëtar si krijues i bashkësisë që sjell në Fjalor dhe përdorues i veçantë gjatë komunikimit në auditorë si profesor, në tavolina pune, në botime të ndryshme të pasurisë gjuhësore të pasqyruar tek "*Fjalori e Malësisë së Madhe*" si libër dhe në mënyrë elektronike.

Metodologji dhe rezultate

50 vjet, mbledh studion i provon tek llojet e komunikimeve për kultivimin të gjerë të pasurisë që qarkullon për prirje, këtë krijim të bashkësisë së Malësisë së Madhe dhe më gjerë si hapësirë. Ka rrugë të shtruar me mermerin e fjalëve të Buzukut dhe autorëve të tjerë të mijëvjeçarit të tij apo edhe më të lashtë: "Si bir modest e i përvujtë i saj, ashtu si emnaku i nderuar i anëve tona, *Dom Gjoni i Bdek Buzukut*, që pat thënë se e shkroi librin e tij "*ën së dashunit botës sanë*", edhe unë, në krejt sa kam mbledhur, shkruar e botuar, para këtij Fjalori dhe në faqet e tij, kam shkuar sipas hullisë Buzukiane "*deshta me u fëdigun, për sa mujta me ditun...*" që e folmja, fjalët dhe urtësia e Malësisë sonë të Madhe të marrin shkëlzimin e njohjen që meritojnë, i bindur se shqipja jonë kaq e pasur, vazhdon të freskohet e pasurohet me burimet e pashtershme të dialekteve të saj"¹.

Vepër e gjerë me shumë degarritje të cilësuar nga profesori dhe pasuri për të gjithë

kombin. Tërësia e veprës pse jo mund të themi se ka realizuar fjalët e gjuhëtarit të madh, Ferdinand de Saussure "*Fjalët janë si monedha, vlera e tyre rritet vetëm nëse qarkullojnë.*"

Rruga me mermerfjalë i ka kushtuar profesorit vite. Artikujt e shkruar në revista shkencore apo monografia e botuar për përzgjedhjen e kompleksit tingullor nga bashkësia e Malësisë së Madhe japin pasqyrë të plotë për faktorët jashtëgjuhësorë, rrethanat shoqërore, si: *realiteti politik, struktura klasore, imigracioni dhe ndryshimet e përgjithshme të popullsisë*, të cilat shfaqen tek ndryshimet gjuhësore ndërmjet brezave. Herë - herë zbrit në disiplina të vështira si etimologjia për të shpjeguar karakterin krijues të kësaj bashkësie gjuhësore. Argumentohen ndryshimet e karakterit marrëveshjesor krahinor, kombëtar të formimit të kompleksit tingullor dhe semantik për objekte dhe dukuri në vite apo shekulle.

Ka shkruar për hulumtimin i gjatë në disa nënzona, të cilat i jap mundësinë të argumentojë në debatet për kërkime të reja në mjaft qendra të tjera e me shumë traditë në këtë fushë dhe për profesorë me mjaft përvojë. Është shkruar për karakterin krijues të radhitur në lista apo fjalorë të lashtë në disa dekada. Në këto krijime të bashkësive gjuhësore është shkruar për karakterin marrëveshjesor të emërimit për gjuhësinë romake, greke, arabe indiane etj. nga gjuhëtarë që kanë ndërtuar lëndën "Gjuhësi e përgjithshme" (Robins, *Historia e Gjuhësisë*; Kostallari, *Histori e gjuhësisë së përgjithshme*). Për fatin e keq për gjuhësinë ilire, fjalët iliro-arbëreshe nuk përmenden askund në antikitet. S'mund të përjashtohen ilirët-arbëreshët bashkësia e Malësisë së Madhe për dukurinë

¹ Shkurta, Gj. *Fjalori leksiko-frazeologjik i Malësisë së Madhe*. Tiranë, 2021, f.6.

universale të zhvillimit njerëzor, karakterin marrëveshësor të emërtimit, lidhjet e këtij kompleksi tingullor me fjalët e tjera të bashkësisë për të komunikuar sa më qartë.

Duke shkruar për rrugën mermerfjalë le të përmendim se Frang Bardhi në fund të Fjalorit të vitit 1635 e vë në dukje, se fjalët e shqipes i mbloodhi më tepër për ëndje, sesa për nevojë, domethënë gjuha amtare i tingëllonte e këndshme. Ndërsa P. Budi shqetësohej se shqipja po vdarej, domethënë besonte se kishte qenë e lulëzuar më parë. P. Bogdani synonte bukurinë e ligjëratës, që të mos i dilte e papëlqyeshme.

Me të drejtë profesori me përvojë mbi 50 vjeçare i cili ka kryer ekspedita në shumë pika studimi në të gjithë vendin, brenda dhe jashtë kufijve shtetërorë rimerr dhe vendos në tavolinën e secilit për të shtuar argumente. Bashkësia gjuhësore e pasqyruar në gjithë veprën e paraqitur me 1060 faqe, fjalë dhe onomastikë të krijuar në shekuj apo rishtas. Autori me këtë vepër e ka emërtuar *Fjalor*. Në hyrje shtron para studuesve dhe lexesit të thjeshtë: "Përveç kësaj, nga një vështrim kritik i ndryshimeve që ekzistojnë midis këtyre dialekteve, E. Çabej arrinte në përfundimin se këto tipare nuk kanë dalë të gjitha njëkohësisht, po një pas një e shkallë-shkallë, dhe se, *gjatë periodës letrare, më konservative tregohet toskërishtja, gjatë periodës paraletare gegërishtja*. Për pohimin e faktit se "*dy dialektet kryesore dikur kanë qenë më pak larg njëri-tjetrit se sot*", studiuesi ynë shihte aty si të thuash një prerje transversale: "*Brenda zonës dialektore të gegërishtes-në lidhje, nga sa duket, me një tendencë të spikatur për një diferencim dialektor më të madh- vërtetohen disa ndryshime fonetike, të cilat janë mjaft më të lashta, pjesërisht më të lashta se veçoritë që dallojnë gegërishten nga toskërishtja*"².

Ka mundësi që të vëzhgohet shqipja e moçme sipas profesorit: "Fjalë që dalin kudo në trevat shqiptare me të njëjtin kuptim, por me

*forma fonetike të ndryshme, që kanë rrjedhur nga e njëjta paraformë e shqipes së moçme. Këtu, në fakt, mund të përfshihen edhe të gjitha ato forma morfologjike dhe sintaksore, bashkë me mjetet fjalëformuese, që kanë përbërë dhe përbëjnë edhe sot pikat më kryesore të dallimit ndërmjet dy dialekteve të shqipes, si dhe të degëzimeve më të vogla brendapërbrenda tyre. Të tilla janë fjalët, që janë të prekura nga veprimi i dukurive fonetike tiparizuese, si grupet *nd>t /n/*: *e prëte/ e prëne; ênz (<endëz), rrât, -i/ rrând ("rrënd"), mb>p/b*: *piell/ miell (<mbjell)*; *fsh>psh* *kafshoj, kapshim, kapshatë; rrapsh, rrapshim, rrafshoj etj*"³.*

Shumë dekada në ekspedita, autor i tekstit "Dialektologjia" për studentët i kushton faqe zhvillimit dialektor, proceset që kanë ndodhur, rruga e ndjekur. Rimerr dhe i shton argumentet kolegut të tij të arritura 40 vjet më parë: "Në zhvillimin historik të gjuhës e të dialekteve të saj do vënë në peshë përveç kësaj dhe kjo rrethanë, që krahas me procesin divergues të zbërthimit gjithnjë e më të madh të madhësive më të mëdha në madhësi përherë e më të vogla (gjuhë-dialekt-ligjërim) ka vepruar edhe procesi i përkundërt, rruga e konvergimit dhe e mbështjelljes së njësisë më të vogla në grupe dialektore më të mëdha, lidhur edhe me shtegtimet e pareshtura të fiseve përbrenda vendit dhe me mbishtresimet e dialekteve. Me këto rrethana etnografike-gjuhësore jashtëzakonisht të ndërlikuara e që njihen vetëm pjesërisht pajton edhe kjo, që emrat Gegë e Toskë nuk dalin asgjekund në burimet historike. E me këtë pajton prapë ky fakt tjetër, që të dy këta emra në përhapjen e tyre të sotme mund të vërtetohen se kanë arritur me anën e zgjerimit të kuptimit të tyre të kryehershëm, kur ato ishin emërtime fiseshe më të vogla. Ky parim i shkoqjes e i zbërthimit e njëkohësisht edhe i afrimit e bashkimit, në Shqipëri vihet re si në organizimin fisnor të popullit ashtu edhe në strukturën dialektore të gjuhës."⁴

² Cituar sipas Gj.Shkurtajt shih: E. Çabej, *Disa faza më të moçme të shqipes në dritën e gjuhëve fqinje*, në "Studime rreth historisë së gjuhës shqipe", Tiranë, 1973, f. 19.

³ Shkurtajt, Gj. *Fjalori leksiko-frazeologjik i Malësisë së Madhe*. Tiranë, 2021, f.12.

⁴ Sjellë si argument nga Gj.Shkurtajt, E. Çabej, *Disa faza më të moçme të shqipes në dritën e gjuhëve fqinje*, në "Studime rreth historisë së gjuhës shqipe", Tiranë, 1973, f. 41-42.

Karakteri përzgjedhës nga bashkësia ka vijuar edhe më tej të cilat janë pasqyruar në vepra të hartuara më parë dhe vijon të krijojë. Shkruan ndër të tjera profesori se janë shumë krijime të bashkësisë gjuhësore që kanë kaluar kufirin si dialektizma semantike dhe kanë zënë vend në fjalorët e hartuar "Së mbrami, por jo për nga vlera e tyre, përmendim edhe disa *dialektizma semantike* apo, thënë ndryshe, fjalë të mbarë shqipes që në Malësi kanë edhe kuptime të ndryshme nga ato të njohurat e të gjithmbarshmet. Kështu, folja *njehi*, *-njeha-njeh(un)* përdoret me kuptimin numëroj: *a din me i njeh bagti:n? Njehi edhe j he:r, se bela nuk i ke njeh si duhet; jân gjithsej trillet e pës kutia me t' njiehun*.

Fjala *samar*, *-i*, përpos kuptimit si në mbarë shqipen, në të folmet e Malësisë ka edhe kuptimin gual a zhguall i kërmillit, i breshkës etj.: *samari i breshks; samari i gamillit "kërmillit"*.⁵

Vijon në hyrje të tërheq vëmendjen për lexuesin dhe studiuesin e ardhshëm: "Leksema të veçanta të Hotit dhe e të folmeve të tjera të Malësisë janë edhe termat bujqësore *shpatuk* "fik i çarë dhe i tharë në diell, çapell" dhe folja *shpatukoj* "bëj fiq të thatë shpatuk, i bëj fiqtë çapella"; *vojoj* "rit që kryhet nga famullitari në rastet kur dikush është në prag të vdekjes", prej nga edhe mbiemri: *vojuom*, *-e (i, e)*;⁶

Shkruan më tej profesori me shumë përvojë në ekspedita "*Pije edhe i met, he burr!*". Dhe m'u kujtua se edhe në Kastrat, qysh në femini, e kisha dëgjuar aq shpesh këtë fjalë, që do të thotë hurbë pije, *gllënjë*. Por nuk thuhet "*i met ujë*", për ujin malësorët thonë "i bulshi u:j", por thonë: "*i met raki, i met vë:n*".⁷

Kompleksin tingullor kjo bashkësi gjuhësore për të realizuar përgjithësimin dhe dhënien e semantikës me tiparet më të qenësishme e ka formësuar me prapashtesa siç shkruan autori: "Malësia e Madhe shquhet, gjithashtu, për një pasuri e fjalësh të prejardhura me prapashtesa, si: *-AK-AN-A:S(E) -AZA: U:j*

NE:SH: burrne:sh, trimne:sh, thine:sh "dosë" (<thi femër) etj.

-ACAK (E) Prapashtesë e dendur dhe në të folmet e Malësisë, me të cilën formohen emra dhe mbiemra cilësorë kryesisht me ngjyresa keqësuese, si: *burracac*, *-u (burrë)*, *frigacac*, *-e (frigë)*, *hilacac*, *-e (hile)*, *malacac*, *-e (mal)*, *morracac*, *-e (morr)*, *pordhacac*, *-e (pordhë)*, *verllacac*, *-e (i verdhë)* etj.

-AC(E) Prapashtesë e dendur dhe në të folmet e Malësisë, me të cilën formohen emra dhe mbiemra cilësorë kryesisht me ngjyresa keqësuese, si: *tollac/tullac*, *pordhac*, *-e/porllac*, *-e*; po edhe të tjerë, si *gjela:c*, *-i (gjel)*.

-A:Ç(E) Prapashtesë e dendur dhe në të folmet e Malësisë, me të cilën formohen emra dhe mbiemra cilësorë kryesisht me ngjyresa keqësuese, ironizuese ose përçmuese, si: *bytha:ç*, *goja:ç(e)*, *gûgaç*, *-e*, *hallaka:ç*, *-e*, *hila:ç*, *-e*, *gërverra:ç*, *-e*, *gzha:ç*, *-e*, *lebera:ç*, *-e*, *luvda:ç*, *-e*, *pikta:ç*, *-e*; *rrëna:ç*, *-e*, *skubula:ç*, *-a*, *tërtraka:ç*, *-e*, *tînza:ç*, *-e*⁸.

Të pakta janë parashtesat edhe për shqipen në tërësi, po edhe në fjalor vijnë pak të tilla duke paraqitur disa variante të parashtesave të kësaj bashkësie: "Nga fjalët e formuara me parashtesa, tipike malësore na duken edhe formimet me parashtesën *PICI-*, si *picig-jate* "e stërgjatur", *picig-jatoj* "stërgjas, zgjatoj shumë; *picigul /picingul* "kokëposhtë, kokëtatëpjetë". Po ashtu, tipike dhe të dendura në krejt Malësinë e Madhe janë edhe formimet me parashtesën *lara*, kryesisht mbiemra që tregojnë ngjyrën e larme si *laracik bore* "zog i larmë që afrohet në oborre gjatë dimrit dhe lajmëron se do të bjerë borë: *laramân*, *-e* "për lopë a qe të larmë"; prej kësaj fjale është formuar edhe eufemizmi metaforik *laramânlaci* "gjarpri i larmë, rrëshaja e larme". Në këtë grup formimesh po përfshijmë edhe ndajfoljen *laradash* "kokëposhtë, me kokë poshtë"⁹.

Fjalën si kompleks tingullor e radhit së bashku me togfjalësha të qëndrueshëm të cilët

⁵ Po aty f.20.

⁶ Po aty f.22.

⁷ Po aty f.20.

⁸ Po aty, f. 22.

⁹ Po aty, f.22.

shtojnë pasurinë e kësaj bashkësie: "Malësia e Madhe ka edhe shumë fjalë, togfjalësha të qëndrueshëm e frazeologjizma, të cilat nuk i gjejmë nëpër të folmet e tjera të shqipes, ose që dalin me kuptime të dallueshme prej tyre, si togfjalëshat me përsëritje (në thelb tautologjike) si: *syt e ballit, dhâ:pt e go:js, flo:kt e kre:s, mêt e kre:s, trût e kre:s, gishtat e do:rs, gishtat e kâ:ms.*"

Artikuj e hulumtime në vite, pyetësor për studiues të tjerë për të krahasuar dhe parë, cili nga kompleksit tingullorë ka shtrije më të gjerë. Botimi dhe organizimi i konferencave kanë shpalosur pasurinë dhe prirjen e fjalës nga krahina, në dialekt dhe deri tek porta hyrëse e Fjalorit: "Veçanërisht e pasur është fusha e emërtimeve të lidhura me gjënë e gjallë, sidomos emrat e bagëtive sipas ngjyrës e tipareve të tjera të dallueshme, të cilave edhe më parë, në studimet për të folmet e veçanta të Malësisë dhe në artikuj e kumtesa në raste të ndryshme, u kemi kushtuar disa artikuj e hulumtime më vete"¹⁰.

Aftësinë krijuese të bashkësisë gjuhësore të Malësisë së Madhe dhe më gjerë profesori e ka hulumtuar dhe e ka radhitur etnonimet, patronimet, antroponimet, i afrohet për të antroponimet dhënë aftësinë krijuese të shenjës gjuhësore gjithë onomastikës. Pra jo vetëm fjalën si kompleks tingullor me togfjalësha të qëndrueshëm të cilët shtojnë pasurinë e kësaj bashkësie, por më gjerë.

Lexuesi i zakonshëm, studiuesi e mëvonshëm mëson apo të fitojë se kjo bashkësi krijuese e moçme si e ka formësuar kompleksin tingullor për të realizuar përgjithësimin dhe dhënie e semantikës me tiparet më të qenësishme edhe për onomastikën. Shkruhen në hyrje arsyet pse profesori ka zgjedhur të radhitë edhe nga disiplina onomastikës si aftësi krijuese e bashkësisë:

"Na u duk e arsyeshme, prandaj, që në këtë Fjalor të Malësisë, krahas e në gji të fjalëve, kuptimeve dhe shprehjeve frazeologjike e mënyrave të të thënit urtuake e aq të bukura, të fusja edhe diçka

nga pasuria etnonimike dhe etnolinguistike e Malësisë, që shkon në boshtin e dyzimit të trajtave të emrave vetjakë në zyrtarë (emra të pagëzimit) dhe gojorë ose forma të dyta, ashtu si dalin në ligjërimin e zakonshëm, herë më prapashtesa zbnuese e nofka, herë më cungime e kalime jo lehtësisht të motivueshme, si dhe në formë riemërimesh a nofkash."¹¹ Le ta sjellim këtë pasuri, këtë aftësi krijuese për formësimin e emrave të familjes që dëshmon siç është shkruar edhe nga gjuhëtarë të tjerë që dëshmojnë për lashtësinë e shenjës gjuhësore: "*Patronimet e femrave me prapashtesën -ja*. Emrat dhe patronimet me tri gjymtyrë. dhe, madje, disa ishin edhe me katër pjesë, si: *Tom Ded Gjo Nishi, Mark Zef Ujk Vata, Zef Prêk Gjeta Çëka*. Më vonë, kur fillova të merresha me gjuhësi, do të shihja se këtë veçori të emrave vetjakë të shqipes, E. Çabej në studimet rreth historisë së gjuhës shqipe dhe të gramatikës historike të shqipes e përmendte këtë si një nga dukuritë e hershme origjinale të shqipes e që dëshmon hershmëri e lashtësi."¹²

Më tej paraqet një prirje, pas krahasimit të elementeve të onomastikës të Malësisë së Madhe, të shtrirë edhe në dialektin Toskë, në Toskërishten Veriore apo në folmet e Labërisë si nëndialekt të Toskërishtes për të nxitur më tej studimet krahasuese: "Disa krahina a qytete dallohen për denduri më të madhe të formave të dyta zbnuese të emrave vetjakë, si, p. sh., zona e Korçës, ku shquajnë sidomos format e sajara me prapashtesën *-kë*, apo qyteti i Shkodrës dhe përgjithësisht areali veriperëndimor, që ka me denduri zbnimet me prapashtesën *-ush (e)* dhe *-in*. Malësia e Madhe, mesa kam mundur ta ndjek, jo vetëm si i lindur në ato anë, po edhe si dialektolog e si etnolinguist, mund të pohoj se aty duhet të shihet si një hapësirë me pasuri të jashtëzakonshme edhe etnonimike. Malësia ka emra të hershëm e të bukur, ka larimi formimesh të trajtave të dyta (zbnuese) të emrave vetjakë, ka nofka aq të shumta, që, me kohë, i kanë shmangur plotësisht emrat e pagëzimit, sikundër ka edhe prurje të reja që duhen njohur e kundruar me kujdes."¹³

¹⁰ Po aty, f.23.

¹¹ Shkurtaç, Gj. *Fjalori leksiko-frazeologjik i Malësisë së Madhe*. Tiranë, 2021, f.26.

¹² Po aty, f.24.

¹³ Po at f.27.

Kjo dukuri gjuhësore e hulumtuar në nënzonat paraqet veçanti. Sidomos pasqyron atë politikë gjuhësore që përcaktoi Komisia Letrare e Shkodrës një shekull më parë. Kemi shkruar në librin "*Gjuhësi krahasuese*" se krahina e Cerjes, Përmet është e vetmja nënzonë, e cila nuk ka lagje me prapashtesën -aj, pra gjithë nënzona. Ashtu si nënzona e Cerjes edhe nënzona e Rrëzës, Shqerisë, Përmet nuk ka lagje me prapashtesën -aj e gjithë nënzona. Ato janë të ndërtuara me togfjalësh ose me prapashtesa të tjera. Kemi shkruar në studimet e realizuar se vihet re dukuria se tek 5 nënzonat e tjera të Përmetit, 60% fshatrave e kanë të ndërtuar me togfjalësh.

Prapashtesa -aj ka shtrirje në disa nënzona të tjera. 2-3 fshatra i kanë të ndërtuara emrat e lagjeve gati 100% me prapashtesën -aj¹⁴ Këtë dukuri e ka shkruar më herët profesori duke cituar edhe autorë të tjerë për studimet krahasuese: "Me interes e vlerë të madhe etnolinguistike janë në Malësinë e Madhe patronimet dhe etnonimet që formohen me prapashtesën -AJ. Etnikat e formuar me këtë prapashtesë, me të cilën formohen emra dhe mbiemra patronimikë, që malësorët, në dallim nga fise të tjera të Shqipërisë së Veriut, trungun familjar e vëllazëror e ka lidhur, jo me të parin fisnor, por me të parin e vëllazërisë. Në këtë mënyrë, sikundër kanë theksuar edhe sociologët, Malësia e ka faktorizuar përkatësinë vëllazërore, duke marrë madje edhe mbiemra patrominal (*Dedvukaj, Camaj, Dushaj* etj.), që nga koha e funksionalizimit të administratës shtetërore" (A. K. Berishaj).

Është prirje gjuhësore që del nga materialet e gjuhësisë krahasuese dhe është shumë e vlefshme porosia apo tërheqja e vëmendjes si sikundër ka edhe prurje të reja që duhen njohur e kundruar me kujdes. E parë si aftësi krijuese e formësimit nga bashkësia e Malësisë së Madhe ka zënë vend në faqet e fjalorit si dukuri shumë e rëndësishme për shumë areale të tjera: "Ne Fjalor, ndonëse nuk është një praktikë e zakonshme e veprave të tilla,

duke qenë kjo një dukuri shumë e rëndësishme e krahinës së Malësisë së Madhe, po edhe e ndonjë visi tjetër, sidomos në Labëri, u kemi bërë vend edhe emrave familjarë, ku shquajnë për sasinë e tyre të madhe ata që formohen me prapashtesën -aj."¹⁵

Duke bashkuar këndvështrimin si dialektolog e si etnolinguist, në faqet e Fjalorit zë vend një pasuri e jashtëzakonshme edhe etnonimike. Kemi zgjedhur 10 faqe si kampion nga Fjalori e kryesisht: f.100, f.200, f.300, f.400, f.500, f.600, f.700, f.800, f.900, f.999 për të parë konkretisht të dy këto zgjedhje të profesorit për të ndërtuar Fjalorin e madh për këtë bashkësi gjuhësore të moçme. Faqja 100 ka 12 fjalë, vetëm një është patronim kryesisht janë fjalë që lidhen me blegtorinë. Toponimi i radhitur ka ndërtim, shpjegim si Fjalori Enciklopedik. "*BARDHAJ/ BARLLAJ*. Fshat me popullsi shqiptare në pjesën e Malësisë, në komunën e Podgoricës (në Mal të Zi), që i përket Traboinit¹⁶. Shtrihet përgjatë kufirit shtetëror të Shqipërisë me Malin e Zi. Ka 47 banorë (2003) ndaj 114 banorë që ka pasur më 1948. Bardhaj është vendlindja e Heroit të Popullit, Ded Gjo Lulit. Për hir të investimeve të vetë banorëve, fshati ka rrugë të asfaltuara dhe ndërtesa të reja banimi. Popullsia merret kryesisht me blegtori dhe pjesërisht me bujqësi. Më shumë se gjysma e popullsisë së Bardhajt ka mërguar jashtë vendit, kryesisht në SHBA. Bardhaj ka shkollë fillore, njësi të shërbimit tregtar e komunal." (FESH, vëll. I, f. 180).

Faqja 200 e Fjalorit ka përbërje 6 formësime të bashkësisë nga fusha e onomastikës nga 20 fjalë që ka faqja duke shënuar në faqe me kujdes klasën e fjalëve edhe burimet: "*COLJA* Kur patronimi *Coli* vjen mbas një emri të gjinisë femërore (grua a vajzë) merr prapashtesën femërorizuese -ja: Liljana *Colja*, Baftë *Colja*; Pashk *Colja*. *COL/E, -JA m*. Emër femrash. *Cole Tolja*¹⁷ (Plavë e Guci).

Faqja 300 ka 8 fjalë. Vetëm tek fjala *DHÂM, -I / LLÂM, -I m. sh. -(T) Dhëmb, radhit 14*

¹⁴ Shih më gjerë, Mërkuri, N. *Gjuhësi e krahasuar*. Triptik, 2018, f.75.

¹⁵ Shkurtaç, G. *Fjalori leksiko-frazeologjik i Malësisë së Madhe*. Tiranë, 2021, f.30.

¹⁶ Po aty f.100.

¹⁷ Po aty f.200.

njësi frazeologjike. Po në këtë faqe ka mundur të shënojë edhe ku shtrirje: "E kemi regjistruar në Koplík e gjetiu në Rranxa të Mbishkodrës."¹⁸

Faqja 400 ka 14 fjalë, 4 janë fjalë etnonime. Për këto etnonime ka shënuar dhe mendimin e shprehur për të dhe burimin ose vendin e ekspeditës: "GJEL, -I m. Emër i moçëm në trevat shqiptare, i cili, sipas traditës së hershme të emrave të njerëzve, që vijnë edhe nga emra kafshësh e shpendësh, sipas E. Çabejit, ka dalë nga emri i gjelit. Emër meshkujsh dhe patronim në Malësi: *Gjel Çaku*¹⁹ (Hot)."

Faqja 500 ka radhitur 8 fjalë, 1 nofkë dhe tek fjala *kishë* ka radhitur njësitë frazeologjike dhe toponimet që kanë në emërtim fjalën *kishë* si fjalë të parë: *KI:SH(Ë)*, -A f. sh. -A(T) Kishë. Godinë kulturi e fesë së krishterë (katolike apo ortodokse), ku meshohet dhe besimtarët shkojnë për t'u lutur e për të kryer ceremonitë fetare të ndryshme; *shkoj n' ki:sh; dal prej kishet*. Në ndonjë nga të folmet e Malësisë, si në Reç etj. shqiptohet edhe *qi:sh*, -a, ashtu si në shqipen e autorëve të vjetër dhe të arbëreshët e Italisë, porse masivisht, në të folen e Malësisë, del *ki:sh*, -a. *Mos e gjuaj kishën pesh!* -Mos bëj mëkat, mos hyr në mëkat! *N'at ki:sh ç'i t'shkosh, at mshir merr*. -Në atë vend që të jetosh, do të mësohesh me zakonet e doket e tij. *T' nimoft kisha e mesha! ur*. Kur ndeshim në udhë dikë që po shkon në kishë, ose që po vjen nga kisha. *Si me pa viedh gjâ:n e ki:shs* i dobët nga shëndeti, shumë i hajthëm. *Pasha kishën shëjte!bet. Pasha kishn e Laçit! bet*. Fjala *kishë* del shpesh në toponimi, si pjesë e emërtimit të qendrave të famullive kryesore, si: *Kisha e Bajzs* (Kastrat), *Kisha e Shkrelit*, *Kisha e Zhajes* (Zagorë), *Kisha e Brigjes* (Hot), *Kisha e Reçit* (Reç), *Kisha e Çartun* (Uldedaj-Kastrat) etj. si dhe *Qafa e Ki:shs*²⁰ (Kastrat i Epërm).

Faqe 600 ka radhitur 12 fjalë titull dhe 3 antroponime, patronime. Për çdo fjalë titull ka renditur njësitë frazeologjike dhe fjalët e urta ku fjala titull merr kuptim të ri e hyn në marrëdhënie të tjera për ligjërimin e bashkësisë duke i shtuar semat e fjalës: "LLI; -JA/DHI; -JA f.

sh. -(T) Dhi. *Lli e bu:t. Lli e egër. I da:j dhi:t/ lli:t* (me dikë) shkëputem nga marrëdhëniet miqësore me dikë. *Nuk kam ma miqsi me tâ, i kem da: lli:t. Nuk din llija çka â tagjija. fj. u. iron.* Nuk e njeh jetën, nuk di se çfarë është e mirë, se është mësuar si dhia në mal. *N' mos kallzo:ft llija, kallzon brîni. fj. u. herët a vonë sekretit del në dritë, dikush do të rrëfejë. I shtjen mish llijet/dhijet* (dikush) shton gjëra të pamira, bën ngatërresa. *Mos na i shtjer mish llijet muhabetit. Mos thuaj gënjeshtër.*²¹ Këtë prirje do ta shtojnë bashkësitë e tjera gjatë përdorimit, për vlerat kurative që ka mishi i dhisë për individë të yndyrshëm me tepri.

Faqe 700 ka radhitur 9 fjalë duke radhitur dhe dy prapashtesa me ngjyresa zvogëlim që janë prodhues edhe për patronime dhe formime të tjera. Pas fjalëve titull shton disa fjalë më shpjegimet përkatëse që e zgjerojnë sasinë e fjalëve në një faqe kampion: "OBORR, -I m. sh. -E(T) Pjesa e mjedisit të një banese, para shtëpisë, zakonisht e rrethuar me mur ose me ledh, si dhe me një partare "derë". Në oborret e shtëpive të malësorëve ka pasur e dhe disa ndërtime a thurima ndihmëse, si: *koteci i kollomoqit, kaçorri i pulave, vathi dhe kësolla e dhenve apo e dhive, kjuori i qenit, kurse në kopshtin (që zakonisht ishte ngjitur me oborrin) kishte edhe mullarë tagjie dhe podina për t'i ushqyer bagëtitë në kushte dimri, kur bie borë e nuk mund të nxiren në kullotë. Oborri, edhe kur nuk ishte i rrethuar me mur, kishte rrethim me gardh ose me purteka dhe partaren apo derën e oborrit, që bëhej e gjerë sa për të hyrë edhe kafshët e barrës të ngarkuara, si dhe, në raste të shtëpive të mëdha, në zonat fushore, edhe sa për të hyrë qerrja. *Oborri i kullës* ka qenë një nga fjalët me përdorim të dendur edhe në *Eposin e Kreshnikëve. N' shtek t' oborrit* te dera e oborrit. *Sa ka hî ën shtek t' oborrit i ka da:l dikush përparan e ja ka vû: livoren ën gjyks.*"²²*

Përdorimi i pasthirmave kur je në distancë për bashkëbiseduesin është prijë edhe për bashkësinë gjuhësore në Jug, prirje mbarëkombëtare dhe lashtë dhe përdorur edhe në ligjërimet e Fishtës: "O! *pasth*. U prin emrave

¹⁸ Po aty f.300.

¹⁹ Po aty f.400.

²⁰ Po aty f.500.

²¹ Shkurtaç, G. *Fjalori leksiko-frazeologjik i Malësisë së Madhe*. Tiranë, 2021, f.600.

²² Po aty, f.700.

të përveçëm të njerëzve, kur u drejtohem për të shkuar në shtëpinë e tyre ose për t'u kumtuar ndonjë lajm nga një farë largësie: *O, Zef Shota! O, Marash Vata! O, i zoti i shpis! O, po a është kush aty, more?* "O vllau i ëm, o vlla!/T'zezat qyqe tash këndojnë, /O vllau i ëm, o vlla!/Nanë e motër u ndihmojnë, / O vllau i ëm, o vlla!"²³ (Fishta, LM).

Faqe 800 ka radhitur 10 fjalë duke radhitur llojet e rrushit që si fjalë të dytë të emërtimit kanë vendin e origjinës nga janë marrë: *Raguzë, Stamboll, Francë, Amerikan, Hot, Golem*; për të kultivuar më tej. Mjedisi ku janë kultivuar dhe emërtuar dhe burime të tjera për këto emërtime si Fjalori i Gazullit. Po tek shpjegimi etimologjik i shprehur nga E. Çabej duke shprehur dhe pohuar edhe pas 40 vjetësh se janë të saktë dhe të hulumtuara me kujdes: "RAGAZI mb. Një lloj rrushi i kuq me kokrra në formë vezake e me cipë të trashë. Besojmë se forma e parë do të ketë qenë *rrush Raguze*. Shumëkund këtë lloj rrushi e quajnë rr. *razaki*, për të cilën ka bërë shpjegimin etimologjik E. Çabej (St. Gj. II, f. 70-71). Në Malësi e në mjediset malësore të Bregut të Matës është dëshmuar edhe më herët forma *ragazi: ban rrush t'bardh'e ragazi* (Rrilë-Bregu i Matës), po edhe te Fjalori i Gazullit *rrush ragazi*, hardhi *ragazezë*. Prej *ragazi* u formua "per extensionem" edhe *ragabardhë* "rrush i bardhë këpujëmadh." (E. Çabej, po aty).

Përtej shtjellimeve të etimologut e mjeshtrit të madh, thjesht nga rrethana e ditur se shumë emra frutash e llojesh të rrushit emërtohen prej emrave të vendeve ku merren kultivarët e tyre (khs. *rrush Stomollet* (Stambolli) ose *Stomolle:sh; rrush Frâcet* (France), *rrush amerikân* për rrushin "çylek", apo *dardh Goleme* (nga Golem), *dardh Hote* (nga Hot) etj. besoj se te *ragazi, ragaze:z*, duhet të shohim si parësor togfjalëshin *rrush Raguzet*. Po ashtu për *ragabardh* të Malësisë, pa asnjë mëdyshje, mbetet i saktë shpjegimi i Çabejit si formim "per extensionem", natyrisht edhe me një trysni të etimologjisë popullore *ragaziragazezë>ragabardhë*²⁴."

²³ Po aty f.700.

²⁴ Shkurtaç, Gj. *Fjalori leksiko-frazeologjik i Malësisë së Madhe*. Tiranë, 2021, f.800.

Në faqen 900 ka radhitur 13 fjalë si pasuri gjuhësore që sjell kjo bashkësi gjuhësore për Fjalorin: "SHTRÛ:G(Ë) -A/ SHTRÛ:η(Ë), -A f. sh. -A(T) Shtegu i ngushtë afër derës së vathit a të oborrit ku milen delet; shtrungë. Ka edhe disa përhëndetje me këtë fjalë, kur kalojmë pranë ndonjë bariu me dhen a dhi, duke i mjelë në shtrungë: *Mi:r ën shtrû:g!* ose *Mir ën shtrû:g, a ka:n, marshallah! Mos i pa:t syni i keq!* SHTRÛGTAR, -I m. Bariu²⁵ që mjel dhentë në shtrungë." (Dol-Guci, Zymeri, *Leksiku...*, f. 151).

Faqe 999 ka radhitur po 14 fjalë gati 85% janë patronime, etnonime dhe toponime të zgjedhura me shumë kujdes si krijime të bashkësisë: "VUKPA:LAJ-PJETROVIQ. Fshat i Katundit të Kastratit, midis Hotit e Bratoshit. VUKSAN, -I Emër meshkujsh të besimit katolik: Vuksan Gela (Grudë); Vuksan Toma (Shënkoll i Bregut të Matës, me origjinë nga Shkrel), Vuksan Miri (Kelemend). Vuksa(n)lekaj/VUKSA(N)LEKAJ Fshat i Malësisë së Madhe me popullsi shqiptare në komunën e Podgoricës (Mal i Zi). Vendasit dhe përgjithësisht malësorët e shqiptojnë *Vuksalekaj*. Shtrihet në luginën e Cemit. Popullsia 280 banorë (2003) të besimit katolik, merren me bujqësi e blegtori. Ka shkollë fillore qysh nga viti 1945-46.


VULA Patronim i hershëm në Shkrel të Malësisë²⁶." Fran *Vula* (Poicë-Shkrel).

Faqet e zgjedhura si kampion vërtetojnë synimin e profesorit se në gji të fjalëve, fjalë titull, kuptimeve dhe shprehjeve frazeologjike e mënyrave të të thënit urtuake e aq të bukura, ka shënuar midis rreshtave në disa faqe pasurinë etnonimike dhe etnolinguistike të Malësisë së Madhe dhe më gjerë. Njësitë e onomastikës zënë afërsisht një të tretën e fjalëve të renditura në Fjalor. Pas fjalëve titull ka renditur gati 20% njësi frazeologjike, fjalë të urta, urime, mallkime, pra njësi që fjala titull hyn në marrëdhënie të tjera si pasuri për të komunikuar me bashkësitë e tjera gjuhësore, për ta pëlqyer këtë krijim dhe më tej si fjalë qendëruese. Njësi të onomastikës (antroponime, partonime, etnonime, toponime...)

²⁵ Po aty f.900.

²⁶ Po aty f.999.

midis rreshtave shënohen afërsisht 30%. Grafiku i mëposhtëm paraqet qëllimin e profesorit afërsisht për 10 faqet e zgjedhura.



Fjalori paraqet performancën e bashkësisë gjuhësore ku profesori ka realizuar ekspedita për disa dekada. Ka shkruar për hulumtimin i gjatë në disa nënzona, të cilat i jap mundësinë të argumentojë në debatet për kërkime të reja në mjaft qendra të tjera e me shumë traditë në këtë fushë dhe për profesorë me mjaft përvojë. Shton argumentet përtej shtjellimeve të etimologut e mjeshtrit të madh, E. Çabej pas 40 vjetëve jo vetëm si mirënjohje, por edhe si shkencëtar i gjuhësisë. Ka cituar me shumë kujdes mjedisin ku janë kultivuar dhe emërtuar aftësitë krijuese të bashkësisë si shpjegime dhe ilustrime dhe burime të tjera për këto emërtime si: Fjalori i Gazullit, Fishta, (LM). A. K. (Dol-Guci, Zymberi, *Leksiku...*, f. 151) etj.

Përfundime

Renditja e aftësisë krijuese të bashkësisë me këndvështrimin si dialektolog e si etnolinguist, e cila zë vend si pasuri jashtëzakonshme edhe etnonimike dhe nënndarje të tjera të onomastikës i rrit vlerat e Fjalorit. Porosia që duhen njohur e kundruar me kujdes apo tërheqja e vëmendjes nga akademiku për studiuesit e tjerë në faqet e fjalorit: "Më shkoqur, po edhe në mënyrë të atillë që të shihen si afria e gati njëjtësia fonetike e

morfologjike e të folmeve të Malësisë së Madhe, mund të ndjekim tri boshtet e krahasimit, sipas nesh me rëndësi parësore, që na zbulojnë përputhjet e tyre shumë të mëdha, po edhe dallimet e tyre, sado të vogla qofshin."²⁷ Pra, është rrugë frytdhënëse kombëtare që të dallojnë prirjen gjuhësore, e cila është shumë e vlefshme duke mëshuar tek gjuhësia krahasuese.

Pasthënia me rreshta si prirje më e gjerë se krahina, dialekti duke kaluar kufijtë e dialektet: "Por, le ta mbyllim me një varg të këngës malësorçe, që thotë: "Ka q e dita, ka q e thaç, merrnje ju tie:rt, se jua laç"²⁸, zakonisht këndohet, recitohet, kur gëzimi ka arritur kulmin dhe të tjerët e mirëpresin për ta vazhduar me atë intesitet. Edhe botimi i *Fjalorit leksiko-frazeologjik i Malësisë së Madhe të prof. Gj. Shkurtajt* vjen në rrugën e nisur për Fjalorin e madh. Profesori paraqet shumë përbashkësi, prirje për strukturën e Fjalorit të madh. *Paç dorën e mbarë të përbashkësive, prirjeve shkencore të botuara në këtë rrugë trashëguese për brezat!*

Literatura

Çabej, E. *Disa faza më të moçme të shqipës në dritën e gjuhëve fqinje*, në "Studime rreth historisë së gjuhës shqipe". Tiranë, 1973.

Gazulli, D. *Fjalori i Gazullit*. Tiranë, 2010

Fishta, Gj. *Lahuta e Malësisë*, Zarë, 1905.

Mërkuri, N. *Gjuhësi e krahasuar*. Triptik, 2018.

Shkurtajt, Gj. *Fjalori leksiko-frazeologjik i Malësisë së Madhe*. Tiranë, 2021.

Shkurtajt, Gj. *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë, 2015.

²⁷ Shkurtajt, Gj. *Fjalori leksiko-frazeologjik i Malësisë së Madhe*. Tiranë, 2021, f.9

²⁸ Po aty, f.1047.

Tipat ndërtimorë të sintagmave parafjalore në gjuhën angleze në përqasje me ato të gjuhës shqipe

Dr. Leonora Lumezi

leonora.xhori@unitir.edu.al

Dr. Daniela Hasa

daniela.hasa@unitir.edu.al

Departamenti i Gjuhës Angleze

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Një fakt themelor që ka të bëjë me fjalët në të gjitha gjuhët njerëzore është se, megjithëse janë të pafundme, ato mund të grupohen në një numër relativisht të vogël klasash që quhen kategori sintaksore. Ndër to, kategoritë sintagmatike kanë paraqitur interes të vazhdueshëm studimor. Artikulli në fjalë përqëndrohet pikërisht në analizën sintaksore të sintagmave parafjalore në të gjuhët angleze e shqipe. Jemi ndalur tek ndërtimet me sintagma parafjalore në të dyja gjuhët dhe përmes shembujve të shumtë kemi evidentuar ngjashmëritë dhe dallimet midis tyre. Përfundimet e analizës tregojnë sa pranë dhe larg janë këto dy gjuhë nga njëra-tjetra dhe theksojnë veçoritë tipologjike të tyre. Analiza strukturore e sintagmave parafjalore është parë nga këndvështrimi i gramatikës së frazës. Ajo tregon se gjuhë të tilla tilla si ajo angleze dhe shqipe, në dukje shumë të ndryshme nga njëra-tjetra për nga kriteri morfologjik i tipologjisë së gjuhëve, në rrafshin sintaksor dëshmojnë se ndajnë shumë karakteristika të përbashkëta dhe vërtetojnë teorinë e N. Çomskit mbi Gramatikën Universale(1).

Fjalë kyç: *Sintagmë, sintagma emërore, sintagma parafjalore, strukturë sintaksore, tipa ndërtimorë*

Abstract

A basic fact about words in all human languages is that, although infinite, they can be grouped into a relatively small number of classes called syntactic categories. Among them, phrasal categories have shown constant research interest. The article in question focuses precisely on the syntactic analysis of prepositional phrases in English and Albanian. We have analyzed the structure of prepositional phrases in both languages and through numerous examples have identified the similarities and differences between them. The conclusions of the analysis highlight their typological features and show where the two languages meet and depart in this respect. The structural analysis of prepositional phrases is viewed from the perspective of phrase structure grammar. It proves that languages such as English and Albanian, apparently different from each other in terms of morphological typology, share some basic features in common

as regards sentence structure, thus confirming N. Chomsky's theory on Universal Grammar.

Key words: *phrase, noun phrase, prepositional phrase, syntactic structure, phrase structure rules*

Hyrje

Parafjalët janë fjalë që përdoren gjerësisht në gjuhë. Për këtë arsye, ato kanë tërhequr gjithmonë vëmendjen e gjuhëtarëve të ndryshëm që janë munduar të japin një përkufizim të plotë për fjalët që bëjnë pjesë në këtë kategori leksikore, por që duket se asnjëherë nuk ia kanë mbërritur të japin një përkufizim unifikues pasi të gjitha tentativat që janë bërë deri më sot kanë qenë të diskutueshme. Megjithatë, parafjalët dhe sintagmat parafjalore si çdo kategori tjetër leksikore e sintagmatike në gjuhë meritojnë të studiohen, edhe pse vazhdimisht janë quajtur kategori shumë problematike. Autorë të ndryshëm gjatë dekadave të fundit e kanë rishqyrtuar problemin e klasifikimit të parafjalëve si fjalë leksikore apo funksionale dhe kanë mbërritur në përfundimin se ato janë një kategori gjysmëleksikore. Ata kanë rianalizuar konceptin e gramatikalitetit, sepse ai duket më tipiku për parafjalët, të cilat tradicionalisht përfshihen në kategorinë "funksionale", d.m.th. "gramatikore" ose "sintaksore".

Parafjalët në gjuhën angleze si edhe në atë shqipe janë fjalë që nuk mund të përdoren më vetë. Ato duhet të plotësohen me doemos nga një gjymtyrë tjetër që është zakonisht një sintagmë emërore (SE). Pra, sintagma të tilla ku parafjala ndiqet nga një plotës quhen sintagma parafjalore (SP). Në ndërtime të këtij lloji parafjala (P) është koka e sintagmës dhe elementi që e plotëson atë (SE) është plotësi i saj. Koka e një sintagme është lloji i fjalës bosht të sintagmës. Për shembull, kokë e sintagmave emërore janë emrat, e sintagmave foljore foljet, e atyre mbiemërore, mbiemrat dhe atyre ndajfoljore, ndajfoljet. Shembuj të sintagmave parafjalore mund të përfshinin sintagma të tilla si *in his face, at the table, on his left* (2). Parafjalët *in, at* dhe *on* janë përkatësisht kokë të sintagmave të mësipërme parafjalore.

Ashtu si në gjuhën angleze edhe në gjuhën shqipe parafjala në një SP vendoset para plotësit të saj p.sh.: *përtej rrugës, pas saj, mbi njërin sup, midis*

shkurreve, kundër zënies, prapa një bregoreje (3).

Në gjuhën angleze gjenden disa raste parafjalësh që edhe pse vendosen pas plotësit sillen si parafjalë tipike e emërtohen si të tilla:

Three weeks ago (4)

(Tri javë më parë)

All joking aside (po aty)

(Duke lënë shakanë mënjanë)

These objections withstanding (5)

(Pavarësisht kundërshtimeve)

Në gjuhën shqipe nuk ka raste të tilla të prapavendosjes. Parafjala gjendet gjithmonë para gjymtyrës që e plotëson atë.

Përqsja e tipave ndërtimorë

Përsa i përket strukturës së SP në gjuhën shqipe, parafjala plotësohet tipikisht nga një SE që përbën edhe strukturën më të shpeshtë të SP në gjuhën shqipe si edhe SP në gjuhën angleze. Megjithatë, edhe në gjuhën shqipe përveç SE, në strukturën e brendshme të SP ndeshen edhe përbërës të tjerë të cilët do t'i analizojmë më poshtë. Tipi ndërtimor më i shpeshtë i SP në gjuhën shqipe është:

SP → P + SE

Kjo është struktura më tipike dhe më e shpeshtë e SP në gjuhën shqipe. Parafjalët në këto sintagma mund të plotësohen nga SE të të gjitha llojeve, të thjeshta P + E/Pr (*nga myshku, midis tyre*) e të zgjeruara P + SE (*mbi katër degë ahu*). Sintagmat emërore në të tilla ndërtime kryejnë funksionin e plotësit të parafjalës ashtu sikurse edhe në gjuhën angleze. Siç mund të vihet re edhe nga shembujt e mësipërm, sintagmat emërore që vendosen pas kokës së sintagmave parafjalore mund të jenë të shumëllojshme, që nga më të thjeshtat e deri tek ato më komplekset ku emri kokë mund të marrë disa përcaktorë:

1. [*pas harkut*]

2. [me të]
3. [sipas të gjitha rregullave]
4. [gjatë drekës së mortit]
5. [prej një flamuri të largët]
6. [në katin e sipërm të kullës] (6)

Pra, parimi bazë i gjenerimit të sintagmave të këtij tipi ndërtimor është i njëjtë për të dyja gjuhët: P + SE. Ajo që i dallon këto ndërtime janë parametrat e ndryshëm të realizimit të këtij parimi. *Së pari*, në gjuhën angleze parafjalët nuk janë treguese të rasës (me përjashtim të rasteve kur parafjala përdoret me një përemër vetor ku ky i fundit del gjithmonë në formën e rasës kallëzore (*ëith* her, *on* them, etj.), ndërsa në gjuhën shqipe të gjitha rasat e emrit shoqërohen me parafjalë të caktuara. Pra, në këtë gjuhë parafjalët janë shenjuese të rasës së emrit. *Së dyti*, në gjuhën angleze emrat nuk marrin mbaresa rasore, ndërsa gjuha shqipe ka një sistem të pasur mbaresash rasore të emrit. *Së treti*, emri kokë pas parafjalës në gjuhën angleze merr përgjithësisht specifikues. Janë të rrallë emrat që nuk marrin specifikues pas parafjalës. Këta emra në gjuhën angleze përdoren me kuptim të përgjithshëm edhe jo specifik ose në SP të qëndrueshme. Në gjuhën shqipe, në varësi të parafjalës dhe të kuptimit të emrit, në SP me plotës SE të thjeshta, emrat mund të jenë të shquar dhe të pashquar. Krahaso p.sh.:

<u>Anglisht</u>	<u>Shqip</u>
on <u>the</u> wall	<i>mbi</i> <u>mur</u>
in <u>the</u> tree	<i>në</i> <u>pemë</u>
behind <u>the</u> tree	<i>pas</i> <u>pemës</u>
from <u>the</u> cinema	<i>nga</i> <u>kinemaja</u>

Në shembujt e mësipërm vihet re që parafjalët e rasave të ndryshme në gjuhën shqipe përdoren me emra në trajta të ndryshme. Parafjalët e rasës emërore p.sh. shoqërohen gjithmonë me emër në trajtën e shquar ose me emër në trajtën e

pashquar me specifikues (*një, ca*). Parafjalët e rasës kallëzore përdoren si me emra në trajtë të shquar edhe me emra në trajtë të pashquar pa specifikues, etj.

Në gjuhën shqipe, në rast se plotësi i parafjalës kokë është një SE e përbërë nga një përemër vetor, ai del në forma të ndryshme rasore ndryshe nga SP analoge në gjuhën angleze ku përemri del gjithmonë në rasën kallëzore, e cila është forma e vetme rasore e përemrit në këtë gjuhë. Për shembull:

<u>Anglisht</u>	<u>Shqip</u>
<i>from</i> <u>you</u>	<i>nga</i> <u>ju</u> (rasa emërore)
<i>between</i> <u>you and me</u>	<i>mes</i> <u>nesh</u> (rasa rrjedhore)
<i>over</i> <u>it</u>	<i>mbi</i> <u>të</u> (rasa kallëzore)

SP → P + Gr (Gerund)

Ky ndërtim ndeshet shpesh, edhe në gjuhën shqipe. Parafjala ndiqet nga një gerund. Gerundi është një formë foljore e pashtjelluar që emërton një veprim por dhe zotëron kryesisht karakteristika të foljes e të emrit. Në këtë mënyrë, ne mbështesim plotësisht mendimin e M. Çelikut për njohjen e kasaj forme gramatikore si një nga format e pashtjelluara të foljes edhe në gjuhën shqipe (7). Le të japim disa shembuj:

1. ...urdhrin [**për** të larë *gjakun*]...
2. ...bëri mënjanë [**për** t'i hapur *rrugë varganit*]
3. ...presin [**për** të dhënë *taksën*]...
4. ...më të devotshëm, të gatshëm [**për** t'u *flijuar*]... (8)

Duke gërshetuar karakteristika si foljore ashtu edhe emërore, gerundi mund të paraprihet edhe nga parafjalë siç vihet re edhe në shembujt e

mësipërm. Sintagma që formohet është pra, një SP e cila luan rolin e elementit të varur të një sintagmeje foljore (shemb.3), emërore (shemb.2) e mbiemërore (shemb. 4). Gerundi në të tilla ndërtime është plotës, ashtu si edhe në gjuhën angleze, pra një element i domosdoshëm për strukturën dhe kuptimin e sintagmës.

E përbashkët për të dyja gjuhët është edhe funksioni i SP të këtij lloji si elementë të varur të sintagmave të zgjeruara, emërore, mbiemërore dhe foljore, si p.sh.:

Anglisht**Shqip**

(SFI) force
himself *into* losing
consciousness

presin për të
dhënë taksën

(SE) the difficulty
in talking about
such things

urdhrin për të
larë gjakun

(SM) successful *in*
achieving their aims

të gatshëm për
t'u flijuar

Si përcaktor në sintagmat emërore, në gjuhën shqipe gerundi paraprihet nga parafjala *për*, ndërsa në gjuhën angleze nga disa parafjalë që varen nga emrat me të cilët përdoren, duke qenë se në këtë gjuhë, në mungesë të mbaresave me emra, folje e mbiemra të ndryshëm përdoret një numër i konsiderueshëm parafjalësh që quhen parafjalë të varura meqenëse ato janë specifike e varen nga fjala me të cilën kombinohen, duke kryer, në njëfarë mënyre, funksionin që kryejnë mbaresat në gjuhën shqipe. Më shpesh ndeshet parafjala e rasës gjinore *of* por edhe parafjalë të tjera të thjeshta si *at*, *on*, *in*, etj. Në SM në gjuhën angleze, parafjalët që paraprijnë gerundin janë specifike në varësi të mbiemrit me të cilin përdoren, ndërsa në gjuhën shqipe parafjala e vetme është *për* dhe vendoset pas mbiemrave të tipit *i gatshëm*, *i përshtatshëm*, *i etur*, etj. që tregojnë cilësi të përkohshme e jo të përhershme.

Si pjesë e sintagmave foljore në gjuhën angleze, gerundi del me parafjalë të ndryshme në funksionin e rrethororit, ku parafjala ruan një kuptim të caktuar leksikor, dhe me parafjalë specifike që përzgjidhen nga folje të ndryshme parafjalore. Në këtë rast funksioni i SP është ai i kundrinorit me parafjalë si në shembullin *force*

himself into losing consciousness, ku parafjala *into* përzgjidhet nga folja *force*. Në gjuhën shqipe sintagmat e këtij tipi ndërtime dalin me parafjalën *për* dhe *me* dhe përcaktojnë foljen duke funksionuar si rrethoror qëllimi, shkak, e kohe (shih shembujt më lart).

Megjithëse formula e gjenerimit të një SP të këtij tipi ndërtime është e njëjtë për të dyja gjuhët ajo që i bën ato të ndryshme nga njëra tjetra është forma e gerundit. Në gjuhën angleze ai del në trajta të ndryshme diatezore e kohore, p.sh.:

overhearing (trajtë
veprore)

being overheard (trajtë pësore),

having overheard (trajtë veprore e së
kryerës)

having been overheard (trajtë pësore e së
kryerës)

Një dukuri e tillë nuk ndodh me gerundin në gjuhën shqipe. Ai nuk ka tipare foljore kaq të spikatura sa gerundi i anglishtes. Në gjuhën shqipe gerundi del në dy trajta rasore: kallëzore (*të bërë*) e rrjedhore (*së bëri*), tipar ky emëror i gerundit që e dallon atë nga gerundi i anglishtes i cili nuk ka tregues rasorë (9).

SP → P + FE (sifjali emërore)/Fpc (sifjali përcaktore)

Ndonëse rrallë, në gjuhën shqipe ndeshim edhe ndërtime të tilla ku parafjala ndiqet jo nga një emër apo SE por nga një sifjali. Lloji i sifjalisë është emërore ose përcaktore. Sifjalitë emërore quhen të tilla sepse sillen në strukturën e fjalisë si emra duke kryer kështu funksione tipike emërore si ai i kryefjalës, kundrinorit, përcaktorit kallëzuesor të kryefjalës a të kundrinorit, etj. Ato zakonisht janë sifjali pyetëse të zhdrejta. Sifjalitë përcaktore përcaktojnë SE dhe fillojnë me ndajfolje lidhore ose përemër lidhor. Për shembull:

1. Kush e di [*për kë po na marrin*]. (P + FE)
2. ...e njihje mirë atë rrafsh [*për të cilin thoshin*]... (P + FPC)

3. ...dhe kulla e ngujimit [**drejt së cilës ata po shkonin**]. (P + FPc) (10)

Sifjalitë emërore dhe ato përcaktore si plotës të parafjalëve janë të ngjashme në të dyja gjuhët. I vetmi dallim është se në gjuhën shqipe tipat ndërtimorë P + SE nuk kanë denduri të madhe si në gjuhën angleze duke qenë se në këtë gjuhë ato plotësojnë kryesisht folje parafjalore që nuk janë tipike për gjuhën shqipe, si p.sh.: The teacher listened **to** what the students said.

Në lidhje me tipat ndërtimorë P + FPc, në gjuhën angleze theksuam se parafjala mund të zhvendoset edhe në fund të sifjalisë përcaktore (the boy **at** whom I was looking/the boy I was looking **at**). Kjo gjë nuk ndodh në gjuhën shqipe ku parafjala qëndron pranë folësit dhe nuk mund të shkëputet prej tij. Gjithashtu, në SP që ndiqen nga sifjali përcaktore përemri lidhor apo pyetës në gjuhën shqipe del në një rasë të caktuar në varësi të parafjalës që i paraprin (shemb. 1 dhe 3). Në gjuhën angleze ai nuk ndryshon. Sintagmat parafjalore të këtij tipi janë pjesë e sintagmave më të zgjeruara kryesisht foljore e mbiemërore, të cilat do t'i analizojmë në vijim të punimit.

SP → P + SN (Sintagmë Ndajfoljore)

Si edhe në gjuhën angleze, në gjuhën shqipe janë të rralla sintagmat parafjalore sipas modelit ndërtimor P + SN. Për shembull:

1. Gjëmëtarët erdhën [**nga larg**].
2. ...se si do të mbërrinin [**gjer atje**]...
3. Tri herë ka ardhur [**gjer më sot**] Binak Alia...
4. ...sapo u nisën [**për atje**]... (11)

Pra, në të dyja gjuhët sintagma të tilla ndërtohen në të njëjtën mënyrë; parafjala kokë vendoset para një SN që në më të shumtën e rasteve tregon vend ose kohë, karakteristikë kjo e përbashkët për SP të këtij lloji në të dyja gjuhët.

SP → P + SP (Sintagmë Parafjalore)

Sintagmat parafjalore të tipit P + SP, janë të rralla në gjuhën shqipe, ndryshe nga gjuha angleze në të cilën sintagma të tilla parafjalore ndeshen shpesh. Në këtë gjuhë ato dalin kryesisht si plotës parafjalorë brenda sintagmave parafjalore duke kryer funksionin e plotësit të sintagmave foljore pas foljeve parafjalore, si p.sh. *had gone straight **on with** his speech*, ku folja parafjalore *go on* kërkon plotës me parafjalën *with*.

Në gjuhën shqipe sintagma të këtij lloji mund të hasen tek-tuk në gjuhën e folur ose në stilin letrar. Në vend të ndërtimeve të tipit P + SP si p.sh.: *Zëri erdhi [**nga jashtë** sallës]*, në gjuhën shqipe parapëlqehet ndërtimi P + N: *Zëri erdhi [**nga jashtë**]*.

Sintagma të tipit SP → P + SM (Sintagmë Mbiemërore) që në gjuhën angleze janë shumë të rralla, si *at first, at last, for certain, for sure, in brief, in private, of late, of old* e ndonjë tjetër e që përgjithësisht janë të qëndrueshme dhe kanë kuptim ndajfoljor, nuk hasen në gjuhën shqipe. Megjithatë ka edhe në gjuhën shqipe raste kur parafjala *për* paraprin një përcaktor kallëzuesor të kryefjalës a të kundrinorit të shprehur me mbiemër. Në këto raste ajo ngjan me ndërtimet përkatëse të gjuhës angleze. Për shembull:

Anglisht

They took me
[**for dead**].

Shqip

Më morën
[**për të vdekur**]

Në këtë shembull *dead* dhe *të vdekur* janë sintagma mbiemërore që plotësojnë përkatësisht parafjalët *for* dhe *për* duke formuar SP që kryejnë funksionin e përcaktorit kallëzuesor të kundrinorit. Në tekstin *Gramatika e Gjuhës Shqipe* (12) thuhet se parafjala *për* në këtë funksion i ka humbur tiparet e saj parafjalore dhe duhet konsideruar si pjesëz. Si edhe në gjuhën angleze numri i foljeve që marrin SP të këtij lloji është shumë i kufizuar. Në të tilla ndërtime në vend të mbiemrit shpesh haset një emër, p.sh.: *Po më marrin **për princeshë***. (13)

Ashtu si në gjuhën angleze edhe në gjuhën shqipe hasen sintagma parafjalore me plotës të dyfishtë: i pari një sintagmë emërore dhe i dyti një sintagmë tjetër parafjalore si psh:

1. [Nga tokat te rrugët]
2. [Nga e djathta në të majtë]
3. [Nga një gjer më shtatëmbëdhjetë prill] (14)

Përveç këtyre togjeve të lira, që tregojnë përgjithësisht kohëzgjatjen e veprimit ose pikënisjen dhe pikëmbërritjen e tij, ashtu si edhe në gjuhën angleze, në ndërtime të tilla SE si plotësa parafjalore shpesh dalin me të njëjtin emër kokë, si p.sh: **nga koha në kohë, nga brezi në brez, nga viti në vit** (15).

Këto sintagma ashtu si togjet e ngjashme në gjuhën angleze (**from age to age, from conquer to conquer, from place to place**) janë të qëndrueshme dhe nuk marrin fjalë përcaktuese. Emrat pas parafjalëve që ndeshen në këto sintagma dalin në rasën që i drejton parafjala, zakonisht emërore (parafj. *nga*) dhe kallëzore (parafj. *në*). Sintagma të tilla tregojnë më së shumti marrëdhënie vendore e kohore:

Anglisht: [*from north to south*],
[*from the morning to night*]

Shqip: [*nga veriu në jug*] [*nga mëngjesi në darkë*]

Koka e një sintagme të tillë është parafjala e parë. Për shembull, në sintagmat e mësipërme parafjala kokë është **from** e cila merr plotës të dyfishtë: sintagmë emërore (përkatësisht *north, veriu, the morning, mëngjesi*) dhe sintagmë parafjalore (përkatësisht *to south, në jug, to night, në darkë*). Sintagmat e dyta parafjalore varen nga sintagmat e para. Në ndërtime të tilla vihet re përdorimi i sintagmave emërore të thjeshta, pa specifikues a fjalë përcaktuese. Në më të shumtën e rasteve ato përbëjnë struktura të qëndrueshme me vlerë ndajfoljore, që përdoren për të përforcuar veprimin e shprehur nga folja ose për të shprehur kohëzgjatjen e tij, por mund të jenë edhe sintagma të lira, jo-idiomatike e në këto raste vihet re se sintagmat emërore mund të specifikohen nga fjalë të ndryshme përcaktuese (*shih shembujt më lart*).

Në strukturat që përmendëm në këtë pjesë të punimit elementët e varur të sintagmave

parafjalore ashtu si edhe në gjuhën angleze janë përgjithësisht plotës, pra elementë të domosdoshëm për strukturën dhe kuptimin e sintagmave të tilla. Por, ashtu siç e theksuam gjatë analizës së sintagmave parafjalore në gjuhën angleze, plotësit nuk janë të vetmit elementë që marrin pjesë në strukturën e SP. Ata mund të përcaktohen edhe nga fjalë përcaktuese tipike për këto sintagma. Kjo dukuri ndodh edhe me SP në gjuhën shqipe.

Përfundime

Analiza e mësipërme e sintagmave parafjalore në gjuhët angleze dhe shqipe vërteton se ato kanë ngjashmëri të dukshme përsa i përket strukturës së tyre. Në bazë të kriterit sintaksor të tipologjisë së gjuhëve, shqipja dhe anglishtja i përkasin tipit *Kryefjalë + Kallëzues + Kundrinor*, ndonëse secila ka tiparet e veta specifike që lidhen me rendin e fjalëve në fjali. Gjithashtu, edhe përsa i përket llojit të sintagmave për nga mënyra se si renditen fjalët në to, d.m.th. pozicioni që zë koka në strukturën e sintagmës, gjuhët shfaqen dukshëm të ngjashme me njëra-tjetrën. Në këtë aspekt, të dyja gjuhët janë kryesisht gjuhë të tipit *kokë + element i varur*, d.m.th. koka është fjala që kryeson sintagmën, megjithëse kjo nuk ndodh në të gjitha rastet.

Ky tipar i përbashkët vihet re edhe në analizën e SP. Në të dyja gjuhët ato kanë përgjithësisht të njëjtën strukturë: SP → P + E (SE) pra, parafjala është koka e sintagmës dhe vendoset në fillim të saj. Në lidhje me tipat ndërtimorë të sintagmave parafjalore, ngjashmëritë mes dy gjuhëve janë të shumta. Llojet më tipike të sintagmave parafjalore janë të përbashkëta për të dyja gjuhët. Ato përfshijnë:

SP → P + SE, SP → P + Gr, SP → P + FE/Fpc, SP → P + SN, SP → P + SP.

Ajo që i dallon gjuhët, përsa i përket llojeve të SP, janë mënyrat e ndryshme të realizimit të SP në secilën gjuhë në varësi të veçorive specifike morfo-sintaksore të tyre. Gjuha shqipe del me parafjalë të rasave të ndryshme dhe me forma më të larmishme të emrave e përemrave sipas rasës së tyre, në gjuhën angleze parafjalët nuk janë shenjuese të rasës dhe emrat e përemrat janë të pandryshueshëm (me përjashtim të

përemrave vetorë që pas një parafjale dalin gjithmonë në formën gramatikore të rasës kallëzore) e përgjithësisht marrin specifikues.

Bibliografi

(1) Cook, V. J. (1991). *Chomsky's Universal Grammar - An Introduction*, Great Britain. 75.

(2) G. Orwell, *Nineteen eighty four*: 56.

(3) I. Kadare, *Prilli i thyer*: 9, 10, 11, 12, 13.

(4) Wekker, H. and Haegeman, L. (1993). *A Modern Course in English Syntax*, Great Britain:52.

(5) Huddleston, R. Pullum, G. K. (2002). *The Cambridge Grammar of the English Language*, Cambridge University Press: 631.

(6) Shembujt 1-6 janw marrw nga I. Kadare, *Prilli i thyer* : 18, 20, 22, 23, 26.

(7) Çeliku, M. (2010). *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe* (ribotim), Tiranë: shblu: 44.

(8) Shembujt 1-4 janw marrw nga I. Kadare, *Prilli i thyer* : 27, 28, 116, 81.

(9) Çeliku, M. (2008). *Tekst Ushtrimesh për Sintaksën e Shqipes Standarde (Pajisur me shënime teorike dhe me modele të zgjidhura)*. Tiranë.

(10) Shembujt 1-3 janw marrw nga I. Kadare, *Prilli i thyer* : 90, 135, 133.

(11) Shembujt 1-4 janw marrw nga I. Kadare, *Prilli i thyer* : 16, 82, 91, 92.

(12) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, (2002). *Gramatika e Gjuhës Shqipe*. Tiranë: 393.

(13) Shembull i marrw nga I. Kadare, *Prilli i thyer* : 95.

(14) Shembujt 1-3 janw marrw nga I. Kadare, *Prilli i thyer* : 137, 149.

(15) Shembujt janw marrw nga I. Kadare, *Prilli i thyer* : 28, 129.

SHKENCAT INXHINIERIKE DHE MATEMATIKORE

Një vështrim mbi Algjebrën Gjeometrike

MSc.Elda Lamçe

Prof.Asoc Llambrini Sota

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

elda.lamce@univlora.edu.al, llambrini.sota@univlora.edu.al

Abstrakti

Ky artikull jep një pasqyrë të shkurtër të Algjebrës gjeometrike e cila është gjuha që shpreh konceptet e vjetra dhe të reja në mënyrë më të thjeshtë. Duke përkufizuar tehet, multivektorët, produktin e jashtëm, të brendshëm dhe atë gjeometrik ne ndërtojmë një bashkësi instrumentash që konsistojnë në dualë, të anasjellë, projeksione dhe rejeksione, prerjen dhe potencialisht shumë e më shumë akoma. Rezultati është shumë më tepër se një bashkësi të aksiomave të Algjebrës së Cliffordit së bashku me disa teorema që qartësojnë strukturën e algjebrës. Bëhet fjalë për një gjuhë matematikore për të shprehur dhe thelluar ide gjeometrike të çdo tipi.

Fjalë kyçe: *multivektor, vektorët dual, pasqyrimi, rrotullimi në 3D*

Abstract. This article gives a brief overview of Geometric algebra which is the language that expresses old and new concepts in a simpler way. By defining the bows, multivariants, external, internal and geometric product we construct a set of instruments that consist of dual, inverse, projection and rejection, meeting and potentially much more. The result is much more than a set of Clifford's algebra axioms along with some theorems that clarify the structure of algebra. It is a mathematical language to express and deepen geometric ideas of any type.

Keywords: *multivectors, dual vectors, reflection, rotation in 3D*

1. Prodhimi jashtëm

Pa shpjeguar saktësisht se çfarë është, ne mund të përkufizojmë një algjebër të Cliffordit në \mathbb{R}^n , $Cl(\mathbb{R}^n)$ ose thjesht Cl_n , në qoftë se është e qartë që kemi formuar kështu algjebrën e Clifford mbi numrat realë.

Prodhimi i jashtëm është një veprim i përkufizuar brenda kësaj algjebre dhe shënohet me \wedge . Më poshtë janë vetitë e prodhimit të jashtëm të vektorëve. Le të jenë $a, b, c \in \mathbb{E}^n$.

$$a \wedge b = -b \wedge a$$

$$(a \wedge b) \wedge c = a \wedge (b \wedge c)$$

$$a \wedge (b + c) = (a \wedge b) + (a \wedge c).$$

Një tjetër veti e rëndësishme është

$$a \wedge b = 0 \Leftrightarrow a \text{ dhe } b \text{ janë linearisht të varur. [1]}$$

2. Prodhimi i brendshëm

Një tjetër veprim i rëndësishëm në algjbrën gjeometrike është prodhimi i brendshëm, icili do të shënohet me " \cdot ". Për vektorët $a, b \in \mathbb{R}^n$, prodhimi i brendshëm i tyre është i njëjtë me prodhimin scalar të tyre. [1]

$$a \cdot b = a * b.$$

Kjo mund të quhet dhe vetia "metrike" e prodhimit të brendshëm, meqë rezultati i prodhimit scalar të dy vektorëve varet nga

metrika e hapësirës vektoriale në të cilën ata shtrihen. Gjithësesi, prodhimi i brendshëm gjithashtu gëzon veti algjebrike për elementët në $\mathcal{C}\ell(\mathbb{R}^n)$, të cilët janë të pavarur nga metrika e hapësirës vektoriale \mathbb{R}^n . Më poshtë paraqiten disa veti pa vërtetim. Le të jetë $a, b, c \in \mathbb{R}^n$, atëherë bivektori $b \wedge c \in \mathcal{C}\ell(\mathbb{R}^n)$, prodhimi i brendshëm i a me këtë bivektor do të japë

$$a \cdot (b \wedge c) = (a \cdot b)c - (a \cdot c)b.$$

3.INTERPRETIMI GJEOMETRIK I PRODHIMIT TË BRENDSHËM

Ne gjithashtu mund të japim një ide për atë që ndodh në algjebren e Clifford në $\mathbb{R}^2, \mathcal{C}\ell(\mathbb{R}^2)$ me bazat ortonormale $\{e_1, e_2\}$. Prodhimi i jashtëm $e_1 \wedge e_2$ gjeneron të gjithë hapësirën, d.m.th. një plan. Tani le të shikojmë prodhimin e brendshëm të e_1 me këtë bivektor.

$$e_1 \cdot (e_1 \wedge e_2) = (e_1 \cdot e_1)e_2 - (e_1 \cdot e_2)e_1 = e_2.$$

Kjo mund të interpretohet si një "ndryshesë" e nënhapësirës së përfaqësuar nga e_1 nga nënhapësira e përfaqësuar nga $e_1 \wedge e_2$. Ajo çka ngelet nga kjo zbritje, është sigurisht pingul me e_1 .




Fig. 1.2: Prodhimi i brendshëm i një vektori dhe një bivektori.

Le të jetë P bivektori $a \wedge b \in \mathcal{C}\ell(\mathbb{R}^3)$. Në \mathbb{E}^3 ky bivektor përfaqëson një plan përmes origjinës, siç tregohet në figurën 1.2. Një vektor $x \in \mathbb{R}^3$ në përgjithësi ka një komponent paralel me $P, x^||$, dhe një komponent pingul me $P, x^⊥$, të tillë që $x = x^|| + x^⊥$. Si rrjedhim

$$y := x \cdot P = (x^|| + x^⊥) \cdot P = x^|| \cdot P.$$

Prodhimi i brendshëm $x^|| \cdot P$ tani "heq" nën hapësirën e përfaqësuar nga $x^||$ nga nën hapësira e përfaqësuar nga P , e cila rezulton në një vektor i cili shtrihet në P dhe është pingul me x , siç tregohet në figurën 1.2. [10]

4.INTERPRETIMI GJEOMETRIKI IPNS




Fig. 1.3: Duali i planit të përfaqësuar nga bivektori $a \wedge b$.

Tashmë kemi parë që IPNS e ndonjë vektori $n \in \mathbb{R}^3$ është një plan që kalon përmes origjinës ku n është normal i planit. Në lidhje me veprimin e dualit, është treguar në paragrafin e mëparshëm që normal i një plani të gjeneruar nga $a, b \in \mathbb{R}^3$, është dhënë nga $(a \wedge b)^*$.

Supozojmë që $n = (a \wedge b)^*$. Ana e planit $a \wedge b$ nga e cila normal n ngrihet pingul zakonisht shihet si ana ballore e planit. Pra, një bivektor përfaqëson një anë plani. Për shembull, normal m i $b \wedge a$ jepet nga

$$m = (b \wedge a)^* = -(a \wedge b)^* = -n.$$

Prandaj, plani i përfaqësuar nga $b \wedge a$ konsiston në të njëjtën nënhapësirë të \mathbb{R}^3 ashtu si plani i përfaqësuar nga $a \wedge b$, por ana-ballore e tyre konsiston në drejtime të kundërta. Pikërisht kjo situatë është treguar në fig. 1.3. Kjo gjithashtu tregon lidhjen midis prodhimit kryq vektorial dhe prodhimit të jashtëm: [9]

$$a \times b = (a \wedge b)^*.$$




Fig. 1.4: Prerja e dy planeve në terma të IPNS.

N.q.s. $A_{(3)} \neq 0$ atëherë a, b dhe c janë linearisht të pavarur. Për të gjetur IPNS e $A_{(3)}$, ne duhet të gjejmë se cili vektor x kënaq barazimin $x \cdot A_{(3)} = 0$.

Gjeometrikisht kjo nënkupton që $x \cdot A_{(3)} = 0$ a.t.t kur x ndodhet në prerjen e tri planeve në të cilët shtrihen a, b dhe c . Meqë të gjithë planet e paraqitur përmes IPNS-së së vektorëve kalojnë përmes origjinës, pika e vetme ku të gjithë planet mund të takohen është origjina. Prandaj, zgjidhja e vetme për x që $x \cdot A_{(3)} = 0$ është zgjidhja trivial $x = 0 \in \mathbb{R}^3$. Figura 1.5 e ilustron këtë.




Fig. 1.5: Prerja e tri planeve në terma të IPNS.

5. PASQYRIMI

Më parë pamë se si të ndërtojmë nënhapësira lineare duke përdorur produktin e jashtëm dhe si të heqim nënhapësira lineare nga njëra tjetra duke përdorur produktin e brendshëm. Gjithashtu dime se sitë ndërpresim nënhapësirat lineare duke përdorur takimin dhe si të formojmë bashkimin e tyre me anë të nyjes. Tani do të duam të veprojmë në nënhapësira duke mbajtur të pa ndryshuar dimensionin e tyre. Për shembull, rrotullimi i një drejtëze rezulton një drejtëz tjetër, jo një pike apo një plan. Një veprim në një teh i cili nuk ndryshon gradën e tij quhet ruajtës grade. Le të shohim një veprim të tillë. Le të jenë $a, n \in \mathbb{R}^n$ dy vektorë, ku $\|n\| = 1$. Gjithashtu shkruajmë $a = a^{\parallel} + a^{\perp}$, ku a^{\parallel} është komponenti i a paralel dhe a^{\perp} komponenti pingul me n . [2] Theksojmë që llogaritja e mëposhtme është e vlefshme për të gjitha dimensionet $n \geq 2$ të hapësirës vektoriale.

$$\begin{aligned} \mathbf{n} \mathbf{a} \mathbf{n} &= (\mathbf{n} \mathbf{a}) \mathbf{n} = (\mathbf{n} \cdot \mathbf{a} + \mathbf{n} \wedge \mathbf{a}) \mathbf{n} \\ &= (\mathbf{n} \cdot \mathbf{a}) \mathbf{n} + (\mathbf{n} \wedge \mathbf{a}) \cdot \mathbf{n} \\ &+ \underbrace{(\mathbf{n} \wedge \mathbf{a}) \wedge \mathbf{n}}_{=0} \end{aligned}$$

$$\begin{aligned} \mathbf{n} \mathbf{a} \mathbf{n} &= 2(\mathbf{n} \cdot \mathbf{a}^{\parallel}) \mathbf{n} - \mathbf{a} = 2 \| \mathbf{a}^{\parallel} \| \mathbf{n} - \mathbf{a} \\ &= 2 \mathbf{a}^{\parallel} - \mathbf{a}^{\parallel} - \mathbf{a}^{\perp} = \mathbf{a}^{\parallel} - \mathbf{a}^{\perp}. \end{aligned}$$

Gjeometrikisht ky është një pasqyrim i vektorit a nën një drejtëz përmes origjinës me drejtim n . Gjëja më e bukur për sa i përket veprimit të pasqyrimin është që ai mund të aplikohet tek çdo teh. Përshebull një plan i dhënë si bivektori $A_{(2)} \in \mathcal{C}\ell(\mathbb{R}^3)$, mund të pasqyrohet në një vektor normal $n \in \mathbb{R}^3$ thjesht nga vlerësimi $\mathbf{n} A_{(2)} \mathbf{n}$. Kjo tregohet në figurën 1.6. [3]




Fig. 1.6: Pasqyrimi i bivektorit $A_{(2)}$ në vektorin n . [8]




Fig. 1.7: Pasqyrimi i vektorit a në bivektorin $N_{(2)}$.

Veprimi i pasqyrimet është në fakt veprimi i vetëm që ne do të përdorim ndonjëherë në algjebren gjeometrike. Çdo veprim tjetër do të përftohet nga kombinimi i një numri të ndryshëm pasqyrimesh. Në hapësirën Euklidiane kjo na lejon në fakt që të pasqyrojmë dhe rrotullojmë në lidhje me boshtet që kalojnë përmes origjinës. [7]

6. RROTULLIMET

Pasqyrimet në lidhje me një vektor normal **n** janë gjithmonë pasqyrimet në një drejtëz që kalon nga origjina dhe ka drejtim **n**. Mund të tregohet që dy pasqyrimet e njëpasnjëshme në lidhje me vektorët normal të ndryshëm **n** dhe **m** janë ekujalent me një rrotullim me dyfishin e këndit midis **n** dhe **m**. [4]




Fig. 1.8: Rrotullimi i vektorit a me anë të pasqyrimet të njëpasnjëshme të a në n dhe m.

Figura 1.8 tregon një veprim të tillë në hapësirën 3d –Euklidiane[6]. Vektorët normal **n, m** ∈ ℝ³ përcaktojnë një kënd ∠(**n**, **m**) = θ dhe një plan rrotullimi përmes produktit të tyre të jashtëm **n** ∧ **m**. Pasqyrimi i vektorit **a** ∈ ℝ³ së pari në **n** dhe më pas në **m**, rrotullon komponenten e **a** që ndodhet në planin e rrotullimit me 2θ. Komponentja e **a** pingul me planin e rrotullimit mbetet e pa ndryshuar.

Rrotullimi i vektorit **a** në planin **n** ∧ **m** me një kënd 2θ mund të shkruhet atëherë si

$$\mathbf{b} = \mathbf{m} \mathbf{n} \mathbf{a} \mathbf{n} \mathbf{m}.$$

$$\mathbf{b} = R \mathbf{a} R^{-1}, \text{ ku } R := \mathbf{m} \mathbf{n}. [5]$$

Meqë aplikimi i R si më sipër ka efektin e një rrotullimi, R është quajtur një rotor.

Përfundime

Algjebra gjeometrike na njeh me dy koncepte të reja. Së pari ajo pranon se një vector është një

nëhapësirë 1-dimensionale dhe për rrjedhojë do të ketë pa dyshim nëhapësira të tilla edhe të rendeve më të larta. Përkufizohen kështu bivektorët, trivektorët dhe K-tehët si përgjithësim i nëhapësirave. Multivektorët janë kombinime lineare të tehëve të gradëve të ndryshme. Së dyti ajo përkufizon produktin gjeometrik për multivektorët. Për arsye se produkti gjeometrik përmban në vetvete si produktin e brendshëm ashtu dhe atë të jashtëm ai bashkon kuptimin e ortogonalitetit dhe kolinearitetit në një veprim të vetëm. Në kombinim me faktin që produkti gjeometrik jep më shumë multivektorë ai bëhet një operator ekstremisht i fuqishëm i aftë për të shprehur relacione dhe ide të ndryshme gjeometrike.

Duke përdorur tehët, multivektorët, produktin e jashtëm, të brendshëm dhe atë gjeometrik ne mund të ndërtojmë një bashkësi instrumentash që konsistojnë në dualë, të anasjellë, projeksione dhe rejeksione, takimin dhe potencialisht shumë e më shumë akoma. Elementet thelbësorë dhe këto instrumenta na japin mënyra të reja të përkufizimit të elementëve të zakonshëm siç janë drejtëzat dhe planet, si në modelin tradicional ashtu dhe në modelin homogjen. Ajo na jep dhe mënyra të reja të arsyetimit për relacionet midis elementëve.

Bibliografi:

[1] R. Abłamowicz. Clifford algebra computations with maple.
 [2] R. Abłamowicz and B. Fauser. The CLIFFORD home page. 2002.
 [3] D. Hestenes and R. Ziegler, *Projective Geometry with Cli@ord Algebra*, (submitted).
 [4] A. N. Whitehead, *A Treatise on Universal Algebra with Applications*.
 [5] J. Browne. The grassmannalgebra book home page. HTML document, 2002.
 [6] William K. Clifford. On the classification of geometric algebras.
 [7] D. Hestenes and G. Sobczyk, *Cli@ord Algebra to Geometric Calculus*,
 [8] L. Dorst, C. Doran, and J. Lasenby, editors. *Applications of Geometric Algebra in Computer Science and Engineering*. Birkh 2002.
 [9] L. Dorst, S. Mann, and T. Bouma. GABLE: A MatLab tutorial for geometric algebra. HTML document, 2000.

[10] Leo Dorst. Honing geometric algebra for its use in the computer sciences.

Metodat statistikore joparametrike

Prof.Asoc Llambrini Sota

MSc.Elda Lamçe

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

llambrini.sota@univlora.edu.al, elda.lamce@univlora.edu.al,

Nonparametric methods use approximate solutions to exact problems, while parametric methods use exact solutions to approximate problems.

W.J. Conover

Abstrakti

Ky artikull jep një përmbledhje të shkurtër për metodat statistikore joparametrike të cilat zbatohen kur nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të përcaktuar formën e shpërndarjes, ose kur të dhënat vijnë nga një shpërndarje për të cilën metodat parametrike nuk janë lehtësisht të disponueshme dhe në situata të tilla studiuesi shpreson të mos bëjë supozime të pabaza. Kryesisht zbatohen kur të dhënat janë nominale ose të zakonshme, por edhe ndaj të dhënave intervalore ose raporti në rastin kur asnjë supozim nuk mund të bëhet për shpërndarjen probabilitare të popullimit. Hulumtimet kanë treguar se testet statistikore joparametrike janë pothuajse po aq të afta për të zbuluar dallimet midis popullatave sa edhe metodat parametrike kur normaliteti dhe supozimet e tjera plotësohen. Ato mund të jenë shpesh më të fuqishme në zbulimin e dallimeve të popullsisë kur këto supozime nuk plotësohen. Për këtë arsye, disa statisticienë mbrojnë përdorimin e procedurave joparametrike në preferencë ndaj homologeve të tyre parametrike.

Fjalë kyçe: *Metoda joparametrike, Testi i shenjave, Testi i rangut Wilcoxon, Testi H Kruskal-Wallis, Korrelacioni i rangut*

Abstract

This article provides a brief overview of nonparametric statistical tests that are applied when there is insufficient data to determine the form of distribution or when the data come from a distribution for which parametric methods are not easily available and in such situations the statistician hopes not to make baseless assumptions. They mainly apply when the data are nominal or ordinary, but also to interval data in the case when no assumptions can be made about the probabilistic distribution for the population. Research has shown that nonparametric statistical tests are almost as capable of detecting differences among populations as the parametric methods when normality and other assumptions are satisfied. They may be, and often are, more powerful in detecting population differences when these assumptions are not satisfied. For this reason, some statisticians advocate the use of

nonparametric procedures in preference to their parametric counterparts.

Keywords: *nonparametric statistical tests, sign test, Wilcoxon rank test, The Kruskal-Wallis H - test, rank correlation.*

Hyrje

Disa eksperimente gjenerojnë përgjigje që mund të renditen ose rankohen, por vlera aktuale e përgjigjes nuk mund të matet numerikisht, përveçse me një shkallë arbitrare që mund të krijohet. Disa shembuj të tille janë:

- Aftësitë e shitjeve të katër përfaqësuesve të shitjeve janë renditur nga më e mira te më e keqja.
- Janë vlerësuar karakteristikat e shijes së pesë markave të rrushit në një shkallë arbitrare nga 1 deri në 5.
- Pesë modele automobilash renditen nga më tërheqës në më pak tërheqës

Si mund të analizohen këto lloj të dhënash? Metodatat statistikore me kampion të vogël janë të vlefshme vetëm kur popullsia e mostrës është normale ose afërsisht normale. Të dhënat që përbëhen nga shkallë arbitrare nga 1 në 5 nuk e përmbushin supozimin e normalitetit, qoftë edhe në një shkallë të arsyeshme. Në disa aplikacione, teknikat janë të vlefshme nëse mostrat janë nxjerrë rastësisht nga popullata variancat e të cilave janë të barabarta. Kur të dhënat duket se nuk i plotësojnë këto supozime mund të përdoret një metodë alternative e analizës - metoda statistikore joparametrike.

Metodat tradicionale statistikore bazohen në supozime parametrike, që nënkupton se të dhënat mund të supozohen se janë gjeneruar nga disa familje të njohura shpërndarjesh, siç është shpërndarja normale, eksponenciale, Poisson e kështu me radhë. Secila prej këtyre shpërndarjeve ka një ose më shumë parametra ku të paktën njëri prej të cilëve supozohet i panjohur dhe duhet të konkludohet. Por shpeshherë me eksperimente komplekse dhe zgjedhje të çrregullta të kampionimit, të dhënat e krijuara mund të mos i atribuohen ndonjë

shpërndarjeje të njohur. Në rastin kur eksperimentuesi nuk është i sigurt për shpërndarjen themelore të të dhënave, nevojiten teknika statistikore të cilat mund të zbatohen pavarësisht nga shpërndarja e vërtetë e të dhënave. Këto teknika quhen metoda joparametrike ose metoda pa shpërndarje. [1]

I. Efikasiteti i metodave joparametrike

Metodat joparametrike nuk janë më të thjeshta se homologet e tyre, metodat parametrike. Përkundrazi, një kritikë parësore e përdorimit të metodave parametrike në analizat statistikore është se metodat parametrike thjeshtojnë shumë popullsinë ose procesin që po vëzhgohet.

Një metodë parametrike dhe një metodë joparametrike nuk janë konkurrenca të drejtpërdrejta, por përkundrazi plotësuese pasi në shkëmbimin midis metodave parametrike dhe joparametrike, diçka sakrifkohet që diçka të fitohet. Një metodë statistikore quhet joparametrike nëse nuk bën supozime mbi shpërndarjen e popullsisë ose madhësinë e kampionit. Kjo është në kontrast me shumicën e metodave parametrike në statistikat elementare që supozojnë se grupi i të dhënave të përdorura është sasior, popullata ka një shpërndarje normale dhe madhësia e kampionit është mjaft e madhe. Në përgjithësi, përfundimet e nxjerra nga metodat joparametrike nuk janë aq të fuqishme sa ato parametrike. Megjithatë, duke qenë se metodat joparametrike bëjnë më pak supozime, ato janë më fleksibël, më të qëndrueshme dhe më të zbatueshme për të dhënat jo sasiore. [5]

Metodat parametrike janë shpesh ato për të cilat ne e dimë se popullata është normale, ose mund të përafrohet duke përdorur një shpërndarje normale pasi zbatohet teoremi i qendrës limite. Në fund të fundit, klasifikimi i një metode si parametrike varet nga supozimet që bëhen rreth një popullate. Disa metoda parametrike përfshijnë testimin e një hipoteze statistikore rreth mesatares së popullsisë në dy kushte të ndryshme: 1. kur kampionimi është nga një popullatë e shpërndarë normalisht me variancë të njohur, 2. kur kampionimi është nga një popullatë e shpërndarë normalisht me variancë të panjohur. Metodatat joparametrike, megjithatë, nuk bazohen në supozimet themelore dhe kështu

nuk kërkojnë që shpërndarja e një popullate të shënohet me parametra specifike.

Kur nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të përcaktuar formën e shpërndarjes, ose kur të dhënat vijnë nga një shpërndarje për të cilën metodat parametrike nuk janë lehtësisht të disponueshme dhe në situata të tilla studiuesi shpreson të mos bëjë supozime të pabaza, hyjnë në lojë metodat joparametrike. Metodatat joparametrike janë të zbatueshme në situata kur metodatat parametrike nuk zbatohen.

Përdorimi i një procedure joparametrike është i përshtatshëm në situatat e mëposhtme:

- Hipoteza që do të testohet nuk përfshin një parametër të popullatës.
- Për analizën e të dhënave të shprehura në shkallën nominale ose të zakonshme.
- Kur popullimet në shqyrtim nuk kanë shpërndarje normale.
- Kur popullimet nuk kanë varianca të barabarta. (edhe kur të dhënat janë në shkallën intervalore ose në trajtë raporti).[1]

II. Avantazhet e metodave joparametrike

1. Bëhen më pak supozime. Procedurat statistikore joparametrike janë procedura që në përgjithësi nuk kanë nevojë për supozime të ngurta parametrike në lidhje me popullatat nga të cilat janë marrë të dhënat.
2. Kanë shtrirje më e gjerë. Meqenëse ka më pak supozime që bëhen në lidhje me kampionin që po studiohet, metodatat joparametrike zakonisht kanë shtrirje më të gjerë në krahasim me metodatat parametrike që në fakt supozojnë një shpërndarje.
3. Nuk kanë nevojë të përfshijnë parametrat e popullsisë. Testet parametrike përfshijnë shpërndarje specifike probabiliteti (p.sh., shpërndarjen normale) dhe testet përfshijnë vlerësimin e parametrave kyç të asaj shpërndarjeje (p.sh., mesataren ose ndryshimin midis mesatareve) nga

të dhënat e mostrës. Megjithatë, testet joparametrike nuk përfshijnë domosdoshmërisht parametrat e popullatës.

4. Mundësia që ato të përdoren në mënyrë jo të duhur është e vogël. Meqenëse shumica e procedurave joparametrike varen nga një grup minimal supozimesh, mundësia që ato të përdoren në mënyrë jo të duhur është e vogël.
5. Janë të aplikueshme edhe kur të dhënat maten në një shkallë matjeje të dobët. Për të dhënat që maten me shkallë intervalore ose raporti, mund të përdorni një test parametrik në varësi të formës së shpërndarjes. Testi joparametrik mund të kryhet edhe kur punohet me të dhëna që janë nominale ose rendore.
6. Lehtë për t'u kuptuar. Studiuesit me përgatitje minimale në Matematikë dhe Statistikë zakonisht i shohin procedurat joparametrike të lehta për t'u kuptuar.
7. Llogaritjet mund të kryhen shpejt dhe me lehtësi. Testet joparametrike zakonisht mund të kryhen shpejt dhe lehtë pa instrumente të automatizuara (kalkulatorë dhe kompjuterë). Ato janë krijuar për një numër të vogël të dhënash, duke përfshirë numërimin, klasifikimin dhe vlerësimin. [2]

III. Disavantazhet e metodave joparametrike

Procedurat joparametrike nuk janë pa disavantazhe. Më poshtë janë disa nga disavantazhet më të rëndësishme.

1. Studiuesi mund të humbasë informacionin kur procedurat parametrike janë më të përshtatshme për t'u përdorur. Nëse supozimet e metodave parametrike mund të përmbushen, është përgjithësisht më efikase t'i përdorim ato.
2. Për madhësi të mëdha mostrash, manipulimet e të dhënave priren të bëhen më të mundimshme, përveç nëse disponohet softueri kompjuterik. Pra është e vështirë për të bërë llogaritje me dorë për mostra të mëdha.
3. Tabelat nuk janë gjerësisht të disponueshme.

Shpesh për statistikën e testit nevojiten tabela të veçanta të vlerave kritike dhe këto vlera nuk mund të gjenerohen gjithmonë nga softueri kompjuterik. Nga ana tjetër, vlerat kritike për testet parametrike janë lehtësisht të disponueshme dhe përgjithësisht të lehta për t'u përfshirë në programet kompjuterike. [2]

IV. Disa metoda joparametrike

Disa prej metodave joparametrike janë: Testi i shenjave, Testi Wilcoxon i rangjeve me shenjë, Testi i shumës së rangut Wilcoxon, Testi H Kruskal-Wallis, Korrelacioni i rangut

Testi i shenjave është një procedurë mjaft e thjeshtë që mund të përdoret për të krahasuar dy popullata kur mostrat përbëhen nga vëzhgime të çiftuara. Në përgjithësi, për çdo çift, ne njehsojmë nëse preferenca e parë – p.sh A - e tejkalon preferencën e dytë – p.sh B. Statistika e testit x , është numri i herëve që A e tejkalon B në n çiftet e vëzhgimeve. Kur dy shpërndarjet e popullsisë janë identike, probabiliteti që A e tejkalon B është i barabartë me $p=0.5$ dhe x ka një shpërndarje binomiale. Në test përfshihen vetëm çiftet me vlera jo të barabarta. Kur numri i çifteve n është i madh, vlerat kritike për refuzimin e hipotezës zero dhe vlerat e përafërta të p -së mund të gjenden duke përdorur një përafrim normal të shpërndarjes së x . Duke përdorur statistikën e testit $z = \frac{x-np}{\sqrt{npq}}$ ne mund të testojmë hipotezën zero $p = 0.5$ kundrejt hipotezës alternative $p \neq 0.5$

Testi i shenjave ndihmon gjithashtu në evidentimin e preferencave të konsumatorëve midis dy marka të një produkti. Në studimin e tregjeve përdoret një zgjedhje prej n -konsumatorësh potencialë për të identifikuar preferencën për një prej dy markave të një produkti. Shprehjet e preferencave janë të dhëna nominale sepse konsumatori vetëm nominon ose etiketon markën e preferuar. Nga të dhënat e vrojtuar me anë të Kriterit të shenjave mund të tregohet nëse ekziston një ndryshim në preferencat e konsumatorëve e lidhur me dy artikujt që krahasohen. Meqenëse të dhënat janë rregjistruar me shenjat (+) dhe (-), ky test joparametrik quhet testi i shenjave. Procedura statistikore që përdoret në kriteri i shenjave në

rastin e zgjedhjes së vogël është si më poshtë: Në një studim për preferencat e konsumatorëve merren n individë dhe u kërkohet që të vendosin shenjën (+) në qoftë se individ i preferon markën 1 dhe shenjën (-) në qoftë se individ i preferon markën 2. Shënojmë me p përpjesën e popullimit të konsumatorëve që preferojnë markën 1. Hipotezat që duhet të kontrollojmë janë: Hipoteza zero $H_0: p=0.50$ kundrejt hipotezës alternative $H_a: p \neq 0.50$. Numri i shenjave (+), shpërndarja zgjedhore e tyre, me supozimin se hipoteza zero është e vërtetë ($p=0.50$) ka një shpërndarje probabilitare binomiale $B(n;p)$. Hipoteza zero hidhet poshtë kur numri i shenjave (+) të vrojtuar është më i vogël se numri i shenjave (+) të tilla që shuma e probabiliteteve të tyre është më e vogël se vlera kritike $\alpha/2$. (kur testi është i dyanshëm). [6]

Testi Wilcoxon i rangjeve me shenjë

Përdoret tek zgjedhjet e çiftuara ku çdo njësi vrojtimi prodhon dy vrojttime të çiftuara, një nga popullimi i parë dhe një nga popullimi i dytë. Diferencat ndërmjet këtyre vrojttimeve shprehin diferencat midis dy popullimeve. Hipotezat që duhet të kontrollojmë janë: Hipoteza zero H_0 : popullimet janë identike dhe Hipoteza alternative H_a : Popullimet nuk janë identike. Hapat që ndiqen në aplikimin e testit të rangjeve janë si më poshtë:

- Hapi i parë: Renditen vlerat absolute të diferencave ndërmjet dy vrojttimeve të çiftuara. (heqim çdo diferencë të barabartë me zero dhe diferencat absolute të mbetura renditen nga më e vogla tek më e madhja). Diferencave të barabarta u japim rangje sa mesatarja e pozicioneve të tyre në bashkësinë e të dhënave të kombinuara.
- Hapi i dytë: Pasi përcaktohen rangjet e diferencave absolute, rangjeve u jepen shenjat origjinale të të dhënave. Në qoftë se dy popullimet do të ishin identike rangjet pozitive dhe rangjet negative eliminojnë njëri-tjetrin. (shuma e rangjeve do të jetë zero)
- Hapi i tretë: Shënojmë me T shumën e vlerave të rangjeve me shenjë. Në qoftë

se dy popullimet janë identike dhe numri i cifteve të të dhënave është 10 ose më shumë, mund të tregohet se shpërndarja e T-së është afërsisht normale me parametra: $\mu_T = 0$ dhe

$$\sigma_T = \sqrt{\frac{n(n+1)(2n+1)}{6}}$$

- Hapi i katërt: Llogarisim statistikën e testit: $z_v = \frac{T - \mu_T}{\sigma_T}$
- Hapi i pestë: Në varësi të vlerës së statistikës së testit vlerësojmë nëse hipoteza zero pranohet ose nuk mund të hidhet poshtë. Nëse $-z_{kr} < z_v < z_{kr}$ hipoteza zero nuk mund të hidhet poshtë. Nëse $z_v > z_{kr}$ ose $z_v < -z_{kr}$ arrijmë në përfundimin se popullimet nuk janë identike.

Në krahasimin e mesatareve të dy popullatave bazuar në mostra të pavarura, statistika kryesore është diferenca midis mesatareve të mostrave duke përdorur testin parametrik t-test. Kur nuk jemi të sigurt se supozimet e kërkuara për një t-test me dy mostra plotësohen, një alternativë është të përdorim dy teste të ndryshme joparametrike Testi i shumës së rangut Wilcoxon ose Mann-Whitney U-test. Testi Mann-Whitney-Wilcoxon përdoret për të përcaktuar nëse ka një ndryshim midis dy popullimeve. Ky test nuk bazohet në zgjedhje të çiftuara por bazohet në dy zgjedhje të pavarura, një nga secili popullim. Tek ky test mjafton që të dhënat të jenë rreshtore (shkalla e zakonshme). [4]

Testi i shumës së rangut Wilcoxon: Mostra të rastit të pavarura

Procedura që do të paraqesim është testi i shumës së rangut Wilcoxon, i propozuar nga Frank Wilcoxon, i cili bazohet në shumën e rangut të kampionit që ka madhësinë më të vogël të kampionit. Supozojmë se kemi n_1 vëzhgime nga popullsia 1 dhe n_2 vëzhgime nga popullsia 2. Hipoteza zero që do të testohet është se dy shpërndarjet e popullsisë janë identike kundrejt hipotezës alternative që shpërndarjet e popullsisë janë të ndryshme. Nëse Hipoteza zero është e vërtetë dhe vëzhgimet janë marrë nga e njëjta popullatë ose popullata identike, atëherë

vëzhgimet nga të dy mostrat duhet të përzihen rastësisht dhe të renditen së bashku nga e vogla tek më e madhja. Shuma e rangjeve të vëzhgimeve nga kampioni 1 duhet të jetë e njëjtë me shumën e rangjeve nga kampioni 2.

Nëse, nga ana tjetër, vëzhgimet nga popullsia 1 priren të jenë më të vogla se ato nga popullsia 2, atëherë këto vëzhgime do të kishin renditjen më të vogël sepse shumica e këtyre vëzhgimeve do të ishin më të vogla se ato nga popullsia 2. Shuma e rangjeve të këto vëzhgime do të ishte e vogël. Nëse vëzhgimet nga popullsia 1 priren të jenë më të mëdha se ato në popullsinë 2, këtyre vëzhgimeve do t'u caktoheshin renditje më të mëdha. Shuma e rangjeve të këtyre vëzhgimeve do të prirej të ishte "e madhe".

Procedura: Rendisim dy mostrat. Përcaktojmë kampionin më të vogël si mostrën 1. Shënojmë me $T_1 = \text{shuma e rangjeve të mostrës 1}$ dhe $T_1^* = n_1(n_1 + n_2 + 1) - T_1$

Përdorim T_1 për të testuar nëse popullata 1 është në të majtë të popullatës 2 ose përdorim T_1^* për të testuar nëse popullata 1 është në të djathtë të popullatës 2. Përdorim vlerën më të vogël midis T_1 dhe T_1^* për të testuar ndryshimin në vendndodhjen midis të dy popullatave. Në tabelat e statistikës gjejmë vlerën kritike për refuzimin ose jo të hipotezes zero. Kur madhësitë e mostrës janë të mëdha, përdorim përafrimin normal për shpërndarjen T me mesatare $\mu_T = \frac{n_1(n_1+n_2+1)}{2}$ dhe variancë $\sigma_T^2 = \frac{n_1n_2(n_1+n_2+1)}{12}$. Shpërndarja $z = \frac{T - \mu_T}{\sigma_T}$ është afërsisht normale me mesatare 0 dhe devijim standard 1 për vlerat n_1 dhe n_2 .

Testi H Kruskal-Wallis: Zgjedhje plotësisht të rastësishme

Ashtu si testi i shumës së rangjeve Wilcoxon është alternativa joparametrike ndaj testit t të Studentit për një krahasim të mesatareve të popullsisë, testi H Kruskal-Wallis është alternativa joparametrike për analizën e variancës, testin F të Fisherit për një zgjedhje krejtësisht të rastësishme. Testi H Kruskal-Wallis është një alternativë e vlefshme për një analizë të variancës kur shkelen supozimet e normalitetit dhe barazisë së variancës. Përdoret

për të zbuluar dallimet në vendndodhje midis më shumë se dy shpërndarjeve të popullsisë, bazuar në zgjedhje të pavarura të rastësishme. Procedura për kryerjen e testit H Kruskal-Wallis është e ngjashme me atë të përdorur për testin e shumë sërë rangut Wilcoxon. Supozojmë se po krahasojmë k popullata bazuar në mostrat e rastësishme të pavarura n_1 nga popullata 1, n_2 nga popullata 2, ..., n_k nga popullsia k, ku $n_1 + n_2 + \dots + n_k = n$. Hapi i parë është renditja e n vëzhgimeve nga më i vogli (rangu1) tek më i madhi (rangu n). Vëzhgimeve të barabarta u caktohet një rang i barabartë me mesataren e rangjeve. Pra rendisim bashkërisht n vëzhgimet e k mostrave. Llogarisim shumën e rangjeve për secilën mostër, ku T_i është shuma e rangjeve e kampionit i dhe njehsojmë statistiken e testit

$$H = \frac{12}{n(n+1)} \sum \frac{T_i^2}{n_i} - 3(n+1).$$

Sa më të mëdha të jenë dallimet në vendndodhje midis k shpërndarjeve të popullsisë, aq më e madhe është vlera e statistikës H. Kështu, ne mund të refuzojmë hipotezën zero : "k shpërndarjet e popullsisë janë identike" për vlera të mëdha të H-së. Kur hipoteza zero është e vërtetë, statistika H do të ketë afërsisht një shpërndarje hi-katrore me $(k - 1)$ shkallë lirie. Prandaj, për një vlerë të dhënë të gabimit α , mund të refuzojmë hipotezën zero kur statistika H tejkalon vlerën χ^2_{α} .

Koeficienti i korrelacionit të rangut Spearman mund të përdoret si një statistikë testuese për të testuar hipotezën e mungesës së lidhjes midis dy popullatave. Supozojmë se n çiftet e vëzhgimeve (x_i, y_i) janë zgjedhur rastësisht. Rendisim përgjigjet për dy variablat nga më i vogli tek më i madhi. Llogarisim koeficientin e korrelacionit për vëzhgimet e renditura. $r_s = 1 - \frac{6 \sum d_i^2}{n(n^2-1)}$ ku $d_i = x_i - y_i$ është diferenca midis rangut të elementit të i-të në variablin e parë dhe rangut të elementit të i-të në variablin e dytë. Gjejmë vlerat kritike për korrelacionet e renditjes në tabelat e statistikës. Nëse hipoteza alternative është se korrelacioni midis dy variablave x dhe y është negativ, ne do të refuzojmë hipotezën zero për vlerat negative të koeficientit r_s që janë afër -1. Në mënyrë të ngjashme, nëse hipoteza alternative është se korrelacioni midis variablave x dhe y është

pozitiv, ne do të refuzojmë hipotezën zero për vlera të mëdha pozitive të r_s . Koeficienti i korrelacionit të rangut nuk zbulon vetëm korrelacion linear domethënës por edhe ndonjë marrëdhënie tjetër midis dy variablave. Nëse koeficienti i korrelacionit të rangut është afër zeros lidhja midis variablave është e dobët.[3]

Konkluzione

Testet joparametrike të paraqitura në këtë artikull janë vetëm disa nga shumë teste joparametrike të disponueshme për eksperimentuesit. Testet e paraqitura këtu janë ato për të cilat tabelat e vlerave kritike janë lehtësisht të disponueshme. Metodatat statistikore joparametrike janë veçanërisht të dobishme kur vëzhgimet mund të renditen, por nuk mund të vendosen saktësisht në një shkallë matjeje. Gjithashtu, metodatat joparametrike janë metodatat e vetme që mund të përdoren kur perzgjedhja e kampionit është respektuar saktë, por të dhënat nuk janë ose nuk mund të supozohet se ndjekin një ose më shumë supozime të shpërndarjes. Ne kemi paraqitur disa teknika joparametrike që mund të përdoren kur të dhënat nuk shpërndahen normalisht ose kur supozimet e tjera të kërkuara nuk plotësohen. Këto dhe shumë procedura të tjera joparametrike janë të disponueshme si alternativa ndaj testeve parametrike.

BIBLIOGRAFI:

1. William Mendenhall, Robert J. Beaver, Barbara M. Beaver. Introduction to Probability and Statistics,
2. C. A. HESSE, J. B. OFOSU, and E. N. NORTEY. Introduction to Nonparametric Statistical Methods
3. I P Sprent, N.C. Smeeton. Applied nonparametric statistical methods.-3rd ed.
4. John E. Kolassa, *An Introduction to Nonparametric Statistics*.
5. J. David J. Sheskin. Parametric and Nonparametric Statistical Procedures Second Edition.
6. Hollander and Wolfe. Nonparametric Statistical Methods.

Vlerësimi i trafikut me nivelet e shërbimit dhe nevoja për Transport të qëndrueshëm në qytetin e Vlorës

Dr. Ing. Pëllumb Cacaj

Fakulteti i Shkencave dhe Natyres

Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare

Universiteti i Vlorës "I. Qemali",

pellumb.cacaj@univlora.edu.al

pellumb_cacaj@yahoo.it

Abstrakt

Zhvillimi i shpejt i transportit dhe rritja shumë e madhe e numrit të mjeteve rrugore ka sjellë nevojën për studime inxhinierike në vlerësimin e flukseve të trafikut si në organizimin dhe menaxhimin e tij. Qyteti i Vlorës është shembulli i një qyteti me trafik të rënduar dhe kjo vërehet sidomos në sezonin turistik. Edhe në ditë të zakonshme flukset e trafikut janë të rënuara në orare piku të mëngjesit, drekës dhe të darkës. Ky studim kërkon të jap një metodike për matjen dhe vlerësimin e flukseve të trafikut si dhe të sugjerojë ndërhyrjet e mundëshme për të lehtësuar këtë trafik. Ky studim do të vlejë jo vetëm për qytetin e Vlorës, por edhe si një shembull për qytete të tjera. Ndërhyrjet në infrastrukturë rrugore duke ndërtuar akse të reja dhe menaxhimi më i mirë i hapsires urbane janë të nevojshme për një transport sa më të qëndrueshëm për të ardhmen. Mundësitë me të tashmen duhet të synojnë një organizim dhe menaxhim më të mirë të trafikut.

Fjalë kyç: trafik, nivel, shërbim, rrugë, Vlorë

Abstrakt

The rapid development of transport and the very large increase in the number of road vehicles has brought the need for engineering studies in estimating traffic flows in both its organization and management. The city of Vlorë is an example of a city with heavy traffic and this is especially noticeable in the tourist season. Even on ordinary days traffic flows are heavy at peak hours of morning, lunch and dinner. This study seeks to provide a methodology for measuring and estimating traffic flows as well as to suggest possible interventions to facilitate this traffic. This study will be valid not only for the city of Vlorë, but also as an example for other cities. Interventions in road infrastructure by building new axes and better management of urban space are necessary for a more sustainable transport for the future. Opportunities with the present should aim at a better organization and management of traffic.

Keywords: traffic, level, service, road, Vlorë

Hyrje

Qyteti i Vlorës është një nga qytetet më të mëdha dhe më të rëndësishme të Shqipërisë dhe konsiderohet një qytet me potencial të lartë zhvillimi. Dekadat e fundit ka njohur një zhvillim të fuqishëm demografik, social dhe ekonomik.

Vlora ka portin e dytë tregtar më të madh në vend si dhe disa porte më të vegjël. Këto porte kanë një ndikim të madh në zhvillimin e qytetit dhe transportit të mallrave dhe të pasagjerëve. Volumet e mallrave dhe pasagjerëve nga viti në vit kanë ardhur duke u rritur dhe tendenca është që rritja të vazhdoi edhe për vitet në vazhdim².

Vlora ka njohur një rritje të madhe në fushën e turizmit. Gjatë periudhës së verës, qyteti ndeshet me një rritje të madhe të numurit të turistëve dhe të pushuesve. Numuri i tyre vazhdon që të rritet dhe bashkë me ta edhe trafiku i mjeteve. Parashikimet janë që qyteti i Vlorës industrinë e turizmit ta ketë degën kryesore të ekonomisë për vitet që vijnë.

Popullsia e qytetit të Vlorës për vitin 2013 është 13150047 dhe për vitin 2030 parashikohet të arrijë në 153.850 banorë¹¹. Kjo rritje e popullsisë i atribuohet kryesisht banorëve të ardhur nga zonat rurale dhe nga qytete të tjera. Vlora ka dendësi relativisht të lartë, duke e krahasuar me dendësinë e qyteteve të Evropës me të njëjtat përmasa, në të cilët dendësia zakonisht varion nga 40 deri në 60 persona për hektare, nga 84 persona/ha për Vlorën⁹. Kjo do të shoqërohet edhe me një rritje të numërit të mjeteve.

Fillimet modern të zhvillimit të transportit dhe të infrastrukturës datojnë me krijimin e shtetit shqiptar në nëntor 1912. Me krijimin e qeverisë së parë shqiptare, pas shpalljes së pavarësisë, u krijua edhe Zyra Herrtare, e cila në fillim mbulonte me shërbime të transportit prapavijën e ushtrisë së sapo krijuar. Kjo zyrë pati një farë zhvillimi sidomos nën qeverinë e Princ Vedit¹⁰.

Infrastruktura rrugore, ashtu si në të gjithë Shqipërinë, u bazua në rrugët e ndërtuara nga italianët duke i përmirësuar ato si dhe duke

ndërtuar edhe rrugë të reja. Megjithatë, gjatësia e rrugëve të shtruara ishte e kufizuar dhe ishin kryesisht me një dhe dy korsi, larg standarteve europiane. Infrastruktura në qytetin e Vlorës paraqitej relativisht e mirë duke pasur parasysh kohën, zhvillimin e qytetit, mjetet që përdorshin dhe numërin e kufizuar të tyre.

Mbas vitit 1990, me ndryshimin e sistemit politik dhe ekonomik, me lejimin e lëvizjes së lirë të qytetarëve, qyteti i Vlorës u përball me një rritje shumë të madhe të numërit të mjeteve, të sjella nga emigrantët, kryesisht nga Italia. Këto mjete ishin të përdorura dhe me kapacitete të llojeve të ndryshme, në të cilët pjesa më e madhe ishin vetura¹³.

Infrastruktura rrugore shumë shpejt filloi të dëmtohet dhe të dalë jashtë kushteve teknike për shkak të fluksit të rritur të mjeteve dhe për shkak të kapaciteteve më të mëdha të mjeteve nga ato që ishin projektuar rrugët. Investimet për mirëmbajtjen ishin fare modeste në krahasim me nevojat.

Mbas vitit 2000, në qytetin e Vlorës, filluan të duken shenjat e para të ndërhyrjes mbi infrastrukturën rrugore nga pushteti lokal, që me ndihmën edhe të investimeve të huaja, u ndërhy në zona në të cilat infrastruktura ishte shkatërruar pothuajse fare¹¹.

Zvillimi i sektorit turistik sjell në qytetin e Vlorës shumë pushues, dhe bashkë me ta, edhe një rritje shumë të madhe të numërit të mjeteve. Kjo shkakton një trafik, i cili në zona të caktuara të qytetit, sjell edhe bllokime të tij. Qyteti i Vlorës, edhe pas vitit 2010, vazhdon të ketë po të njëjtat probleme.

Numëri i mjeteve vazhdon të rritet. Situata e trafikut sa vjen dhe rëndohet dhe ka nevojë për ndërhyrje të studiuara dhe të argumentuara. Gjatë kryerjes së studimit, rrjeti rrugor që u mor në shqyrtim, ka një gjatësi totale prej 36.4 km, e cila përbëhet nga kategori të ndryshme të rrugëve. Numri i mjeteve të qarkut të Vlorës është 45874 mjete dhe vetëm qyteti i Vlorës ka 36622 mjete⁵.

I gjithë ky zhvillim social-ekonomik i shoqëruar me një nevojë të madhe për zhvillimin e transportit, duhet të paraprihet nga studimet inxhinierike, duke u mbështetur në metoda shkencore, në mënyrë që të paraprihen skenarët e ndryshëm të zhvillimi të qytetit.

Këto studime mungojnë dhe zhvillimi infrastrukturës rrugore dhe orgavizimi i trafikut është zhvilluar në mënyrë rastësore. Për qytetin e Vlorës është bërë një studim i trafikut dhe i lëvizjes së mjeteve, në vitin 2001, në bashkëpunim me Institutin e Transportit, Tiranë.

Ky studim nuk mbështetet mbi ndonjë metodikë inxhinierike dhe shkencore, por mjaftohet me dhënien e drejtimeve të lëvizjes mbi çdo aks rrugor. Ai nuk bën parashikime për prespektivën dhe nuk jep zgjidhje të mundëshme të rritjes së trafikut.

Gjatë kryerjes së studimit, rrjeti rrugor që u mor në shqyrtim, ka një gjatësi totale prej 36.4 km, e cila përbëhet nga kategori të ndryshme të rrugëve. Numri i mjeteve të qarkut të Vlorës është 45874 mjete dhe vetëm qyteti i Vlorës ka 36622 mjete³.

Në studimin tonë do të bëjmë krahasimin e shfrytëzimit të infrastrukturës rrugore duke bërë vlerësimin e kapaciteteve rrugore, nëpërmjet niveleve të shërmimit të rrugëve. Studimi do të mbështetet në një model inxhinierik të llogaritjes së flukseve të trafikut mbi akse të ndryshme rrugor. Flukset e llogaritura, do të krahasohen me kapacitete e flukseve maksimale të këtyre akseve duke bërë raportin e fluksit real me atë maksimal. Në këtë mënyrë ne mund të shikojmë sa janë kapacitete rezerve për shfrytëzimin e këtyre rrugëve. Ne do të shikojmë aksin kryesor dhe me të rëndësishëm të qytetit të Vlorës, Bulevardin "Ismail Qemali" për të verifikuar kapacitete të tij dhe për të vlerësuar segmentet me të ngarkuar.

Materiali dhe metodat

Modelimi i transportit në qytetin e Vlorës bazohet në modelin klasik të transportit. Ky model jep rezultate të mira dhe vazhdon të përdoret

pavarësisht përmirësimit dhe zhvillimit të teknikave të modelimit. Gjatë modelimit të sistemit të transportit është e vështirë të përcaktohen të gjitha mardhëniet midis faktorit njëri dhe sistemit të transportit, por egzistojnë softwear, siç është Transcad-i, të cilët arrijnë të bëjnë një qasje të mirë teorike me realitetin duke përdorur funksione në analogji me ligjet e fizikës¹. Të dhënat e mbledhura duhet të jenë të lidhura ngushtë me modelin.

Modeli duhet të ndërtohet me një strukturë sa më të thjeshtë¹.

Modelimi është një paraqitje e thjeshtuar e realitetit. Thjeshtimi fillon me përcaktimin e zonave, sistemit rrugor dhe kodifikimin e një zonë urbane, mbledhjen e të dhënave, kalibrimin dhe vlerësimin e tyre.

Të dhënat e mbledhura do të përdoren për të vlerësuar numërin total të udhëtimeve të gjeneruara dhe të tërhequra prej secilës zonë⁴.




Fig. Error! No text of specified style in document.-1 Paraqitje grafike e modelit klasik të modelimit të transportit

Hapsira gjeografike do të modelohet në formën e një grafi. Me graf mund të përkufizojmë rrugën ose itinerarin, në të cilën nyja e fundit e çdo harku

përkon me nyjen e fillimit të harkut të radhës. Një rrugë është unazë në qoftë se nyja e fundit të rrugës përkohet me nyjen fillestare. Një rrugë quhet elementare ose pa qark, nëse në asnjë pjesë të tij nuk formon një unazë⁶. Grafët e përdorur për të paraqitur sistemet e transportit në përgjithësi nuk janë të plotë. Një graf quhet i lidhur në qoftë se çdo nyjë është origjinë e të paktën një rruge që ka ekstrem çdo nyje tjetër të grafit.

Për të thjeshtuar modelimin e sistemit është e nevojshme të ndahet hapsira e studimit në zona të trafikut. Zonat mund të ndërtohen në shkallë rajonale, kombëtare deri në disa blloqe të qytetit. Qëllimi i zonimit është që të përafroj të gjitha pikat e fillim dhe të përfundimit të spostimeve ndërzonale në një pikë të vetme (centroida e zonës).

Një numër i madh i zonave zakonisht çon në një paraqitje më të saktë të fenomenit real, por është një barrë më e madhe për skematizimin dhe simulimi e sistemit të transportit.

Ambjenti i jashtëm i hapsirës së studimit, zakonisht ndahet në zona më të mëdha sesa hapsira e brendshme.

Një sistem i ndarë në zona përdoret si bazë për të bërë modelimin. Sa më i madh numëri i zonave, aq më e vështirë është për t'u mbuluar hapsira e studimit.

Për studimin tonë hapsira e studimit do të jetë qyteti i Vlorës. Hapsira e studimit nuk përcaktohet nga kufijtë politikë por nga interesi në çfarë hapsire do të shtrihet studimi. Hapsira e studimit do të përfshijë zonat brenda hapsirës, të cilat do të përputhen më lagjet e qytetit. Gjithësej rezultojnë të jenë 20 zona studimi të brendshme⁴.

Në paraqitjet kompjuterike të modeleve zonat paraqiten si një pikë e vetme në të cilën janë përqëndruar të gjitha atributet, e cila quhet centroida e zonës. Centroidat bashkohen me rrjetin nëpërmjet konektorëve të centroidave nëpërmjet të cileve paraqiten koha, distanca, kostoja, duke lidhur sistemin e transportit me

udhëtimet nga origjina në destinacion për në secilën zonë¹⁴.

Për të realizuar studimin tonë është e nevojshme të mblidhen të dhëna nga institucione të ndryshme të qytetit të Vlorës.




1. Është e nevojshme që përveç zonave të brendshme të hapsirës së studimit të përcaktohen edhe zonat e jashtëme të studimit. Kemi konstatuar për studimin tonë që janë të nevojshme të veçojmë 5 zona të jashtëme, të cilat janë:
2. Veriu, në të cilën përfaqsojmë të gjithë flukset që vijnë nëpërmjet autostradës në qytetin e Vlorës.
3. Jugu, në cilën përfaqësohen flukset e trafikut që kalojnë nga pjesa jugore, nëpërmjet rrugës së Orikut
4. Labëria, në cilën përfaqësohen flukset e trafikut që kalojnë nga zona e Lumit të Vlorës dhe zonës së Selenicës
5. Myzeqeja, në cilën përfaqësohen flukset e trafikut që kalojnë nga zona e Myzeqesë
6. Porti dhe Tri Porti, janë flukset e trafikut që kalojnë nëpërmjet Portit detar dhe Triportit

Këto të dhëna mund të merren sipas nevojës për periudha vjetore ose disa vjeçare. Kështu, kemi marrë të dhënat për numurin e popullsisë së zonave të studimit, numëri i bizneseve për çdo zonë, numëri i mjeteve, ndarje administrative e zonave (lagjeve) dhe matjet e flukseve të trafikut në nyje të ndryshme të rrjetit rrugor.

Mbi bazën e këtyre të dhënave, kemi bërë modelimin me softwearin TransCAD, i cili kalon në katër faza modelimi, faza e fundit e të cilit është ngarkimi i flukseve të trafikut mbi rrjetin rrugor.

Duke modeluar të dhënat e mbledhura më lart dhe duke ngarkuar mbi grafin e sitemit rrugor vlerat e gjetura të flukseve, do të kemi paraqitjen grafike të mëposhtme:

Duke mbi çdo segment rrugor, ne mund të llogarisim nivelet e shërbimit ditur, vlerën e flukseve të këtyre rrugëve. Koncepti i niveli të shërbimit të rrugëve përdoret për të përkufizuar cilësinë dhe lehtësinë e lëvizjes në kushte të ndryshme të trafikut.



FigError! No text of specified style in document.-2 Paraqitje rrugëve kryesore së bashku me centroidat dhe e mbivendosur mbi hartën e zonave.

Fig Error! No text of specified style in document.-3 Paraqitja grafike e flukseve të trafikut mbi rrjetin rrugor të qytetit të Vlorës për vitin 2013 dhe 2030

Niveli i shërbimit, ose i shënuar ndryshe me LOS, është një masë cilësore e cila përshkruan kushtet e operimit në një rrymë trafiku, përgjithësisht në termat e masave të shërbimit siç janë shpejtësia dhe koha e udhëtimit, liria e lëvizjes, ndërprerja e trafikut, konforti dhe kursimi⁸.

Termtat e nivelit të shërbimit janë të lidhur ngushtësisht me kapacitetin. Kapaciteti jep një vlerë sasiore të trafikut ndërsa niveli i shërbimit na paraqet një masë cilësore të trafikut³⁸.

Niveli i shërbimit mat cilësinë e kushteve të operimit në një system trafiku dhe mënyrën sesi këto kushte janë perceptuar nga drejtuesit e mjeteve dhe pasagjerët. Ajo lidhet me karakteristikat fizike të rrugëve dhe me karakteristikat e operimit, të cilat varen nga karakteristikat e ndryshme të volumeve të trafikut. Shpejtësi-fluks-dendësi trafiku janë një mardhënie e rëndësishme e cila ndikon në nivelin e shërbimit në kushte ideale të lëvizjes⁷.

Për një rrugë të dhënë, kapaciteti i saj është kostant. Fluksi aktual mund të ndryshojë nga dita në ditë dhe në orare të ndryshëm të së njëjtës ditë. Qëllimi i nivelit të shërbimit është të lidhë cilësinë e shërbimit të trafikut mbi një fluks rrjeti rrugor të dhënë. Ky është një term i cili tregon rrezën e kushteve të operimit për kushte të caktuara.

Niveli i shërbimit LOS ndahet në gjashtë nivele. Niveli A përfaqëson kushtet më të mira të trafikut në të cilin drejtuesit kanë të gjithë lirinë të lëvizin me shpejtësinë që dëshirojnë në fluks të lirë, dhe niveli F përfaqëson cilësinë e kushteve më të këqija të trafikut⁸.

Kapaciteti i një rrugë me dy korsi në kushtet bazë është 3200 mjete në orë, për të dy drejtimet, me kapacitet maksimal 1700 mjete në orë në një drejtim⁷.

Niveli i shërbimit për një rrugë me dy korsi llogaritet duke u mbështetur në dy madhësi efektive⁷, shpejtësia mesatare e udhëtimit dhe përqindja e kohës së harxhuar për të kaluar rrugën.

Shpejtësia mesatare e udhëtimit është mesatarja e shpejtësisë së të gjithë mjeteve që udhëtojnë në atë rrugë të marrë në analizë, për një periudhë specifike të kohës, e cila zakonisht është 15 minuta të orës së pikut. Shpejtësia mesatare e udhëtimit përfshin të gjithë mjetet që kalojnë atë segment rrugor në të dy drejtimet⁷.

Niveli i shërbimit të rrugëve të qytetit të Vlorës do të përcaktohet duke u mbështetur mbi aspektet teorike të treguara më sipër si dhe mbi llogaritjet e flukseve të trafikut të realizuar me modelin klasik të transportit dhe duke përdorur softwearin TransCAD.

Karakteristikat dhe mundësitë për të ndërhyrë mbi sistemin rrugor të qytetit të Vlorës janë të kufizuara. Faktorët kryesor që do të ndikojnë në përcaktimin e nivelit të shërbimit, do të jenë shpejtësia e lëvizjes, kapaciteti i tyre dhe gjendja fizike e rrugëve.

Rrugët janë kryesisht me dy drejtime të lëvizjes dhe shumica e tyre kanë vetëm dy korsi të lëvizjes¹¹.

Numëri i mjeteve sa vjen dhe shtohet, ndërsa rrugët kanë ngel po ato, duke rënduar trafikun dhe lëvizjen e mjeteve. Kjo situatë rëndohet më tej gjatë sezonit të verës, kur numëri i mjeteve rritet për shkak të ardhjes së mjeteve të turistëve të ndryshëm vëndas dhe të huaj.

Shpejtësia maksimale e lëvizjes së mjeteve në një zonë urbane, bazuar në "Kodin Rrugor" të Republikës së Shqipërisë, është 40 km/orë. Në këtë mënyrë, fluksi i mjeteve mund të lëvizë më këtë shpejtësi ose me shpejtësi më të vogël se kjo.

Niveli i shërbimit të rrugëve të qytetit të Vlorës është realizuar me anën e softwear-it TransCAD. Studimi i mëparshëm është realizuar në vitin 2013 dhe janë bërë edhe parashikimet për vitin

2030, duke u mbështetur mbi të njëjtin sistem rrugor.

Aktualisht sistemi rrugor ka pësuar ndryshime. Këto ndryshime në disa raste kanë ulur kapacitetet e rrugëve duke i kthyer nga karrexhat me katër korsi në karrexhata me dy korsi. Më poshtë do të bëjmë krahasimet e niveleve të shërbimit për situatën aktuale, me vlerat që jep google trafik, për të gjykuar mbi kapacitete dhe lirshmërinë e trafikut. Për çdo nivel të shërbimit përdoret një ngjyrë ku me jeshile janë shënuar rrugët me nivelin A (trafik është i lirë dhe pa pengesa) dhe me të kuqe janë shënuar rrugët me nivelin e shërbimit F (trafik është thuajse i bllokuar dhe lirshmëria e lëvizjes është minimale).

Nivelet e shërbimit të paraqitur mbi google map janë mbështetur mbi të njëjtën teori dhe model inxhinierik⁸. Ndryshimi i flukseve që paraqiten është dinamik dhe ne jemi munduar të paraqesim grafiket e trafikut për orarë të ndryshme duke përfshirë oraret e pikut, sic është ora 13, orar në të cilin shumica e nxënësve shkojnë në shtëpi apo orën 8 kur njerzit shkojnë në punë dhe fëmijet në shkollë.

Për rastin e qytetit të Vlorës, për përcaktimin e kapacitetit të rrugëve do të mbështetemi tek kjo tabelë, e paraqitur mëposhtë, dhe do të zgjedhim kapacitetin e rrugëve sipas kategorive¹¹.

Nr	Kategori a e	Dëndësia e lëvizjes në të dy drejtimet si
1	Autostra	Më shumë se 12001
2	I	Nga 5 001 deri në 12 000
3	II	Nga 2501 deri 5 000
4	III	Nga 1 251 deri ne 2 500
5	IV	Nga 350 deri ne 1 250

Tab. Error! No text of specified style in document.-1 Treguesit e dendësisë së lëvizjes në autostrada dhe rrugë të kategorive të ndryshme

Nivelet e shërbimit, siç edhe e shpeguam më lartë, tregon në mënyrë sasiore dhe cilësore kushtet e lëvizjes. Raporti fluks/kapacitet që del përcakton

edhe nivelin e shërbimit të rrugës. Këto raporte do të paraqiten në tabelën e mëposhteme¹²:

Niveli i shërbimit	Shpejtësia e fluksit	Raporti fluks/kapacitet
A	96	0.20
B	80	0.45
C	64	0.70
D	56	0.85
E	48	1.00
F	I nastabilizuar	Mbi 1

Tabela me koeficientët e përcaktimit të gjashtë niveleve të shërbimit

Duke përdorur këto llogaritje dhe këto ndarje të niveleve të shërbimit të rrugëve, nëpërmjet softwear-in TransCAD, për vitet 2013 dhe atë 2030, mund të bëjmë paraqitjet grafike të mëposhteme.

Nga sa shikohet, në vitin 2013, niveli i shërbimit të rrugëve të qytetit të Vlorës, paraqet një situatë jo shumë shqetësuese, duke patur parasysh kapacitetet e rrugëve. Ato, pothuajse të gjitha janë të lira dhe asnjëra prej tyre nuk ka arritur nivelin F. Ato kanë nivel të shërbimit të niveleve A, B,C dhe disa të nivelit D dhe ndonjë të nivelit E.

Kjo situatë na tregon, që në disa rrugë kryesore trafiku gradualisht po rritet dhe shumë shpejt do të arrijë nivelin F, pra volumi i trafikut do të arrijë dhe do të kalojë kapacitetin e rrugës.

Nisur nga kjo situatë, autoritetet vendore duhet të fillojnë të shpallin prioritetet në investimet që duhet të planifikonë për të ardhmen.

Për vitin 2030, nga vërtetimi i grafikut të nivelit të shërbimit, mund të themi që situata do të jetë shumë e vështirë për qarkullimin e mjeteve nëse nuk ndërhyhet dhe gjendja dhe akset rrugore ngelen po ato. Ne mund të shohim që në shumicën e rrugëve volumi i trafikut do të kapërcejë kapacitetin e rrugës, madje në disa prej tyre, në disa herë.

Infrastruktura rrugore, gjatë këtyre viteve ka pësuar ndryshime, të cilat kanë qënë në drejtimin e kundërt me atë që duhet të bëhet. Kështu, Bulevardi kryesor nga katër korsi lëvizje, tashmë është me dy korsi lëvizje, pra është kthyer në një rrugë me kapacitet të përgjysmuar.





Fig. Paraqitja grafike e nivele të shërbimit të rrugëve të qytetit të Vlorës për vitin 2013 dhe për vitin 2030

Gjithashtu, shëtitorja përgjatë detit është kthyer në dy rrugë me nga një sens lëvizje, duke ulur kapacitetin e rrugës. Edhe dy rrugët që shërbejnë si një unazë për qytetin, rrugët “Zenel Murra” dhe “Sazani”, vetëm janë rikonstruktuar dhe nuk ju është rritur kapaciteti. Ndërkohë që rrugët e tjera nuk kanë ndryshuar referuar kapaciteteve.

Për vlerësimin e trafikut aktual do të referohemi google map trafic, e cila ka një saktësi mbi 95%. Google map trafic bazohet mbi të njëjtin model inxhinierik, mbi teorine e grafeve, ashtu si transcadi. Duke ju referuar trafikut të mjeteve dhe nivelit të shërbimit të paraqitura në google trafic¹³ të qytetit të Vlorës në orare të ndryshme do të kemi:








Fig. Paraqitja grafike e nivele të shërbimit të rrugëve të qytetit për vitin 2022 marre nga google trafic

Nga sa shikojmë në paraqitjet grafike e niveleve të shërbimit, vëmë re që situata e trafikut në orare të ndryshme është kushtëzuar nga ndërhyrjet që janë bërë në infrastrukturën kryesore. Nëse në studimin e mëparshëm ne kishim parashikuar që kapacitetet e rrugëve do të plotësoheshin në vitin 2030, vërejmë që në bulevardin e qytetit ky kapacitet është i plotësuar. Siç shikohet në paraqitjet grafike të marra në orare të ndryshme nga google map trafic, niveli i shërbimit tregohet me ngjyrë të kuqe, që do të thotë që kapaciteti është plotësuar dhe lëvizja e mjeteve është e ngadaltë dhe me ndalesa, që i referohet nivelit të shërbimit E dhe F.

Përfundime

Nga llogaritjet që bëmë më lartë mund të themi që në rrjetin rrugor të qytetit të Vlorës janë të nevojshme të realizohen ndërhyrje të fuqishme në infrastrukturën rrugore dhe në aspektin e organizimit të saj.

Ndryshimet e realizuara gjatë këtyre viteve nuk kanë shkuar në drejtimin e duhur, pra duke rritur kapacitetin e rrugëve, por duke ulur kapacitetin e tyre. Kjo ka sjellë që bulevardi i qytetit të jetë pothuaj gjithë ditën me trafik të rënduar dhe me bllokime të shumta. Situara që kemi parashikuar për vitin 2030, për shkak të këtyre ndryshimeve, janë akuale. Trafiku ka arritur vlera shumë të mëdha në raport me kapacitetin e rrugëve.

Përmirësimi i situatës, në një kohë që numri i mjeteve sa vjen dhe shtohet, duhet të mbështetet në organizimin dhe menaxhimin më të mirë të trafikut. Gjithashtu, duhet të ketë një menaxhim më të mirë të tererritorit duke mos rritur më dëndësinë e popullsisë në zonat me trafik të rënduar dhe duke ndërtuar vetëm në zonat ku niveli i shërbimit e lejon.

Është detyrë e autoriteteve lokale, si pronare të infrastrukturës rrugore dhe menaxhuese dhe organizuese e trafikut të qytetit të Vlorës, për të zgjidhur këto probleme që analizuam më lartë. Ky punim është një ndihmë në këtë drejtim.

Literatura dhe bibliografia

1. Juan de Dios Ortúzar, Luis G. Willumsen: *Modelling Transport*. 4th edition, Wiley publication. 15, 21,144p
2. <https://reader.elsevier.com/reader/sd/pii/S2405896321008144?token=6DD5352358731E576662F15A5A32F063DC8D1D908931ACEE7F86B13C2FAF844FCF28074B81A11FA371AC2ACD A17A7478&originRegion=eu-west-1&originCreation=20220518112407>
3. <http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-aksidentet-dhe-karakteristikat-e-mjeteve-rrugore/#tab2>
4. Ennio Cascheta: *Metodi quantitativi per la pinificazione dei sistemi di trasporti*, Editore: CEDAM (1 settembre 1990), 17p, 29p.
5. Xinhao Wang, Rainer Hofe: *Research Methods in Urban and Regional Planning* 370-378p
6. Ennio Cascetta: *Transportation Systems Engineering: Theory and Methods* 207-256p
7. John R. McLean: *Highway Traffic Operations: Theory and Practice* 98-178p
8. Martin Rogers: *Highway Engineering*
9. http://siteresources.worldbank.org/INTALBANIA/Resources/Albania_urban_sector_shqip.pdf
10. file:///C:/Users/User/Desktop/historiku%20transportit/Vlor%C3%AB,%20historiku%20i%20transportit%20me%20linj%C3%AB%20t%C3%AB%20hekurt_TRT%20%20Shqip
11. *Të dhëna të ndryshme nga Bashkia e qytetit të Vlorës*
12. <https://datastudio.google.com/reporting/5dea2cb3-5552-4bdc-b5ee-7cb0edf9e636/page/RX1xB>